

PERMBLEDHJE

Mbi heqjen e licensave te Shoqerise CEZ Shperndarje sh.a per aktivitetin e shperndarjes se energjise elektrike dhe Furnizimit Publik me Pakice te energjise elektrike

I. HYRJE – Kuadri Ligjor dhe Rregullator ne fuqi dhe Detyrimet e Pergjithshme te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a:

1. Ligji per Sektorin e Energjise Elektrike.....	1 fq
2. Marreveshja per Shitjen e Aksioneve (SPA).....	5 fq
3. Deklarata Rregullatore.....	7 fq
4. Modeli Shqiptar i Tregut.....	9 fq
5. Rregullat e Tregut Shqiptar te Energjise Elektrike.....	11 fq
6. Kodi i Shperndarjes.....	12 fq
7. Licensa e Shperndarjes dhe FPP-se- Kushtet dhe Detyrimet e tyre.....	13 fq

II. RRETHANAT E CESHTJES

1. Kronologjia e marredhenieve ndermjet CEZ Shperndarje sh.a dhe ERE.....	15 fq
2. Rrethanat e vendosjes se Gjokes – Sjellja e Kompanise.....	19 fq
3. Rrethanat e fillimit te procedures se heqjen e Licensave te CEZ Shperndarje.....	21 fq
4. Fillimi i procedurave per Heqje License.....	22 fq

III. ANALIZA LIGJORE DHE TEKNIKE – Shkeljet e Shoqerise CEZ Shperndarje sh.a

1. Shkeljet e Kushteve te Licenses se Shperndarjes	
1.1. Mos prokurimi i energjise elektrike per mbulimin e plote te te gjitha humbjeve ne sistemin e shperndarjes.....	25 fq
1.2. Mos realizimi i objektiveve per nivelin e reduktimit te humbjeve dhe rritja e metejshme e ketij niveli.....	36 fq
1.3. Mos zbatimi i Planit te Investimeve te miratuar nga ERE.....	42 fq
1.4. Mospajisja me matesa te energjise elektrike te te gjithe konsumatoreve.....	54 fq

1.5. Mos pagesa ndaj shoqerise OST sh.a	61 fq
1.6. Moszbatimi i detyrimit per raportimet ne ERE.....	62 fq
 2. Shkelje te kushteve te Licenses se FPP	
2.1. Mos pagesa ndaj shoqerise KESH sh.a.....	66 fq
2.2. Shkelje te detyrimit per parandalimin e vjedhjeve.....	70 fq
2.3. Shkelje te kushteve te Pergjithshme te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare.....	71 fq
2.4. Shkelje te treguesve te cilsise se sherbimit te Shperndarjes dhe Shitjes se energjise elektrike.....	85 fq
 3. Veprimet e demshme kunder shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.....	102 fq
 IV. KONKLUSIONE.....	103 fq



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ .2013

Relacion

Mbi heqjen e licensave shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. për aktivitetin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Furnizimit Publik me Pakice të Energjisë Elektrike

I- HYRJE

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR NE FUQI DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME TE SHOQERISE CEZ SHPERNDARJE SH.A.

Aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike rregullohen nga një kuadër ligjor dhe rregullator, në të cilin përfshihen një sërë aktesh ligjore dhe nenligjore që përcaktojnë midis të tjerave detyrimet e përgjithshme të CEZ Shpërndarje dhe sjelljen në treg të kësaj shoqërie. Ky kuader përbëhet nga:

1. Ligji i Sektorit të Energjisë Elektrike

Ligji Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për sektorin energjisë elektrike” (i ndryshuar), rregullon aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve (aktoreve) në këtë sektor. Ai përcakton “te

drejtat dhe detyrimet e nje personi fizik dhe juridik te perfshire ne ushtrimin e nje apo me shume aktiviteteve ne kete sektor si edhe procedurat per perzgjedhjen dhe zhvillimin e modelit te tregut dhe rregullat per tregun e energjise.”

Ligji i Sektorit te Energjisë Elektrike parashikon, nder te tjera, zhvillimin e një tregu konkurrues të energjisë dhe përmirësimin e kushteve për investimet në sektorin e energjisë.

1.1 Detyrimet kryesore te CEZ Shperndarje sh.a. ne baze te Ligjit 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar

Ne kete Ligj percaktohen edhe detyrat kryesore te shoqerise CEZ Shperndarje, ne rolin e saj si Operator i Sistemit te Shperndarjes (OSSH) dhe si Furnizues Publik me Pakice (FPP) dhe konkretisht:

Neni 43

Operatori i Sistemit te Shperndarjes

- Rrjeti i shpërndarjes zotërohet dhe operohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, që ka një licencë për kryerjen e veprimtarisë në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Mban një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient, duke respektuar kushtet mjedisore;
- Zhvillon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe të parashikimeve të ndryshimit të kërkesës në vend;

Neni 46, pika 2

Furnizuesit me pakicë nder te tjera:

- Zbatojnë kushtet e licencës së furnizimit me pakicë të klientëve;

- Plotësojnë kërkesat e klientëve për energji elektrike, në përputhje me kushtet e kontratës;
- Lexojnë matësat dhe lëshojnë faturat e konsumit të energjisë elektrike për klientët e tyre;
- Përmblushin të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe legjislacioni ose rregulloret përkatëse në fuqi.”

1.2- Roli i ERE ne mbikqyrjen e tregut dhe pjesetareve te tij , ne baze te Ligjit 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar

Ne baze te Ligjit nr. 9072 date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, i ndryshuar, eshte ngritur dhe funksionon Enti Rregullator i Energjise. Autoriteti i tij shtrihet ne fushen e licensimit, vendosjes se tarifave, hartimit te akteve nenligjore, zgjidhjes se mosmareveshjeve mes paleve ne sektor si dhe monitorimit te te gjithë aktoreve. ERE ka pergjegjesine e menaxhimit efektiv te aktiviteteve te rregulluara te aktoreve te tregut, ne perputhje me rregullat dhe rregulloret e miratura per kete qellim.

ERE-ja është përgjegjëse per percaktimin e te drejtave dhe detyrimeve respektive te pjesëmarrësve te tregut, sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jo diskriminuese qe sigurojne aksesin e paleve te treta. Siguron kontroll rregullator per tregun e energjisë elektrike dhe ne përputhje me ligjin per sektorin e energjisë elektrike, ERE-ja i kerkon te licensuarve te veprojne ne nje mënyrë te tille qe te garantojne sigurine afat-shkurter dhe afat-gjate te furnizimit dhe te mos perfshihen ne praktika te pandershme ose te ushtrojne pushtet tregu.

Ne gjithë aktivitetin e saj ERE udhëhiqet nga parimi i aksesit të hapur dhe jo – diskriminues ne sistemin elektroenergjitik ne perputhje me kërkesat e Traktati te Komunitetit te Energjise.

ERE ka luajtur nje rol kyc ne zhvillimin e tregut te energjise elektrike duke krijuar infrastrukturen ligjore (Rregullat e Tregut, Kodet e Rrjetit etj), duke mbikqyrur tregun e energjise elektrike dhe zbatimin e Modelit te Tregut, duke korrigjuar devijimet qe shfaqen ne treg si dhe me ane te vendimarrjes se saj ka ndikuar ne masen e hapjes se tregut duke vendosur penalitete ne rast te deformimeve te tregut te energjise elektrike.

Kuadri rregullator mbi te cilin mbeshtetet e gjithe veprimtaria e ERE-se, i kushton nje rendesi te vecante mbrojtjes se interesave dhe garantimit te te drejtave te atyre pjesemarresve te tregut qe nuk kane mundesine dhe aftesine e duhur per te njohur dhe per te patur aksesin e nevojshem si ne kuadrin ligjor ashtu edhe ne aspektin teknik te funksionimit te tregut, duke u ekspozuar keshtu ndaj shkeljeve te mundshme te te drejtave te tyre nga efekti monopol i tregut te energjise.

Per kete arsye, fuqizimi i rolit aktiv te konsumatoreve ne treg, mireinformimi dhe mbrojtja e interesave te tyre, ne menyre te vecante te konsumatoreve familjare, eshte nje nga sfidat me te rendesishme dhe prioritetet kryesore te ERE-s. Fuqizimi i konsumatoreve konsiston ne punen per garantimin e Cilesise se Sherbimit te Shperndarjes dhe Sigutine e Furnizimit te energjise elektrike. Cilesia e sherbimit te furnizimit me energji elektrike, ne menyre te vecante ne kontekstin e procesit te privatizimit dhe te liberalizimit te sektorit te energjise elektrike, ze nje vend te rendesishem ne aktivitetin e Rregullatorit.

ERE ka miratuar Rregulloren e Cilesise e Sherbimit te Shperndarjes dhe Furnizimit te energjise elektrike, i cili ne aspektin e mbrojtjes se konsumatoreve, eshte nje nga dokumentat kryesore i cili krijon kushtet e nje sherbimi te garantuar per furnizim te panderprere (brenda limiteve te lejuar) me energji elektrike, te konsumatoreve ne sistemin e shperndarjes se energjise elektrike.

Sigurimi transparences nepermjet konsultimit me palet e interesuara dhe me publikun eshte nje nga objektivat e punes se ERE-s, e cila sigurohet gjate procedurave te

miratimit të kuadrit rregullator, dhenien e licensave për veprimtaritë e ushtruara në sektorin e energjisë, miratimin e tarifave të shitjes me pakicë të energjisë elektrike, si dhe në procesin vendimarrës, (mbledhjet e Bordit të Komisionereve).

Për zbatimin e vendimeve të saj, ERE zbaton mekanizmat e mëposhtem shtrenguese:

- Nisja e një procedure kontrolli mbi aktivitetin e të licensuarit që mund të çojë në një rishikim të tarifave të percaktuara.
- Vendosja e gjobave për të licensuarit që nuk përmbushin detyrimet që burojnë nga ligji për sektorin e Energjisë dhe kuadri rregullator në fuqi.
- Heqja e licenses sipas kushteve të percaktuara në ligj dhe në kushtet e licenses.

2- Marreveshja për Shitjen e Aksioneve (SPA), e miratuar me Ligjin nr. 10116, datë 23.04.2009

Duke synuar liberalizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, shteti Shqiptar ndërmoi një sërë reformash, përfshirë privatizimin e Operatorit të Sistemit Shpërndarjes së energjisë elektrike, (OSSH sh.a.), nëpërmjet një procesi tenderimi të kryer në vitin 2008. Objektivi i shtetit Shqiptar, i njohur si dhe i pranuar nga CEZ a.s., që privatizoi 76 % të aksioneve të shoqërisë së shpërndarjes ishte: "*rritja e efikasitetit të operimit, ulja e humbjeve dhe krijimi e një shoqërie furnizimi të energjisë elektrike të qëndrueshme dhe të besueshme*"¹. Shteti shqiptar kërkonte që kompania që do të privatizonte OSSH të përmbushte disa kushte të detyrueshme minimale teknike të performancës². Në ofertën e saj për privatizimin, CEZ a.s. ka bërë angazhime të qarta për të përmbushur

¹ 26 Shtator, 2008, Projekti Teknik I Privatizimit të OSSH nga CEZ a.s, Plani Paraprak I Biznesit, fq.3

² *Forma e konfirmimit të kushteve të detyrueshme minimale të performancës teknike*, të përfshira në Ofertën Teknike të Projektit të Privatizimit të OSSH nga CEZ a.s., 26 shtator 2008

këto standarde minimale, dhe rrjedhimisht mbizotëroi si ofertues fitues dhe investitori strategjik ("Investitor Strategjik").

SPA u nënshkrua më 11 mars 2009, mes Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Ekonomise, si shitës i aksioneve dhe CEZ a.s. si blerës e investitor strategjik. Ne SPA thekson se *"privatizimi i OSSH, do të realizohet nga shitja e numrit të tillë të aksioneve të OSSH-se, sic percaktohet ne "Closing Date" të shtatëdhjetë e gjashtë përqind (76%) të aksioneve të rregjistruara të OSSH të mbajtura nga METE, një investitor strategjik. Për të tërhequr investitorin strategjik optimal për të operuar dhe për të zhvilluar OSSH, METE vendosi të ndërmarë një proces tenderimi të hapur ndërkombëtar, dhe përfundimin e kësaj SPA që do të nënshkruhet ndërmjet METE dhe investitorit strategjik. "*

Ne vijim, ne SPA percaktohet se pas shqyrtimit dhe pikeve të çdo oferte, *CEZ a.s. është shpallur nga METE si ofertuesi fitues për tu bërë Investitor strategjik "*.

Ne menyre që CEZ a.s. të plotesonte detyrimet në baze të SPA, duhej të plotesoheshin disa detyrime nga ana e institucioneve të shtetit shqiptar që perfshinin:

Neni 4.1 (b) të SPA: OSSH do të ketë marrë nga Rregullatori (ERE) (i) të gjitha licencat e nevojshme për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike dhe (ii) të gjitha miratimet për transferimin e aksioneve të OSSH;

Neni 4.1 (d) i SPA: miratimi nga Parlamenti Shqiptar të Deklaratës Rregullatore;

Neni 4.1 (f) i SPA: lëshimi i një garancie risku të pjesshëm nga Banka Botërore në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Blerësin dhe miratimit nga Parlamenti Shqiptar të kësaj garancie;

Neni 4.1 (g) i SPA: miratimi nga ana e Rregullatorit të procedurave të tenderit të përmendura në Nenin 4, të Deklaratës së Rregullatore (i) për përzgjedhjen e bankave në lidhje me çdo borxh të ri që do të merrej nga OSSH, dhe (ii) për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, në çdo rast, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për blerësin; dhe

Neni 6.2 (f) i SPA: miratimin nga Parlamenti shqiptar të transaksionit dhe SPA dhe miratimi nga Këshilli i Ministrave të investitorit strategjik;

Qëllimi i shtetit Shqiptar ishte që të zgjidhte një investitor strategjik me njohuritë e përvojën, dhe me burimet e nevojshme për të operuar dhe për të zhvilluar sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim arritjen e objektivave të deklaruara të rritjes së efikasitetit operacional, uljen e humbjeve, dhe krijimin e një kompanie furnizimi të qëndrueshme dhe të besueshme të energjisë elektrike. ***Në këtë kontekst, SPA nuk ishte një marrëveshje e thjeshtë për transferim e aksioneve.***

3 - Deklarata Rregullatore

Deklarata Rregullatore, miratuar me Vendimin nr. 12, datë 3.03.2009, të Bordit të Komisioneve të ERE, është bashkangjitur si Shtojca 11, e Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve (SPA). Përfshirja e Deklaratës Rregullatore në SPA, është një tregues i qartë se CEZ a.s duhet të jetë përgjegjëse për detyrimet e sistemit të shpërndarjes në përputhje me kushtet e licencave të saj. Për këtë arsye, CEZ a.s. kishte detyrimin dhe përgjegjësinë për të siguruar përmbushjen e detyrimeve sipas Deklaratës Rregullatore si më poshtë:

- Paraqitja e aplikimeve të tarifave pranë ERE-s "për një vit të dhënë në rastin e Furnizuesit Publik Pakice dhe për një periudhë

të caktuar rregullator për OSSH, jo më vonë se 1 shtatori i vitit kalendarik që paraprin periudhën e ardhshme rregullatore";

- Paraqitja e një plani të investimeve për vitin 2009 dhe 2010 "jo më vonë se [2] muaj pas mbylljes së privatizimit të OSSH, në të cilën ERE do ta shqyrtojë dhe aprovojë jo më vonë se [2] muaj pas dorëzimit të saj";
- Kryerjen e një auditimi të detajuar mbi humbjet në vitin 2008 dhe Studimin e Humbjeve në vitin 2009, për tu përdorur si bazë të rishikimit të tarifave dhe propozimin e një skeduli të reduktimit të humbjeve;
- Në këtë drejtim, ERE priste një përmirësim të shpejtë të nivelit të humbjeve jo-teknike, dhe një reduktim të ngadaltë, por të vazhdueshëm të humbjeve teknike (parashikuar në 4% për periudhën e parë rregullatore, 4% për periudhën e dytë rregullatore, dhe 9 % për periudhën e tretë rregullatore);
- Në bazë të studimit të Humbjeve, OSSH duhet që t'i propozonte ERE-s një plan për reduktimin e humbjeve totale për tre periudhat rregullatore, të shoqëruar me planin e investimeve për reduktimin e humbjeve;
- OSSH duhet të dorëzonte planet e investimeve për reduktimin e humbjeve, në zbatim të nenit 24 të ligjit për sektorin e energjisë elektrike.

- Kryerja e një studimi të detajuar për Borxhin e Keq për të përcaktuar metodologjinë e llogaritjes së borxheve të këqija, dhe nivelet e borxhit të keq për vitet 2008, 2009, dhe 2010;
- Paraqitja e një propozimi për ERE-n për standartet në përmirësimin e cilësisë e shërbimit në lidhje me ndërprerjet e energjisë elektrike (frekuencat dhe kohëzgjatja) dhe saktësia e faturimit në 99%. Këto përmirësime do të konsistojnë nga mirembajtjet e bëra nga ana e OSSH-s, së bashku me një program të riparimeve me bazë vjetore; dhe leximin e matesave.

4 - Modeli Shqiptar i Tregut

Modeli Shqiptar i Tregut, miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008, përben bazën ligjore të organizimit dhe strukturimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Parathënia e Modelit Shqiptar të Tregut ("Modeli i Tregut") thekson se miratimi i Modelit të Tregut është *"një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit, konsolidimit dhe qëndrueshmërisë së tregut shqiptar të energjisë elektrike"* dhe *"është pjesë e reformës që Shqipëria ka ndërmarrë për rindërtimin e sektorit të energjisë elektrike, në pajtim me Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike..."*.

Pika 3.1 i Modelit të Tregut parashikon se ai është bërë për të *"siguruar një kuadër për reformimin e sektorit të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe privatizimin e shpërndarjes dhe furnizuesit publik me pakicë në të ardhmen e afërt. Ky kuadër do të sigurojë një bazë të shëndoshë për privatizimin e segmenteve të tjera të sektorit të energjisë."*

Pikat 4.8 dhe 4.9 të Modelit të Tregut përcaktojnë detyrimet e OSSH dhe FPP (te cilat

iu shiten CEZ a.s., qe mori përgjegjësinë e saj për rolin e investitorit strategjik të privatizimit).

Sipas Pikes 4.8 të Modelit të Tregut, OSSH duhet që:

- Të zotërojë, ruaje dhe zgjeroje sistemin e shpërndarjes në të gjithë Shqipërinë;
- Te blejë energji elektrike për të mbuluar humbjet reale në sistemin e shpërndarjes
- Te ofroje shërbimin e lidhjes në kushte jo-diskriminuese;
- Te pranoje rregullimin nga ana ERE-s; dhe
- Te mbuloje gjitha humbjet teknike dhe jo-teknike në sistemin e shpërndarjes sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

Sipas Pikes 4.9 të Modelit të Tregut, FPP është i detyruar që, ndër të tjera:

- T'i sigurojë OST dhe KESH-it, Furnizuesit Publik me Shumice, programet vjetore, javore dhe ditore për fluksin e pritshëm, në mënyrë që të mundësojë Furnizuesin Publik me Shumice dhe OST për të hartuar programet e tyre;
- Te bleje energji elektrike nga KESH me çmimet e miratuara nga ERE dhe
- Te ule mosarketimin e klientëve tariforë sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

Sipas pikes 6, të Modelit të Tregut (Fluksi i Fondeve), OSSH dhe FPP janë përgjegjës për të bërë pagesa të ndryshme, duke përfshirë:

- Pagesat nga OSSH për energjinë e nevojshme për të mbuluar humbjet reale në sistemin e shpërndarjes;
- Pagesa nga OSSH-ja për OST për shërbimet e transmetimit, duke përfshirë shërbimet ndihmëse sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja, në lidhje me energjinë e blerë nga OSSH-ja për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes;
- Pagesa nga FPP tek KESH për energjinë elektrike të furnizuar me Furnizuesin Publik me Pakicë sipas kushteve të miratuara nga ERE-ja;
- Pagesa ndaj OST për shërbimet e transmetimit, duke përfshirë shërbimet ndihmëse dhe
- Pagesa për OSSH për shërbimin e shpërndarjes.

5 - Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike

Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike ("Rregullat e Tregut"), miratuar me vendim nr. 68, të Bordit të Komisionerëve të ERE-së të datës 23 qershor 2008, përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tregut dhe sigurojnë mbikëqyrjen e rregullatorit për tregun e energjisë elektrike.

Sipas Kapitullit II.2.5 të Rregullave të Tregut, OSSH është e detyruar të:

- Zotërojë, ruajë, zgjerojë dhe operojë sistemin e shpërndarjes;
- Të mbajë një regjistër të objekteve dhe të matësve të konsumit të energjisë elektrike për konsumatorët e kualifikuar dhe konsumatorët tarifore të lidhur në sistemet e shpërndarjes;
- Të ofrojë shërbimin e shpërndarjes për të gjithë konsumatorët e kualifikuar në kushte jo-diskriminuese;
- Të ofrojë aksesin e rrjetit të shpërndarjes për hidrocentralet e vegjël;
- Të blejë energji nga subjekte të ndryshme, duke përfshirë KESH, për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes;

Sipas Kapitullit II.2.7 të Rregullave të Tregut, FPP do të:

- Shesë energji elektrike për konsumatorët tariforë; dhe
- Të ruajë të dhënat e konsumatorëve.

6- Kodi i Shpërndarjes

Kodi i Shpërndarjes (Kodi i Shpërndarjes) është pjesë e legjislacionit dytësor (sekondar) të miratuar nga ERE me Vendimin nr. 100, datë 26.08.2008, sipas ligjit bazë të sektorit të energjisë elektrike. Ai vendos rregullat teknike të tregut të energjisë elektrike si dhe kërkesat për një funksionim normal, të qëndrueshëm dhe efikas të rrjetit të shpërndarjes.

Kodi i Shpërndarjes përcakton pjesërisht se OSSH dhe FPP duhet të “garantojnë një sistem shpërndarjeje të sigurt dhe efikas duke u kujdesur edhe për ambientin”, “nuk duhet të bëjnë dallim ndërmjet përdoruesve apo grup përdoruesve të sistemit, sipas llojit të aktivitetit” dhe “t’u sigurojë përdoruesve të sistemit informacionin e duhur për t’u lidhur sa me mirë në sistem”.

7- Licensa e Shpërndarjes dhe e FPP - kushtet dhe detyrimet e tyre

Licensa e Shpërndarjes

Përveç të tjerash, sipas kësaj license, detyrimet e OSSH-së përfshijnë:

- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një rrjeti të shpërndarjes me një kapacitet që është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e të gjithë konsumatorëve dhe të përdoruesve brenda Shqipërisë, duke përfshirë zgjerimin ose përmirësimin e objekteve të saj teknike sipas nevojës;
- Marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të përmirësuar efikasitetin operativ dhe ekonomike të aktivitetit të licencuar;
- Garantimi i qëndrueshmerisë dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të klienteve;
- I Licensuari duhet të përgatisë një program për të arritur uljen e nivelit të humbjeve ashtu siç është përcaktuar në Deklaratën Rregullatore apo nga ndonjë vendim tjetër i ERE-s.

- Përgatitja e një programi investimi me analiza tekniko - ekonomike dhe financiare për projektet e investimit;
 - Realizimi i një programi që synon reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjet;
 - Një program mirëmbajtjeje për të siguruar, së bashku me programin e investimit, operim me të qëndrueshem të Rrjetit;
-
- Paraqitja e një aplikimi për tarifë, në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së tarifave të shpërndarjes nga ERE;
 - Mirëmbajtja e sistemit të matjes;
 - Blerja e gjithë energjisë së nevojshme për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes.

Liçensa e Furnizimit Publik me Pakicë

Në Licensën e FPP, përfshihen midis të tjerave detyrimet e mëposhteme:

- Kryerja e aktivitetit të licencuar në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomik dhe objektivin e arritjes së kostove më të ulëta në cilësinë e përcaktuar dhe standardet e performancës;
- Mosangazhimin në aktivitete të tjera që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen e duhur të aktivitetit të licencuar;
- Ushtrimin e aktivitetit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Mbatjen e llogarive dhe përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve vjetore për operacionet e saj në ERE, më 31 Janar të çdo viti;
- Blerjen prej Furnizuesi Publik me Shumicë (FPSH ose KESH) të energjisë elektrike dhe kapaciteteve të nevojshme për konsumatorët tariforë;

- Marrja e të gjitha masave të nevojshme për të përmirësuar efikasitetin operativ dhe ekonomik të aktivitetit të licencuar, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e furnizimit me çmim të arsyeshëm.

Sa më sipër, detyrimet e CEZ Shperndarje sh.a sipas Liçensës së Shpërndarjes janë në shumë mënyra të ngjashme me detyrimet sipas licencës FPP më sipër, sidomos në lidhje me aplikimin dhe detyrimet ligjore.

II-RRETHANAT E CESHTJES

Ne kete pjese te materialit Grupi i Punes ka paraqitur kronologjine e marredhenieve ndermjet CEZ Shperndarje dhe ERE per sa i takon problematikave kryesore te lindura ne lidhje me mospërmbyshjen e kushteve te licencave.

1. Kronologjia e marrëdhënieve ndërmjet CEZ Shperndarje dhe ERE

Duke filluar nga Janari 2012, pas informacioneve periodike te dërguara ne ERE nga ana e CEZ Shperndarje dhe KESH sh.a si dhe pas shqetësimeve te ngritura nga ana e KESH sh.a me shkresen nr. 71, Prot. Date 09.01.2012, per reduktimin e importit te energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne sistemin e shperndarjes nga ana e CEZ Shperndarje, nga ana e ERE eshte zhvilluar seance degjimore per kete qellim mes KESH, OST dhe CEZ Shperndarje. (Shih njoftimin me ane te shkreses 24/1, prot., date 12.01.2012).

Pas kesaj seance, ERE me ane te shkreses 24/3, prot., date 19.01.2012, drejtuar CEZ Shperndarje, ka kerkuar shtimin e importit te energjise elektrike per mbulimin e humbjeve sipas nivelit aktual te tyre.

Shoqeria CEZ Shpendarje sh.a. ne shkresen me Nr. 281/2, date 30.03.2012 lidhur me situaten e veshtire ne sektorin elektroenergjitike drejtuar Ministrise se Financave, METE-s dhe Keshillit te Ministrave, shprehet per nje gjendje financiare shume te veshtire. Nga ana tjeter ne kete suate po aq te veshtire eshte dhe kompania KESH per shkak jo vetem te situates hidrologjike te ndodhjes ne nje vite te thate, por dhe per shkak te marredhenieve kontraktuale jo funksionale midis saj dhe CEZ Shperndarje. Pervec rritjes se kerkeses ne nje mase shume te madhe nga ajo e planifikuar nga CEZ Shperndarje, ne te njejten kohe nuk eshte paguar detyrimi per energjine e marre nga KESH qe per vitin 2011 i korrespondojne nje sasie rreth 626 mije MWh .

Nga ana tjeter me ane te shkreses me nr. 281/11, Prot., date 11.04.2012, ERE ka sqaruar se mbasi jane analizuar pretendimet e CEZ Shperndarje, pasi eshte analizuar situaten financiare, ka organizuar seancen degjimore te dates 04.04.2012 ne te cilen jane kerkuar argumentat e nevojshme per te provuar situaten e veshtire te kompanise CEZ Shperndarje. Ne kete shkrese shoqeria njoftohet se ERE ka filluar nje proces te gjere monitorimi te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.

Ne shkresen me nr. 281/20 Prot, date 25.05.2012, ERE i ka dhene rekomandimet perkatese shoqerise CEZ Shperndarje, pasi grupi i punes i ERE-se, i ngritur per qellime te monitorimit te gjendjes financiare, ka konstatuar se gjendja kritike eshte shkaktuar kryesisht nga tejkalimi nga ana e CEZ Shperndarje e shpenzimeve te lejuara si pasoje e keqmenaxhimit te shoqerise.

Po ashtu ne sancen degjimore te zhvilluar ne daten 5 Shtator 2012, ne prani te METE, KESH, OST dhe perfaqesuesve te Sekretariatit te Komunitetit te Energjise ne Vjene,

nga ana e shoqerise CEZ Shperndarje eshte pranuar nevoja per import te energjise elektrike per mbulimin e plote te humbjeve dhe eshte premtuar qe do realizohej ky import, dhe konkretisht drejtuesi i shoqerise CEZ Shperndarje sh.a. Z. Macek deklaroi se *“ne nuk ndaluam importet duke dashur qe te mos importojme por situata e kompanise na coji qe ne nuk importojme dot.”*

Po ashtu, me shkresen nr. 256/18, date 25.09.2012, ERE i gjen te pabazuara argumentat e CEZ Shperndarje sh.a, ne lidhje me paaftesine financiare te saj per importin e energjise elektrike. Se fundmi konkludohet se gjendja financiare eshte pasoje e menaxhimit te kompanise. Ne te kundert ERE paralajmeron qe do te procedoje me marrjen e masave administrative.

Perseri ERE ne shkresen nr. 636/1, date 03.10.2012, ka udhezuar shoqerine CEZ Shperndarje qe te ule nivelin e shpenzimeve per zera te tjere dhe te fokusohet ne kryerjen e shpenzimit per prokurimin e energjise elektrike.

Nga ana tjeter OST me shkresen nr. 4517/3, date 4.10.2012, si operator i tregut, i gjen te pambeshtetur te gjithe argumentat e CEZ Shperndarje ne lidhje me paaftesine financiare per mbulimin e humbjeve. Nga ana e OST theksohet qe kompania duhet ti gjeje shkaqet e verteta brenda kompanise pa ja ngarkuar fajin entiteve shteterore apo rregullatore, sepse me gjithe përpjekjet e bera nga Qeveria Shqiptare dhe entitet shteterore, shkak per mosrealizimin e marreveshjes per shuarjen me kompensim te detyrimeve te ndersjellta midis institucioneve buxhetore e jobuxhetore, shoqerive te kontrolluara nga shteti dhe CEZ shperndarje sipas marreveshjes se dates 28.2.2012 te miratuar me VKM nr. 154, date 29.2.2012, CEZ Shperndarje deshtoi ne permbushjen e detyrimeve te tij qe benin efektive kete marreveshje. Per me teper ne kete shkrese cilesohet se detyrimet e CEZ Shperndarje ndaj OST e KESH sh.a. tejkalojne shume here me teper vleren e detyrimit nga institucionet buxhetore e jo –buxhetore. Ne përfundim rekomandohet qe administrimi i shoqerise aksionere duhet te behet ne

perputhje me Ligjin nr. 9901 date 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i cili eshte pergjegjesi e organeve te shoqerise dhe nuk mund ti ngarkohet te treteve ne menyre te drejtperdrejte.

Perseri OST sh.a me shkresen nr. 4693 dt 9.10.2012, mbi situaten hidroenergjetike paralajmëron qe furnizimi i konsumatoreve me energji vazhdon normalisht, por kjo po sjell zvogelimin me shpejtesi te rezerves hidroenergjitike te kaskades se lumit Drin per shkak te uljes ne **zero** te importit nga ana e CEZ Shperndarje.

Ne shkresen e nr.7869 prot., date 20.12.2012, CEZ Shperndarje sha, njofton ERE-n, se : *“shoqëria mund te mos jete ne gjendje te parandaloje perkeqesimin ne javet e ardhshme ne nivelin e shërbimeve qe siguron, perfshire dhe levrimin e energjise elektrike”*, gjë qe deshmon mungesen e kapaciteteve dhe heqjen dore nga kryerja e aktivitetit te licensuar.

Gjithashtu me shkresen me Nr. 7869/2 Prot, date 21.12.2012, drejtuar ERE-s, CEZ Shperndarje sh.a. ne kerkesen per lejimin e kryerjes se pagesave per sherbime emergjente, thuhet se *“CEZ Shperndarje sh.a. (referuar ketu e me poshte si shoqeria) gjendet ne veshtiresi serioze per te paguar detyrimet baze ndaj kontraktoreve te ndryshem.”*

ERE me shkresen Nr. 805/1Prot, date 21.12.2012, si pergjigje e shkreses refuar me siper, i rikujton CEZ Shperndarje se *“Persa kohe qe CEZ Shpendarja eshte mbajtes i licenses se Shperndarjes se Energjise Elektrike dhe Furnizuesit Publik me Pakice, eshte e detyruar dhe e pergjegjshme ne baze te ligjit qe te kryej te gjithë sherbimet sipas legjislacionit ne fuqi perfshire dhe furnizimin e panderprere te energjise elektrike te konsumatoreve.”*

Paaftesia e tyre per menaxhimin e situates dhe per vazhdimin e kryerjes se aktivitetit te licensuar, pohohet prej vete CEZ Shperndarje sh.a. ne pergjigjen drejtuar ERE-s, me nr. 7869/3, date 21.12.2012, se *“ ne nuk e dime ende cfare ngjarjesh mund te ndodhin te cilat mund te sjellin perkeqesimin e shërbimeve. Ajo cfare ne dime eshte se gjendja jone kritike financiare na e ben te veshtire punen per kryerjen e riparimeve apo zëvendesimin e pajisjeve te demtuara.”*

CEZ vazhdon me pohimet ne shkresen drejtuar ERE-s me Nr. 805/4 Prot, date 24.12.2012 ku shprehet se *“Nga e gjithë lista e shlyerjes se detyrimeve qe keni paraqitur me shkresen e sipercituar nuk keni parashikuar shlyerjne e detyrimeve te blerjes se energjise elektrike dhe te sherbimit te transmetimit te energjise.”*, e cila tregon mungesen totale te vullnetit per respektimin e detyrimeve kontraktuale karshi pjesetareve te tjere te tregut.

Duke iu referuar Ligjit, ne shkresen e saj nr. 805/5, date 24.12.2012, ERE citon se *“Persa kohe qe shoqeria CEZ shperndarja eshte mbajtese e licenses se Shpendarjes se Energjise Elektrike dhe Furnizuesit Publik me Pakice eshte e detyruar qe te beje furnizimin e panderprere me energji elektrike per konsumatorët tarifar.”*

2-Rrethanat vendosjes se Gjobjës – Sjellja e Kompanisë

Duker vërejtur mos zbatimin e udhezimeve te dhena nga ERE dhe mos korrigjim te veprimeve nga ana e shoqerise CEZ Shperndarje, me ane te Vendimit nr. 103, date 20.07.2012, ERE filloi procedimin administrativ per vendosje kundravajtje administrative ndaj shoqerise CEZ Shperndarje.

Me ane te vendimeve nr. 111, date 31 Korrik 2012, “Mbi kapacitetet e interkonjeksioneve ne drejtimin import per muajin gusht 2012” dhe nr. 114, i dates 22 Gusht 2012, “Mbi kërkesën e CEZ Shpërndarje sh.a për moszhvillimin e ankandit të kapaciteteve në drejtimin import muajt shtator, tetor, nëntor, dhjetor, të vitit 2012”, Bordit i Komisionereve te ERE u perpoq per ti krijuar CEZ Shperndarje te gjitha lehtesite per kryerjen e importit te energjise elektrike, dhe u vendos alokimi pa ankand i kapaciteteve te interkonjeksionit për muajin Shtator per këtë shoqëri me qellim qe te lehtësohej importimi i energjise elektrike .

Duke konstatuar se nga ana e CEZ Shperndarje per periudhen 1 – 14 Shtator 2012 niveli i importit ra ne zero, me ane te Vendimit nr. 128, date 11.09.2012, Bordi i Komisionereve te ERE-se vendosi te dënojë administrativisht me vendosje gjobe shoqërinë CEZ Shperndarje, per shkak te mos prokurimit te energjisë elektrike te nevojshme qe i korrespondon humbjeve te rrjetit te shperndarjes për vitin 2012. Nga ana e ERE gjate këtij procedimi u konstatua se kjo shkelje është kryer ne dijeni te plote nga ana e CEZ Shperndarje ne te gjitha nivelet e drejtimit te saj duke sjelle qe rrethanat te jene te renda.

U konstatua qe pasojat qe janë krijuar jane te medha dhe kane cenuar sigurinë e furnizimit dhe kane vendosur ne vështirësi financiare KESH sh.a. ne kushtet e mospagesave nga CEZ Shperndarje dhe moskompensimi ne sasi prej këtij te fundit qe ka sjelle si rrjedhoje veshtiresine e KESH për te likuiduar detyrimet financiare ndaj Prodhuesve te Vegjel te Energjisë.

Gjithashtu, është për tu theksuar se kompania e ka pranuar këtë mospërmbushje detyrimi edhe pse e ka justifikuar këtë me kundërshtimin prej saj te kuadrit rregullator apo mos arritjen e lidhjes se kontratave me furnizuesit ne treg. Ne analize te komunikimeve te vet CEZ Shperndarje, mos lidhja e kontratave pretendohet se ka ndodhur per shkak te pamundesie se shoqerise per te dhene garancite e mjaftueshme per tregtaret. Po ashtu CEZ Shperndarje nuk po arrin te realizoje edhe furnizimin me energji elektrike sipas kontrates te lidhur ne kuader te prokurimit te realizuar ne vitin 2011 per mbulimin e humbjeve ne sistemin e shperndarjes per vitin 2012. Kjo e fundit eshte shkaktuar per shkak te detyrimeve te parealizuara per pagesat e energjise elektrike ndaj subjektit me te cilin ishte lidhur kontrata sipas tenderit vjetor qe CEZ Shperndarje ka zhvilluar.

Ne analize te gjithë sa me sipër nga ana e ERE ne baze te nenit 64, te Ligjit 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar, gjithashtu duke marre ne konsiderate qe Shoqëria CEZ Shperndarje rezultonte qe eshte dënuar edhe me pare administrativisht nga ERE me vendimin nr. 90, date 15.11.2010, u procedua me vendosje gjobe ndaj shoqerise CEZ Shperndarje ne masen 1% te te ardhurave te vitit parardhes.

3 - Rrethanat e fillimit te procedures se heqjen e Licencave shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.

Edhe pas vendosjes se gjobes, shoqeria CEZ Shperndarje vazhdoi ne shkelje te detyrimeve te kuadrit ligjor ne fuqi, duke mos prokuruar energjine elektrike per mbulimin e humbjeve. Ne shkresen nr. 6092/2, date 28.09.2012, CEZ Shperndarje shprehet se kerkon qe KESH te marre masa te nevojshme per te vepruar si furnizues i alternative se fundit, cka nenkupton furnizimin me energji elektrike per mbulimin e plote te humbjeve.

Me shkresen nr. 4693 Prot., date 09.10.2012, OST sh.a, ka bere me dije se “*CEZ Shperndarje e ka ulur importin ne zero, dhe ne keto kushte e gjithë kerkesa per energji elektrike po perballohet pothuajse nga rezerva e kaskades se Drinit,,.*

Mos prokurimi i energjise elektrike per mbulimin e humbjeve nga ana e CEZ Shperndarje sh.a, pervecse nje shkelje e detyrimeve ligjore dhe rregullatore te sipermendura, cenon ne mënyre e drejtpërdrejte edhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve tarifore, duke qene se mos importimi i humbjeve con ne mungesën e energjisë elektrike te konsumatoreve shqiptare dhe sigurimi përmes kompanisë se furnizimit publik me shumice (KESH) rendon situatën financiare te kësaj te fundit dhe me tej pjestaret e tjerë te tregut.

Ne kete situate, duke vërejtur kushtet e krijuara nga mosprokurimi i energjise elektrike te nevojshme për mbulimin e gjitha humbjeve te shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, nga ana e Qeverise Shqiptare u procedua me miratimin e aktit normativ te Keshillit te Ministrave³, duke lejuar KESH sh.a qe te importonte energjinë e nevojshme për furnizimin e konsumatoreve dhe mbulimin e humbjeve. Ky deformim i tregut i ardhur si pasoje e mosveprimeve te shoqerise CEZ Shperndarje u mor duke pare uljen e rezervave te kaskades se Drinit si rrjedhoje e përdorimit te ketyre rezervave edhe per mbulimin e humbjeve ne sistemin e shperndarjes.

4 - Fillimi i procedurave për heqje licence

ERE duke konstatuar mosreagimin e shoqerise CEZ Shperndarje sh.a, e cila ka vijuar me deformimin e metejshem te tregut dhe shkeljeve te kryera nga shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. te kushteve te përcaktuara ne Licensën për aktivitetin e Shpërndarjes se Energjisë Elektrike dhe Licensën e aktivitetit te Furnizimit Publik me Pakice, ne mbështetje te:

- 1- Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, te ndryshuar, neni 18, pika 1, germa a,;
“ERE-ja mund ta heqë licencën kur i licencuari:
a) nuk përmbush kushtet e licencës së dhënë sipas këtij ligji;”
- 2- Pikes 4.8, te Modelit te Tregut te miratuar me vendimin nr. 338, date 19.03.2008 “OSSH-ja eshte pergjegjese per blerjen e energjise elektrike per

³ VKM 633, date 03.10.2012 “PËR LEJIMIN E SHOQËRISË "KESH" SHA TIRANË, TË IMPORTOJË ENERGJI ELEKTRIKE PËR FURNIZIMIN E KONSUMATORËVE TARIFORË, SI DHE MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES”

- te mbuluar te gjitha humbjet ne sistemin e shperndarjes. OSSH-ja mund ta bleje kete energji nga cdo pjesmarres tregu me cmime tregu”
- 3- Deklarates Rregullatore, miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE, nr 94, date 18.04.2008
- 4- Rregullores “Për Procedurat e Heqjes se Licensave” te miratuar me Vendim te Bordit te Komisionerëve te ERE nr. 68, date 04.11.2005, perkatesisht nenet 5, 6, 7 dhe 8 te saj,
- 5- Licenses per veprimtarine e shperndarjes se energjise elektrike, miratuar me vendimin e Bordit te Komisioenereve te ERE-s nr. 8, date 25.01.2008
- 6- Licencë per aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit te Komisioenereve te ERE-s nr. 9, date 25.01.2008;
- 7- Kontratës se Furnizimit me Energji Elektrike te Konsumatoreve Familjare, miratuar me vendimin e Bordit te Komisioenereve te ERE-s nr. 108, date 21.10.2011;
- 8- Kontratës se Furnizimit me Energji Elektrike te Konsumatoreve Jofamiljare, miratuar me vendimin e Bordit te Komisioenereve te ERE-s nr. 109, date 21.10.2011;
- 9- Kontratës se Furnizimit me Energji Elektrike mes KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a., miratuar me vendimin e Bordit te Komisioenereve te ERE-s nr. 134, date 17.03.2012;
- 10 - Marrëveshjes se Transmetimit mes OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, miratuar me vendimin e Bordit te Komisioenereve te ERE-s nr. 102, date 19.07.2012.

Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr. 158 datë 16.11.2012, Vendosi fillimin e procedurave për heqjen e licensave të aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë, për këtë shoqëri.

Ne vijmë të këtij vendimi, në përputhje me sa përcaktuar në nenin 18 pikë 1, paragrafi a), të Ligjit nr. 9072 “Për sektorin e energjisë elektrike”, datë 22.05.2003, të ndryshuar, si dhe për sa përcaktuar në nenet 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e heqjes së një License”, u procedua me dërgimin e këtij vendimi, me shkresën nr. 743 prot., datë 20.11.2012, shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. duke i bërë të ditur që shoqëria kishte të drejtën për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

Me shkresën nr. 7303/1 prot., datë 17.12.2012 CEZ Shpërndarje sh.a. paraqiti në ERE përgjigjen ndaj Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.158, datë 16 nëntor 2012.

Paralelisht me nisjen e këtij procedimi dhe në funksion të verifikimit të veprimtarisë së CEZ Shpërndarje sh.a, në zbatim të Modelit të Tregut të energjisë elektrike dhe kushteve të licensave, ERE vijoi me monitorimin e metejshëm të aktiviteteve të licensuara të kësaj shoqërie. Nga ana e ERE u vijua edhe me monitorimin lidhur me levizjen e parase (Cash Flow) të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a për periudhën Janar – Tetor 2012 dhe të verifikimit të realizimit të përmbushjes së detyrimit ligjor për furnizimin e pa ndërprerje dhe me cilësi të konsumatorëve me energji elektrike nga CEZ Shpërndarje. Mbas monitorimit të bërë në CEZ Shpërndarje, ERE me shkresën nr. 45 prot., datë 11.01.2013 procedoi me dërgimin kompanisë të konstatimeve të grupit të punës, mbi Levizjen e parase duke i bërë të ditur që të dërgonin sqarimet e tyre rreth këtyre konstatimeve të përgatitura nga grupi i punës së ERE-s brenda datës 15.01.2013. **Deri me sot nuk na është dërguar asnjë informacion nga ana e**

Shoqerise lidhur me konstatimet tona edhe pse duhet te ishin sqaruar me kohe nga ana e saj.

Nga raportimet periodike dhe monitorimet ne vijim si dhe nisur nga informacioni i derguar nga shoqeria CEZ Shperndarje me shkresen nr. 7303/1, date 14.12.2012, konstatohen shkeljet e legjislacionit ne fuqi ne ushtrimin e aktiviteteve te licensuar te shoqerise CEZ Shperndarje, si me poshte analizuar.

III- ANALIZA LIGJORE DHE TEKNIKE - Shkeljet e shoqerise CEZ Shperndarje

Ne kete pjese te materialit analizohen ne menyre te detajuar shkeljet e konstatuara nga ERE te legjislacionit ne fuqi te kushteve te licencave te shoqerise CEZ Shperndarje.

I – Shkeljet e kushteve te Licenses se Shperndarjes

1. Mos prokurimi i energjise elektrike per mbulimin e plote te te gjitha humbjeve ne sistemin e shperndarjes

Baza ligjore:

I Licensuari do te respektoje Legjislacionin ne Fuqi gjate ushtrimit te funksioneve sipas kesaj license.- Pika 3.1 e Licenses se Shperndarjes

I Licensuari eshte pergjegjes per blerjen e gjithe energjise se nevojitur per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes. – Pika 3.16.4 e Licenses se Shperndarjes

OSSH-ja eshte pergjegjese per blerjen e energjise elektrike per te mbuluar te gjitha humbjet ne sistemin e shperndarjes. OSSH-ja mund ta bleje kete energji nga cdo pjesmarres tregu me cmime tregu. – Pika 4.8 e Modeli te Tregut

CEZ Shperndarje sh.a. ne shkelje te detyrimeve te sipercituara, nuk ka realizuar prokurimin e sasise se plote te energjise elektrike per mbulimin e plote te humbjeve ne sistemin e shperndarjes.

Duke filluar nga muaji Shtator te vitit 2012 CEZ Shperndarje ne periudhen 1-14 Shtator nuk ka importuar asnje MWh energji elektrike per mbulimin e humbjeve ne sistemin e shperndarjes. Te detajtuara sasite e importura nga CEZ Shperndarje jane sipas deklarimeve ditore te OST sh.a, te paraqitura ne tabelen nr. 1 te meposhtme per muajin Shtator.

Tabela nr.1

	PROGRAMIMI DITOR I SHKEMBIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE													
	CEZ SHPERNDARJE SH.A			TOT	KESH SH.A		TOT	Konsumatoret e Kualifikuar			TOT	Σ		
	CEZ As				KEK			ACR,ARMÇ	Antea(Rud	KURUM (GEN-I)				
1 Shtator	0	0	0	0	-530	0	-530	-1752	-430	0	-2182	-2712		
2 Shtator	0	0	0	0	-650	0	-650	-1752	-410	0	-2162	-2812		
3 Shtator	0	0	0	0	-420	0	-420	-1752	-416	0	-2168	-2588		
4 Shtator	0	0	0	0	-540	0	-540	-1752	-416	0	-2168	-2708		
5 Shtator	0	0	0	0	-620	0	-620	-1752	-416	0	-2168	-2788		
6 Shtator	0	0	0	0	-1660	0	-1660	-1752	-416	0	-2168	-3828		
7 Shtator	0	0	0	0	-1910	0	-1910	-1752	-424	0	-2176	-4086		
8 Shtator	0	0	0	0	-1750	0	-1750	-1752	-410	0	-2162	-3912		
9 Shtator	0		0	0	-1990	0	-1990	-1752	-410	0	-2162	-4152		
10 Shtator	0	0	0	0	-1065	0	-1065	-1752	-416	0	-2168	-3233		
11 Shtator	0	0	0	0	-300	0	-300	-1752	-368	0	-2120	-2420		
12 Shtator	0	0	0	0	-360	0	-360	-1608	-412	0	-2020	-2380		
13 Shtator	0	0	0	0	-1250	0	-1250	-1872	-416	0	-2288	-3538		
14 Shtator	0	0	0	0	-1037	0	-1037	-1872	-416	0	-2288	-3325		
15 Shtator	-3120	0	0	-3120	-980	0	-980	-1992	-410	0	-2402	-6502		
16 Shtator	-3120	0	0	-3120	-830	0	-830	-1992	-410	0	-2402	-6352		
17 Shtator	-1536	0	0	-1536	0	0	0	-1872	-410	0	-2282	-3818		
18 Shtator	0	0	0	0	0	0	0	-1872	-410	0	-2282	-2282		
19 Shtator	-2880	0	0	-2880	-900	0	-900	-1872	-410	0	-2282	-6062		
20 Shtator	-2880	0	0	-2880	-470	0	-470	-1880	-405	0	-2285	-5635		
21 Shtator	-6000	0	0	-6000	-710	0	-710	-1992	-405	0	-2397	-9107		
22 Shtator	-6480	0	0	-6480	-470	0	-470	-1992	-405	0	-2397	-9347		
23 Shtator	-6480	0	0	-6480	-550	0	-550	-1992	-405	0	-2397	-9427		
24 Shtator	-5880	0	0	-5880	-610	0	-610	-1872	-405	0	-2277	-8767		
25 Shtator	-5880	0	0	-5880	-570	0	-570	-1872	-405	0	-2277	-8727		
26 Shtator	-5880	0	0	-5880	-570	0	-570	-1872	-301	0	-2173	-8623		
27 Shtator	-480	0	0	-480	-750	0	-750	-1872	-216	0	-2088	-3318		
28 Shtator	-480	0	0	-480	-750	0	-750	-1872	-236	0	-2108	-3338		
29 Shtator	-480	0	0	-480	-915	0	-915	-1992	-405	0	-2397	-3792		
30 Shtator	-480	0	0	-480	-825	0	-825	-1992	-405	0	-2397	-3702		
31 Shtator														
TOT	-52,056				-23,982			-55,424	-11,819					

Ne shkresen nr. 4693 Prot., date 09.10.2012, OST sh.a, na ve ne dijeni se “CEZ Shperndarje e ka ulur importin ne zero, dhe ne keto kushte e gjithë kërkesa per energji elektrike po perballohet pothuajse nga rezerva e kaskades se Drinit., Po ashtu OST sh.a me shkresen nr. 4498, Prot., date 27.09.12 drejtuar CEZ Shperndarje sh.a, METE dhe per dijeni ERE-s, thekson se “Verejme se sot importi (nga CEZ) per daten 26 Shtator 2012 eshte deklaruar ne nivelin 20 MWb. Verejme se CEZ Shperndarje sh.a. nuk ka marre asnje mase per respektimin e ligjit nr 9072, date 22.05.2003 „Per sektorin e energjise elektrike“, Modelit te Tregut dhe Kodit te Rrjetit te Transmetimit... Sikurse informon KESH sh.a, vazhdimi i nje situate te tille do ta coje rezerven energjitike drejt nivelit zero,,.

CEZ me shkresen nr 6092/2, date 28.09.2012, parashtrohet pamundesine e shoqerise per te garantuar importin e energjise per mbulimin e humbjeve ne kushtet kur furnizuesit kane nderprere furnizim dhe kerkojne parapagim per livrime te metejshme te energjise dhe njeh te gjitha detyrimet ndaj KESH si per pjesen e energjise per mbulimin e humbjeve ashtu edhe detyrimin financiar. Po ne kete shkrese CEZ Shperndarje sh.a. kerkon se fundmi “*qe KESH te marre masat e nevojshme per te vepruar si furnizues i alternatives se fundit*”, pra cka nenkupton qe heq dore nga sigurimi i energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne sistemin e shperndarjes.

ERE me shkresen nr .636/1, date 03.10.2012, udhazon shoqerine CEZ Shperndarje qe te ule nivelin e shpenzimeve per zera te tjere dhe te fokusohet ne kryerjen e shpenzimit per prokurimin e energjise. Ky Udhëzim rrjedh edhe *nga analiza e te dhenave te raportuara per Cash Flow te muajit shtator, ku konstatohet se pagesat jane kryer per shërbimet te tjera si: mbledhje e debitoreve, kontrata leasing, CEZ AL, zyrat e permbarimit, paga dhe konsulenca.*

Per me teper, ne vazhdim te shqetësimeve te ngritura nga ana e saj OST sh.a me shkresen nr. 4517/3, date 4.10.2012, ne cilesine e operatorit te tregut, i gjen te pambeshtetur te gjithë argumentat e CEZ Shperndarje ne lidhje me paaftesine financiare per mbulimin e humbjeve. OST thekson qe “kompania duhet ti gjej shkaqet e verteta brenda kompanise pa ja ngarkuar fajin entiteve shteterore apo rregullatore sepse me gjithë përpjekjet qe u bene, shkak per mosrealizimin e marreveshjes per shuarjen me kompensim te detyrimeve te ndersjellta midis institucioneve buxhetore e jobuxhetore, shoqerive te kontrolluara nga shteti e CEZ shperndarje sipas marreveshjes se dates 28.2.2012, te miratuar me VKM nr 154 dt 29.2.2012, eshte vete CEZ Shperndarje. Keshtu me gjithë përpjekjet dhe angazhimin serioz te institucioneve shteterore, perseri CEZ Shperndarje deshtoi ne permbushjen e detyrimeve te tij, qe benin efektive kete marrëveshje”. Per me teper cilesohet se

“detyrimet e CEZ Shperndarje ndaj OST e KESH sh.a. tejkalojne shume here me teper vleren e detyrimit nga kompanite buxhetore e jo-buxhetore. Administrimi i shoqerise aksionere duhet te behet ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.4.2008, i cili eshte pergjegjesi e organeve te shoqerise dhe nuk mund ti ngarkohet te treteve ne menyre te drejtperdrejte”.

Ne vazhdim, OST me shkresen nr. 4693, date 9.10.2012 “mbi situaten hidroenergjetike”, deklaroi se “Furnizimi i konsumatoreve me energji elektrike vazhdon normalisht, por kjo po sjell zvogelimin me shpejtesi te rezerves hidroenergjetike te kaskades per shkak te uljes ne zero se importit nga ana e CEZ”. Ky shqetesim bazohet ne faktin se prodhimi i energjise ne kushtet e nje niveli te ulet te liqenit te Fierzes, sjell zvogelimin e ndjeshem te rendimentit te ketij HEC-i.

Nderkohe CEZ Shperndarje me shkresen nr. 6254/1, date 3.10.2012, vetem njofton qe nuk eshte ne gjendje te rrise importin dhe eshte ne pritje te instruksioneve te ERE-s, duke mos vleresuar gjendjen e rende te sistemit elektroenergjetike, te sigurise se furnizimit te konsumatoreve tarifore dhe per me teper nuk jep asnjë zgjidhje dhe nuk paraqet asnjë plan per përmbushjen e këtij detyrimi ligjor dhe kushteve te Licenses.

Gjithashtu dhe KESH me shkresen nr. 4731, date 26.10.2012, shpreh shqetësimin se detyrimet e CEZ Shperndarje ndaj KESH mberrijne ne 16 miliard leke, duke perfshire edhe detyrimin e vitit 2011, nderkohe qe nuk importon energji per humbjet dhe nuk ben pagesa per energjine e furnizuar nga KESH sh.a. I ndodhur para kesaj suate, KESH kerkoi nderhyrjen e ERE-s dhe institucioneve te tjera shqiptare per zgjidhjen e kesaj suate.

ERE perseri me shkresen nr. 295/6, date 27.09.2012, kërkon qe CEZ te permbushi detyrimet per importin ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Nisur nga keto rrethana, KESH plotesoi jo vetem te gjithë kërkesen për energji elektrike për konsumatorët tariforë, por edhe sasinë e energjisë elektrike që i korrespondon humbjeve në sistemin e shpërndarjes, (te pasiguruara nga CEZ Shpërndarje) përmes gjenerimit vendas dhe në mungesë të gjenerimit vendas të importojë energji elektrike për llogari të shoqërisë CEZ Shpërndarje, siç përcaktohen në VKM 633, datë 3.10.2012.

Po ashtu, me shkresën Nr. 7689 Prot, datë 13.12.2012, mbi procedurën e tenderit vjetor për prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për 2013, citohet se: *CEZ Shpërndarje vazhdoi të bente përpjekjet maksimale dhe ndërmori negociatat të mëtejshme me ofertuesit (si dhe me furnizuesit e tjere potencial) në mënyrë që të përmbylleshin kontratat e blerjes së energjisë elektrike, në bazë të së cilave CEZ shpërndarja do të furnizohej me sasinë e mjaftueshme të energjisë për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2013.*

Të gjendur në të njëjtat kushte, Këshilli i Ministrave, u detyrua të miratojë vendimin e dytë për lejimin e KESH sh.a që të importojë energji elektrike për mbulimin e humbjeve edhe për periudhën janar-shkurt 2013. (VKM nr. 924, datë 26.12.2012)

Në tabelën nr. 2 të mëposhtme paraqiten importet e kryera nga shoqëria CEZ Shpërndarje gjatë periudhës 2010 - 2012, krahasuar me humbjet totale në shpërndarje gjatë këtyre viteve.

Tabela nr. 2

Rezultatet e importeve nga raportimet mujore te CEZ Shperndarje per periudhen 2010 - 2012

HUMBJET DHE BLERJET NGA CEZ Shperndarje PER MBULIMIN E TYRE 2010-2012 (nentor)									
	VITI 2010			VITI 2011			VITI 2012		
	Energji e Blere per Mbulimin e Humbjeve MWh	Humbjet Totale ne Shperndarje MWh	Diferenca Marrje me teper nga sistemi FPSH	Energji e Blere per Mbulimin e Humbjeve MWh	Humbjet Totale ne Shperndarje MWh	Diferenca Marrje me teper nga sistemi FPSH	Energji e Blere per Mbulimin e Humbjeve MWh	Humbjet Totale ne Shperndarje MWh	Diferenca Marrje me teper nga sistemi FPSH
Janar	235,176	256,293	-21,117	130,200	375,213	-245,013	111,600	418,319	-306,719
Shkurt	170,016	213,155	-43,139	194,880	220,258	-25,378	278,400	402,298	-123,898
Mars	181,243	220,390	-39,147	196,957	218,516	-21,559	370,037	329,696	40,341
Prill	154,800	153,056	1,744	218,160	112,144	106,016	237,600	244,308	-6,708
Maj	149,352	160,619	-11,267	228,048	119,493	108,556	166,320	188,100	-21,780
Qershor	75,696	140,106	-64,410	116,496	96,072	20,424	151,200	194,754	-43,554
Korrik	175,080	130,322	44,758	111,600	108,928	2,672	79,512	244,318	-164,806
Gusht	200,880	147,675	53,205	111,600	100,686	10,914	186,929	246,023	-59,094
Shtator	200,368	93,665	106,703	147,600	106,800	40,800	53,194	197,637	-144,443
Tetor	156,495	99,757	56,738	111,750	125,884	-14,134	22,896	172,217	-149,321
Nentor	130,455	111,692	18,763	108,000	184,672	-76,672	0	229,672	-229,672
Dhjetor	155,646	184,222	-28,576	139,104	237,529	-98,425			
Total	1,985,207	1,910,952	74,255	1,814,395	2,006,195	-191,800	1,657,688	2,867,342	-1,209,654
Energji e pafaturuar						-156 266			
Dem ekonomik						-278 668			
Diferenca marrje me teper nga sistemi 2011						-626 734			

Sic shikohet edhe nga tabela, detyrimi i CEZ Shperndarje sh.a. ndaj KESH sh.a., per periudhen 2010-2012, rezulton nje difference prej 1.762.133 MWh, duke mos perfshire edhe detyrimin e “ndjeshem” te krijuar ne muajin dhjetor 2012.

Gjitha keto shifra tregojne qarte shkeljet nga ana e CEZ Shperndarje te kushteve te licenses dhe Modelit te Tregut, te paraqitura ne kete raport.

Pretendimet e CEZ Shperndarje sh.a.

Ne lidhje me këtë shkelje te Kushteve te Licences dhe Modelit te Tregut, shoqëria CEZ Shpërndarje, ne pergjigjen e paraqitur me 17 Dhjetor 2012, pretendon se gjate vitit 2012 ka importuar nje sasi energjie me te madhe sesa sasia e njohur nga ERE per qellim te llogaritjes se tarifave te vitit 2012. Sasia e humbjeve te njohura nga ERE per llogaritjen e tarifës është 1.293 GWh, ndersa CEZ Shperndarje ka importuar deri ne Shtator 2012, 1.658 GWh.

CEZ Shperndarje pretendon se ERE nuk ka dhene mjaftueshem shpjegime ne lidhje me konstatimin ku shprehet se ka vene re “disa deformime te tregut te shkaktuara nga CEZ Shperndarje si pasoje e shkeljes se kushteve dhe afateve te licenses per shpërndarjen e energjië elektrike dhe te licenses per furnizimin publik me pakice te energjië elektrike, si dhe deshtimin e CEZ Shperndarje ne rivendosjen e funksionimit normal te tregut dhe te veprimtarive te shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice. Gjithashtu kjo sjellje kundrejt pjesemarresve te tjere te tregut u ka shkaktuar atyre veshtiresi financiare”.

Sikurse i është bere e ditur ketij subjekti gjate gjithë komunikimeve qe ERE ka patur me te, por edhe sic pershkruhet ne relacionin shoqerues te vendimit te ERE-se per fillimin e procedurave per heqjen e licenses, nr. 158, date 16 Nentor 2012, ne legjislacionin ne fuqi percaktohet detyrimi i CEZ Shperndarje per te prokuruar te gjithë energjië e elektrike per mbulimin e humbjeve reale (faktike) ne sistemin e shperndarjes, pavaresisht sasise se njohur nga ERE per qellim te llogaritjes ne tarife.

Pretendimi i CEZ Shperndarje se kjo shoqeri ka importuar energji me shume sesa i ka njohur ERE per efekt te llogaritjes se tarifave eshte teresisht i pabazuar ligjerisht, pasi kjo shoqeri ka detyrimin dhe pergjegjesine e prokurimit dhe sigurimit te te gjitha sasise se energjise se nevojshme per te mbuluar humbjet reale ne sistemin e shperndarjes.

Per sa i perket sasise se njohur per efekt te llogaritjes se tarifave eshte nje vendim i marre nga ERE ne perputhje me sa percaktuar ne Deklaraten Rregullatore, ku ne piken 4.5 eshte percaktuar nder te tjera llogaritja e nivelit te lejuar te humbjeve (qe perfshihen ne kostot e njohura nga rregullatori permes tarifes perkatese) vendosja e targetave per reduktimin e humbjeve, dhe ulja e humbjeve pertej ketyre targetave eshte incentive e kompanise.

Po ashtu edhe vete CEZ Shpërndarje ne përgjigjen ndaj vendimit 158, date 16 nentor 2012, pasi pretendon se ka realizuar importin e plote te humbjeve per sa njohur ne tarife, ne sqarimin ne paragrafin e radhes shpjegon se edhe ajo vet eshte ne dijeni se ka per detyrim per te mbuluar te gjitha humbjet ne sistemin e shperndarjes. Ne faqen 7, paragrafi i pare te pergjigjes, shprehet qe si rrjedhoje e situates financiare, CEZ Shperndarje nuk ishte ne gjendje te merrte asnje angazhim shtese kundrejt furnizuesve/tregtareve ne menyre qe te rriste sasite e energjise se importuar ne rrjet deri ne nivelin e kerkuar nga ERE per mbulimin e humbjeve reale ne sistemin e shperndarjes.

Gjithashtu, vete CEZ me shkresen nr. 6092/2, date 28.09.2012, shprehet se “CEZ i njeh te gjitha detyrimet ndaj KESH si per pjesen e energjise per mbulimin e plote te humbjeve ashtu edhe detyrimin financiar”. Ne vijim CEZ Shperndarje qe KESH te marre masa e nevojshme per te vepruar si furnizues i alternatives se fundit, cka nenkupton furnizimin me energji elektrike per mbulimin e humbjeve.

Ky qendrim kontradiktor (ku njehere pretendohet per realizim te prokurimit te energjise elektrike per mbulimin e humbjeve sipas nivelit te njohur nga ERE ne tarife dhe nga ana tjeter pretendohet se nuk mund te importonte me shume per mbulimin e humbjeve reale, per shkak te situates fianciare dhe vendosjes se kushteve te papranueshme nga tregtaret, ne dijeni te situates financiare te CEZ Shperndarje), vihet re edhe ne vijim ku CEZ Shperndarje paraqet perpjekjet qe ka bere per te realizuar importin e sasise se energjise elektrike te nevojshme per te mbuluar humbjet ne rrjetin e shpenrdarjes, duke zhvilluar per kete qellime tendera per blerjen e enrgjise elektrike per periudhen 2012-2013, tendera te cilet kjo kompani ka vendosur ti anulloje per shkak te ofertave te kushtezuara, sic shprehet ne shkresen nr. 7689, Prot.,date 13.12.2012.

Po ashtu ne sancen degjimore te zhvilluar ne daten 5 Shtator 2012, ne prani te METE, KESH, OST dhe perfaqesuesve te Sekretariatit te Komunitetit te Energjise ne Vjene, nga ana e shoqerise CEZ Shperndarje eshte pranuar nevoja per import te energjise elektrike per mbulimin e plote te humbjeve dhe eshte premtuar qe do realizohej ky import, dhe konkretisht drejtuesi i shoqerise CEZ Shperndarje sh.a. Z. Macek deklaroi se *“ne nuk ndaluam importet duke dashur qe te mos importojme por situata e kompanise na coji qe ne nuk importojme dot.”*

Ne seancen degjimore te dates 6 Mars 2012, CEZ Shperndarje sh.a. shprehet *“detyrimi jone per energjine qe nuk i kemi paguar furnizuesve eshte rreth 11 milion euro kjo ka te beje me sasite e energjise te shperndara qe ne shkurt, dhe pritet qe kjo shume te rritet pasi ne po vazhdojme te importojme energji dhe prandaj ne presim nje ndihme nga burime te jashtme, prandaj per tenderat qe jane ne vazhdim ne I kemi anuluar ato dhe nese ne nuk do te marrim financime nga burimet e jashte kompanise atehere ... situata eshte e keqe dhe do te behet akoma me e keqe nese kontraktori*

jone EFT do te ndaloje sherbimin sepse ne nuk kemi permbushur detyrimin ndaj tyre.” (Procesverbali bashkelidhur)

CEZ Shperndarje ne pergjigjen e Vendimit nr. 158, lidhur me prokurimin e energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes, shprehet se gjate muajit shtator 2012 jane bllokuar llogarite bankare te saj nga shoqerite EFT Albania , KESH dhe OST, bllokime dhe sekuestreime keto qe kane vonuar ose penguar pagesen e debitoreve te tjere te shoqerise.

Ne analize te ketij deklarimi verehet se aktet (urdhra ekzekutimi) te pretenduara si penguese nga kompania per shlyerjen e debitoreve te tjere te CEZ Shperndarje, se pari jane te nderrmarra ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi pasi ne ne baze te ligjit nr. 10486 date 26.11.2011 “Per nje ndryshim ne ligjin nr.8662 date 18.09.2000 “Per trajtimin si titull ekzekutiv te fatures se konsumit te energjise elektrike” faturat e shitjes, blerjes dhe faturat e shërbimit te transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike perbejne titull ekzekutiv. Pra kemi te bejme me veprime te nderrmara nga keto shoqeri ne kushtet e mosekzekutimit vullnetarisht te detyrimeve financiare te CEZ Shperndarje ndaj subjekteve te tjera si EFT Albania, apo KESH sh.a dhe OST sh.a.

CEZ Shpërndarje konsideron te pamjaftueshme edhe vendimet e Bordit te Komisionereve nr. 111, date 31 Korrik 2012, “Mbi kapacitetet e interkonjeksioneve ne drejtimin import per muajin gusht 2012” dhe 114 i dates 22 Gusht 2012, “Mbi kërkesën e CEZ Shpërndarje sh.a për moszhvillimin e ankandit të kapaciteteve në drejtimin import muajt shtator, tetor, nëntor, dhjetor, të vitit 2012”, me ane te te cilave vendosej alokimi pa ankand i kapaciteteve te interkonjeksionit për këtë shoqëri.

Lidhur me kete sqarojmë se CEZ Shpërndarje sh.a. anashkalon faktin se zgjidhja e dhene nga ERE ne vendimet e sipërcituara nr. 113, dhe nr. 114 ishte produkt i kerkeses se parashtruar nga CEZ Shperndarje sh.a e cila ne kerkesen e paraqitur ne ERE deklaronte se do te rritej mundesia e saj per te kontraktuar energji elektrike per mbulimin e humbjeve nese kapacitetet do te jepeshin te siguruara ketij subjekti. Ne lidhje me ceshtjen e kapaciteteve te siguruara CEZ Shperndarje nuk ben gje tjeter vecse ankohet per zgjidhje te propozuara nga ajo vet dhe te miratuara nga ERE me qellim krijimin e kushteve me te favorshme kesaj shoqerie per ushtimin e aktiviteteve te licensuara.

Mbeshtetur ne sa parashtruar dhe argumentuar mesiperm, ERE gjykon CEZ Shperndarje nuk ka permbushur detyrimin e percaktuar sipas Kushteve te licenses per prokurim te plote te sasise se energjise elektrike per mbulimin e te gjitha humbjeve ne sistemin e shpërndarjes.

2. Mosrealizimi i objektivave per nivelin e reduktimit te humbjeve dhe rritja e metejshme e ketij niveli

Baza Ligjore

Marreveshja SPA - Oferta Teknike Projektit te Privatizimit te OSSH date 26 shtator 2008 nga CEZ a.s., Plani i Biznesit.

Pika 4.8 Modeli i Tregut, OSSH-ja eshte pergjegjese per reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike ne sistemin e shperndarjes, sipas kushteve te percaktuara nga ERE-ja. ERE-ja mund te percaktojë per OSSH-ne nje tarife qe siguron incentiva per reduktimin e ketyre humbjeve.

Licensa e Shperndarjes

Pika 2.7 I Licensuari do ta kryejë Veprimtarinë e Licensuar në përputhje me parimet e eficientes ekonomike dhe objektivin e arritjes së kostos me të ulët me standarde të përcaktuara të cilësisë dhe performancës.

Pika 3.1 I Licensuari do të respektojë Legjislacionin në Fuqi gjatë ushtrimit të funksioneve sipas kësaj License.

Pika 3.4 I Licensuari do të ndermarre të gjithë masat e nevojshme për përmirësimin e eficientes operative dhe ekonomike të Veprimtarisë së Licensuar me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të shpërndarjes në përfitim të klienteve, dhe sipas Kodit të Shpërndarjes.

Pika 3.16.5 I Licensuari duhet të përgatitë një program për të arritur uljen e targetave të humbjeve ashtu siç është vendosur në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të shpërndarjes apo nga ndonjë vendim tjetër i ERE-s.

Pika 3.17.2 Plani duhet fokusuar në zhvillimin, rindertimin dhe rehabilitimin e rrjetit të të licensuarit me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj klienteve. Duhet të përfshijë por nuk duhet të kufizohet me sa më poshtë:

c. Një program që synon reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në Rrjet.

Pika 4.7 I Licensuari është përgjegjës për zbulimin dhe parandalimin e vjedhjes së energjisë.

Qëllimi i shtetit Shqiptar për privatizimin e OSSH, ishte të zgjidhte një Investitor Strategjik që të kishte kapacitetet që ndërmjet të tjerave të ulte humbjet në shpërndarje dhe të krijonte një shoqëri furnizuese të energjisë të qëndrueshme dhe të besueshme.

Si pjese integrale e paketes se privatizimit jane edhe dokumentet e tenderit dhe cdo reference ne ligjet dhe rregulloret qe jane direkt detyruese per CEZ a.s., si Investitorit Strategjik.

Sipas dokumenteve të tenderit (Oferta Teknike e Projektit te Privatizimit te OSSH date 26 shtator 2008 nga CEZ a.s., Plani i Biznesit) detyrimet që duhet të kryente CEZ as si Investitori strategjik janë si më poshtë:

- Transferimi i know-how nga eksperiencia e tij në drejtim të zhvillimit të shpërndarjes dhe furnizimit (nga Hyrje dhe Përmbledhje Ekzekutive (fq. 3));
- Reduktimi i humbjeve (nga Hyrje dhe Përmbledhje Ekzekutive (fq. 3));
- Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe arketimit (nga Hyrje dhe Përmbledhje Ekzekutive (fq. 3));
- Planet e menaxhimit të burimeve njerëzore (nga Hyrje dhe Përmbledhje Ekzekutive (fq. 3));
- Struktura organizative të përafrohet sipas modelit te praktikave më të mira te CEZ Group (nga planet për përmirësime të sistemit (fq. 6));
- reduktimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike, duke përfshirë investimet në pajisje të shpërndarjes, infrastruktures për monitorimin dhe parandalimin (nga Plani për uljen e humbjeve teknike dhe jo-teknike (fq. 8-9).

Pra CEZ a.s. ishte i vetëdijshëm se angazhimet dhe detyrimet e saj si investitor strategjik do të kryheshin nëpërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, si aksioner kryesor i operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Gjithashtu ne baze te Dokumentit te Ofertes Teknike te vitin 2008, ne faqe 3 te saj, CEZ a.s si nje insvestues strategjik kishte per qellim uljen e humbjeve dhe gjithashtu

ne faqe 8 te këtij Dokumenti, reduktimin e humbjeve teknike dhe jo teknike, duke perfshire investime ne pajisje te shperndarjes, infrastrukture monitoruese dhe parandaluese duke bere edhe detajim te menyrove per tja arritur ketij qellimi.


Detyrimi i CEZ Shperndarje per uljen e humbjeve eshte gjithashtu i shprehur ne Deklaraten Rregullatore, pika 4.5 - Objektivat per uljen e humbjeve

“ERE pret nje permiresim te shpejte ne nivelin e humbjeve jo – teknike, dhe nje ulje me te ngadalshme por te vazhdueshme te humbjeve teknike ne rrjetin e shperndarjes. ERE parashikon uljen e humbjeve totale ne sistemin e shperndarjes sipas skenarit ne vijim:

- 4% (pike perqindje) ulje per periudhen e pare te rregullimit;
- 4% (pike perqindje) ulje per periudhen e dyte te rregullimit;
- 9% (pike perqindje) ulje per periudhen e trete te rregullimit (3*3%).”

Grafiku ne vijim paraqet krahasimin e targeteve te humbjeve te vendosura nga ERE, ne zbatim te Deklarates Rregullatore, krahasuar me realizimin faktik te humbjeve nga ana e shoqerise CEZ Shperndarje sh.a (sipas raportimeve te vete kompanise) per periudhen 2008-2012.

Tabela nr. 3



Pra sic shihet qarte nga tabela, humbjet ne kundershtrim me qelimin dhe detyrimet e privatizimit kane ardhur duke u rritur dukshem.

ERE duke u bazuar edhe në Deklaratën Rregullatore pika 4.5 “Objektivat e Reduktimit të Humbjeve”, për vitin 2012 ka njohur në tarife vetëm nivelin e pranuar te humbjeve sipas skedultite reduktimit te humbjeve te aprovuar nga ERE. Pra nga ana e ERE-s, per efekt te llogaritjes se tarifes, janë njohur vetëm 23.92% humbje ne vitin 2012, në rrjetin e shpërndarjes të cilat janë 11.35 Miliard lekë. Ndersa, diferenca ndermejt nivelit aktual te humbjeve nga ato te njohura nga ERE, do te mbulohen nga vete shoqëria CEZ Shperndarje dhe qe i korrespondojne nje vlere rreth 15 miliarde leke.

CEZ Shperndarje pretendon se niveli i humbjeve para privatizimit te OSSH nuk ka qene real.

Lidhur me kete pretendim sqarojme se:

Nga ana e ERE ne analize te kerkeses se OSSH⁴, date 27.04.2010 dhe ne kuader te rezultateteve te monitorimeve te kryera nga ERE ne zonat e shperndarjes se OSSH, duke konstatuar se Auditi i Humbjeve i kryer nga Arthur D. Little, nuk arriti te verifikonte dhe te percaktonte nivelin e humbjeve totale per vitin 2008 ne sistemin e shperndarjes per shkak te kohes se shkurter per verifikime dhe pamjaftueshmerine e dokumentacionit dhe te te dhenave si dhe per qellim te llogaritjes se tarifave te energjise elektrike per vitin 2010 pranoi nivelin e deklaruar te humbjeve per vitin 2008 ne masen e deklaruar nga OSSH (perpara privatizimit) ne nivelin 32.74%, duke e lene te hapur te drejten per tu shprehur ne kuader te te dhenave qe do te rezultonin e verifikoheshin ne vijim. Ne kete kuader edhe ne baze te monitorimit te kryer nga ERE gjate te cilit u verejten elemente te tille si vetkonsumi i OSSH sha, mbifaturimeve te ndryshme, efektet e kufizimeve te furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve, te cilat ndikonin ne nivelin e humbjeve ne shperndarje dhe nuk ishin marre ne konsiderate ne nivelin e humbjeve te pranuar sipas Deklarates Rregullatore, Bordi i Komisionereve me Vendimi 46, date 14.06.2010 percaktoi nivelin e humbjeve te pranuar per OSSH per vitin 2008, per efekt te vendosjes se objektivave te humbjes per tre periudhat rregullatore (2010-2014) sipas Deklarates Rregullatore dhe te llogaritjes se tarifes se shperndarjes ne 33.92 %. Efektet financiare te ketij vendimi u axhustuan ne vijim permes parimit te kompensimit sipas Deklarates Rregullatore. Sqarojme se ky vendim nuk eshte kundershtuar apo ankimuar nga asnje subjekt, perfshire edhe CEZ Shperndarje qofte administrativisht apo dhe ne rruge gjyqesore.

Ne vazhdim, ne pergjigjen e CEZ Shperndarje eshte deklarimi ne lidhje me pretendimet e Albpetrol sh.a dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a për mbifaturime te

⁴ Shih Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE, nr. 46, date 14.06.2010, "Mbi kerkesen e OSSH sh.a, lidhur me nivelin e humbjeve te energjise elektrike per vitin 2008".

vazhdueshme, pretendime me te cilat CEZ Shperndarje kerkon te perligje deklarimin e saj per nivele jo reale te humbjeve para privatizimit. CEZ Shperndarje ne komunikimet me ERE-n ne lidhje me pretendimet e subjekteve Albpetrol sh.a, Ujesjelles Kanalizime, nuk i pranon pretendimet per mbifaturime te ketyre subjekteve me gjithë ankesat e perseritura te tyre, duke mos reflektuar korrigjime te mundshme te faturave te ketyre subjekteve.

Si konkluzion Cez Shperndarje nuk e ka zbatuar detyrimin e tij per te ulur humbjet ne rrjetin e shperndarjes duke thelluar ndjeshem (me shume se ai i njohur nga ERE per vitin 2008) diferencen ndermjet targeteve te vene per nivelin e humbjeve dhe humbeve reale ne rrjet.

3. Mos zbatimi i Planit te Investimeve te miratuar nga ERE

Baza Ligjore:

- Marreveshja e Shitjes Blerjes se Aksioneve (SPA)- Dokumenti i Ofertes se vitit 2008 CEZ a.s

-Licensa e Shperndarjes:

Pika 3.17 - Plani i zhvillimit te operimeve

3.17.2 Plani duhet fokusuar ne zhvillimin, rindertimin dhe rehabilitimin e Rrjetit te te Licensuarit me qellim permiresimin e sherbimit ndaj klienteve. Duhet te perfshije, por nuk do te kufizohet me sa me poshte:

a) Nje program ndertimi;

b)Nje program investimi me analiza tekniko - ekonomike dhe financiare per projektet e investimit;

- c) *Nje program qe synon reduktimin e humbjeve te energjise elektrike ne Rrjet;*
- d) *Nje program mirembajtje per te siguruar, se bashku me programin e investimit, operim me te qendrueshem te Rrjetit;*
- e) *Treguesit e cilesise se sherbimit dhe nje program per te arritur synimet;*

Pika 4.6- I Licensuari do t'u bindet vendimeve te nxjerra nga ERE

Në lidhje me reduktimin e humbjeve, te përcaktuar ne Dokumentin e Ofertes se vitit 2008 CEZ a.s ishte "plotësisht e angazhuar për të ulur humbjet" në mënyrat e mëposhtme:

- Linjat 110 kV dhe nenstacionet 110/10 kV qe jane ekzistuese do të rindërtohen dhe forcohen;
- Do të blihet një numër i madh i bokseve një fazore individuale për konsumatorët shtëpiake dhe bokseve tre-fazore për konsumatorët privatë, si dhe një numër panelesh me transformatorë matës për konsumatorët privatë;
- Zhvillimi i rrjeteve të shpërndarjes dhe të nënstacioneve në qytetet kryesore të Shqipërisë dhe zonat me te populluara rurale;
- Zevendesimi i transformatorëve të prodhuar me teknologji të vjetër (me konstruksione çeliku dhe të bakri që rezultojnë në humbje të mëdha) me transformatorë te rinj humbjet e te cileve janë nën 2%;
- Matja e energjisë reaktive për konsumatorët me kapacitet mbi 50 kV, pasi kërkesa për këtë kategori të konsumatorëve eshte identifikuar dhe plani për blerjen e paneleve mates me matesa elektronike aktive / reaktive;
- Vazhdimi i punëve tashmë te filluara për pajisjen e kabinave elektrike me matësa të energjisë aktive dhe reaktive dhe sigurimin e kabinave të reja me matesa;

- Investime shtesë në rrjete dhe teknologjine e linjave për të rritur seksionet e përcjellesave dhe për të zvogëluar humbjet teknike dhe minimizuar ndërhyrjet në rrjet;
- Korrigjimin e rregullave në Kodin Matjes për të trajtuar (I) saktësinë e matjeve, leximin e matesave, dhe regjistrimin e të dhënave; (ii) shërbimi i matjes duhet të vulozet; dhe (iii) mbrojtjen e sistemit të matjes nga ndërhyrjet dhe demtimet, me qëllim mbrojtjen e sistemit mates dhe minimizimin e vjedhjeve të energjisë;
- Përmirësimi i cilësisë së Sistemit të Shpërndarjes (përfshirë frekuencën dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve).
- Në Planin e Biznesit, CEZ a.s. deklaroi "planifikon të zbatojë një program investimesh për të siguruar që cilësia dhe siguria e shërbimeve të shpërndarjes dhe furnizimit të ofruara nga kompania të rriten vazhdimisht në standardet e industrisë." Elementet kryesore të këtij programi të investimeve ishin:
 - Kufizimi i kohës së mosfurnizimit të konsumatorit me energji elektrike;
 - Optimizimi i kostove të shpërndarjes së energjisë elektrike;
 - Lidhja e të gjithë klientëve të rinj;
 - Rindërtimi, modernizimi dhe zgjerimi i pajisjeve ekzistuese për shpërndarjen e energjisë elektrike;
 - Rinovimi dhe rindërtimi i stacioneve ekzistues të transformatorëve të shpërndarjes;
 - Pajisje për matjen e konsumit të energjisë elektrike;
 - Maksimizimi i arketimeve dhe realizimit të të ardhurave (modernizimi i sistemeve të faturimit, sistemeve të shërbimit të klientit, dhe pajisjeve matëse). Në këtë drejtim, CEZ a.s. rendit si "prioritet të parë" qëllimin e saj për të përmirësuar mbledhjen e të

ardhurave dhe për të vënë më shumë theksin në zbatimin e një modeli të centralizuar të menaxhimit të të dhënave të konsumatorëve;

- Levizja / trajnimi personelit dhe ceshtje të tjera të Burimeve Njerëzore dhe
- Çështjet mjedisore.

Si dëshmi e angazhimit të saj për të investuar dhe për të përmirësuar këto aspekte të operatorit të sistemit të shpërndarjes, CEZ a.s. deklaroi në Planin e Biznesit që: "objektivi kryesor i CEZ sapo të bëhet pronar i shumicës së aksioneve të OSSH-së është që t'u ofrojë klientëve të saj një nivel të mjaftueshëm të shërbimeve dhe të jetë në gjendje të: (1) të ketë një menaxhim vendimtar dhe efektiv të çështjeve që kanë lidhje me borxhin e keq, krijimin e një departamenti të veçantë që do të trajtojë debitorët e keqij, si dhe do të përmirësojë efektivitetin e mbledhjes së parasë në afat të shkurtër dhe (2) për t'u përgjigjur nevojave në rritje të këtyre grupeve të konsumatorëve në lidhje me hartimin e tarifave të përshtatshme, kushtet e pagesës, mënyrën e pagesës, transparencën e faturimit në afat të gjatë."

Si rrjedhojë e këtyre detyrimeve, ERE me anë të Vendimit nr. 143 datë 07.12.2011, të ndryshuar, "Për Miratimin e Planit të Investimeve", miratoi planin e investimeve për vitin 2012. Nga të dhënat paraqitura të monitorimit të kryer se fundmi dhe siç deklarohet nga vet kompania në raportimet periodike në ERE, për vitin 2012, ka realizuar rreth 7% të planit të miratuar të investimeve. Siç shihet nga tabelat e mëposhtme shoqëria CEZ Shpërndarje nuk ka realizuar planin e investimeve ashtu siç miratuar nga ERE edhe për vitet 2010 dhe 2011.

Tabela nr. 4

Ecunia e investimeve 2010 – 2012

ECURIA E INVESTIMEVE NGA CEZ -SHPERNDARJE 2010-2012 (LEKE)					
2010		2011		2012	
Miratur nga ERE	Realizuar	Miratur nga ERE	Realizuar	Miratur nga ERE	Pritet Realizim
4,338,598,498	4,702,815,306	4,896,000,000	1,946,563,308	6,500,473,000	934,064,632

Sqarojme se ne vitin 2010, shifra e paraqitur ne tabelen me lart dhe ne grafikun me poshte qe ka lidhje me investimet e realizuara nga shoqeria CEZ Shperndarje perfshijne edhe transferimet e asetave nga e KESH sh.a dhe OST sh.a. Shifra e investuar faktikisht nga shoqeria CEZ Shperndarje eshte paraqitur ne tabelen nr. 6 dhe eshte ne vleren 2,259,494,049 leke.

Tabela nr. 5




Tabela nr. 6

Investime Fakt	2009	2010	2011	2012 (deri 31.08.2012)	Total
Land with Buildings	-	22,475,213	0	0	22,475,213
Land improvements and arrangements	-	266,708,226	0	0	266,708,226
Technical Buildings	33,455,483	332,811,133	42,850,591	855,343	409,972,550
Construcion	-	147,741,548	302,204	0	148,043,752
Other Machinery and Equipments	66,228,727	1,855,336,166	334,012,245	75,381,446	2,330,958,584
Transformatore	414,307,671	795,607,513	88,458,210	23,983,825	1,322,357,219
Linja ajrore(TL)	-	67,389,009			67,389,009
Linja ajrore(TM)	-	249,476,707	174,653,806	1,304,767	425,435,280
Dispeceria dhe kontr.sistemit	-	0			-
Linja nentokesore (TM)	-	0	108,771,296	591,670	109,362,966
metering	56,921,488	749,625,993	990,857,154	529,430,269	2,326,834,904
Heavy dutie vehicles	1,748,995	13,524,700	6,831,470	2,274,360	24,379,525
Furnitures and fixtures	29,496,642	41,923,088	17,590,861	1,404,766	90,415,357
IT Computer	1,972,657	19,962,843	37,556,891	2,204,682	61,697,073
IT Equipments	13,522,371	118,946,582	95,700,655	2,281,124	230,450,732
Software - intangible asset	0	0	9,264,492	17,555,940	26,820,432
Trade mark, license/intangible			39,713,428	12,039,972	51,753,400
TOTAL (kapitalizime)	617,654,034	4,681,528,720	1,946,563,303	669,308,164	7,915,054,221
Transferta nga KESH dhe OST		2,422,034,671			
TOTAL (Investime te realizuara)	617,654,034	2,259,494,049	1,946,563,303	669,308,164	5,493,019,550
Plani investimeve te miratuara	3,097,739,000	4,338,598,498	4,896,000,000	6,500,473,000	18,832,810,498

Lidhur me realizimin e Planit te Investimeve te miratuar me Vendimin nr. 143 date 07.12.2011, te ndryshuar, CEZ Shperndarje deklaroi se investimet lidheshin me kushtin e sigurimit te finacimit te duhur. Ky financim sic shpjegon CEZ Shperndarje u ra dakort te sigurohej me nje hua nga EBRD dhe IFC ne shumen totale prej 100 milion Euro.

Ne shpjegimet e CEZ Shperndarje gjate takimit te dates 24 nentor 2010 ne ambjentet e ERE-s, ne pranine e perfaqesuesve te EBRD dhe IFC, sic shihet nga prezantimi i tyre (bashkelidhur ne aneksin 3), bankat kerkonin nje angazhim me shkrim te ERE per mos ndryshim thelbesor nga Deklarata e pare Rregullatore, te Deklarates vijuese, miratimi i studimit te Borxhit te Keq , miratimi i rregullores se Demit Ekonomik, dhe kryerja e nje auditi te dyte te humbjeve ne fund te periudhes se Deklarates se pare Rregullatore.

Per keto deklarime te CEZ Shperndarje sqarojme se me shkresen nr. 11/8, date 23.03.2011 u aprovuan nga ana e ERE-s kushtet e kerkuara nga IFC dhe EBRD per kredine 100 milion Euro per CEZ Shperndarje Sh.a, te cilat ishin brenda kuadrit ligjor ne fuqi. Bordi i Komisionereve miratoi termat dhe kushtet e kredise ne te cilat nuk perfshihej asnje kusht per vendosjen si garanci te aseteteve te CEZ Shperndarje per levrimin e kredise.

Sqarojme se ne Marreveshjen e kredise ndermjet CEZ Shperndarje Sh.a dhe Bankes Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Korporata Financiare Nderkombetare (IFC) te nenshkruar me date 30 qershor 2011, eshte perfshire per here te pare edhe opsioni qe huadhenesit mund te kerkojne garanci shtese ne formen e garancise hipotekore. Theksojme se kjo marreveshje nuk i eshte paraqitur ERE-s (dhe ERE nuk e ka miratuar ate si marreveshje) deri ne Shkurt 2012, ku u paraqit vetem pas kerkeses se ERE-s (shkresa e CEZ Shperndarje me Nr. 122/3 Prot, date 23.02.2012). Ne vendimarrjen perkatese qe shqyrtoi kerkesen e CEZ Shperndarje per lenien peng te aseteteve, ERE mbajti qendrimin se ky eshte nje kusht i padiskutuar asnjehere paraprakisht me Rregullatorin, i pa miratuar prej tij dhe per me teper eshte nje garanci shtese e panevojshme ne kushtet kur norma e interesit te kredise e njohur

ne tarife (per periudhen 2012-2014), eshte e larte per shkak te garancise financiare te ofruar nga CEZ a.s.

Per gjithë sa me siper dhe ne menyre te vecante me ane te shkreses nr. 11/8, date 23.03.2011, ERE tregoi nje perpjeke te qarte per te mbeshtetur kompanine ne veprimet e saj per te siguruar sa kerkuar dhe identifikuar prej saj per te realizuar detyrimin per te investuar ne rrejtin e shperndarjes.

Lidhur me mos realizimin e investimeve, *CEZ Shperndarje konsideron ERE-n si pengese*, por nga ana tjeter kjo kompani nuk shpjegon se perse per sigurimin e fondeve te nevojshme per kryerjen e investimeve nuk veproji sipas pikes 4.2 te Deklarates Rregullatore, ku nder te tjera percaktohet se:

“OSSH do te zgjedhe bankat per te siguruar borxhin e ri ne perputhje me procedurat e tenderimit, qe do te propozohen nga vete ajo jo me vone se fundi i Shkurtit 2009. ERE do te miratoje keto procedura jo me vone se Mbyllja e privatizimit te OSSH –se. Keto procedura do te jene te drejta, transparente dhe ne perputhje me ligjet dhe praktiket me te mira. Keto procedura do te jene te vlefshme per periudhen kohore qe mbulon kjo Deklarate Rregullatore. OSSH do te kete gjithashtu te drejten te marre borxh nga huadhenes nderkombetare, duke perfshire pa kufizim EBRD dhe IFC, ne rastin ne te cilin keto procedura tenderimi nuk do te jene te zbatueshme. Kosto e borxhit te ri te marre nga OSSH ne perputhje me keto procedura (ose sipas rastit, te marre nga huadhenes nderkombetare sipas fjalise me siper) do te jete plotesisht e transferueshme ne tarifen perkatese nepermjet modelit te llogaritjes se WACC-ut te shpjeguar ne kete seksion.

Ne rast se borxhi i ri nuk eshte e mundur te perfitohet nepermjet ketyre procedurave te tenderimit, dhe/apo nga institucionet financiare nderkombetare, aksioneret e OSSH-se mund te sigurojne, si burim te fundit, financim shtese per te siguruar mbarevajtjen e veprimtarise se OSSH-se.

Kosto e ketij financimi do te jete e njejte me normen e lejuar te kthimit mbi kapitalin e vet (ARoE), te pershkruar me sipër, dhe do te jete plotesisht e transferueshme ne tarifen e miratuar si komponent borxhi nepermjet modelit te llogaritjes se WACC, sic pershkrubet ne kete seksion. OSSH do te paraqese ne ERE fakte te arsyeshme qe tregojne se ajo ka bere perpjekjet me te mira per perfitim e financimeve te tilla nepermjet ketyre procedurave”.

Njohja e detyrimit nga ana e CEZ a.s. per kryerjen e investimeve

Përveç detyrimeve te percaktuara ne kuadrin ligjor, duke njohur kuadrin ligjor te Marreveshjes se Shitjes se Aksioneve (SPA), CEZ a.s. dhe CEZ Shperndarje sh..a kanë bërë një sere prezantimesh dhe deklarimesh nepermjet te cilave CEZ a.s. ka marre persiper për të realizuar te gjitha detyrimet e marra persiper ne Dokumentat e Ofertes te paraqitur ne 2008 per privatizimin e shperndarjes, si edhe detyrimet kuadrin ligjor rregullator në fuqi.

Me poshte jepen disa fakte te cilat mbeshtesin njohjen dhe pranimin e CEZ Shperndarje per kryerjen e investimeve:

1. Në letrën e CEZ Shperndarje sh.a. derguar ERE-s ne daten 8 mars 2011, CEZ Shperndarje sh.a. pranon se ajo "është e angazhuar dhe është e detyruar për të rritur faturimet dhe uljen e humbjeve." Detyrimi për të rritur faturimin dhe uljen e humbjeve marre persiper nëpërmjet CEZ Shperndarje Sh.a., por eshte marre persiper edhe nga CEZ a.s. sipas Dokumenteve te Tenderit te vitit 2008 dhe Deklaraten Rregullatore, dhe te dyja keto Dokumentave jane pjese e Marreveshjes se Blerjes se Aksioneve dhe si rrjedhim janë të detyrueshme per të.
2. Në letrën e CEZ Shperndarje sh.a. drejtuar Kryeministrit, në datën 16 qershor 2011, CEZ Shperndarje sh.a. deklaronte se "mund të sjellë sa më

shpejt të jetë e mundur 100 mil. EUR në Shqipëri dhe mund të investojë pjesen me të madhe të tyre në rrjetin e shpërndarjes dhe të vazhdojë të përmirësimin e shërbimeve të shpërndarjes të kompanisë CEZ Shpërndarje." Ky angazhim për të investuar në sistemin e shpërndarjes është reflektuar në Dokumentat e Tenderit të 2008 dhe Deklaratën Rregullatore, të cilat të dyja ishin pjesë e Marreveshjes së Blerjes së Aksioneve, dhe për këtë arsye janë të detyrueshme ndaj CEZ a.s., pavarësisht vendimit të tij për të kryer investime nepermjet CEZ Shpërndarje Sh.a." Edhe një herë, angazhimi për të marrë pjesë në stabilizimin e sektorit energjetik është në përputhje me deklaratat e qarta të bëra nga CEZ a.s. në dokumentet e tenderit në vitin 2008. Në këtë mënyrë, CEZ a.s. ka njohur dhe ka pranuar detyrimin e tij për të siguruar funksionimin e duhur të kompanisë shpërndarëse të energjisë elektrike, në përputhje me detyrimet e tij sipas Marreveshjes së Blerjes së Aksioneve dhe kuadrin ligjor përkatës, ose direkt ose nepermejt Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

3. Më tej duke përsëritur njohjen e mësipërme nga CEZ a.s, procesverbali i Bordit të Drejtorëve takimit të CEZ a.s., në datën 21 mars 2012, konfirmon angazhimin CEZ a.s. për të rritur kapitalin duke dhënë 40.000.000 EUR dhe 20.000.000 EUR, sipas deklaramentit të bërë nga CEZ a.s.
4. Në aplikimin për plan të investimeve për vitin 2012, CEZ Shpërndarje Sh.a. përsëri ka njohur në emër të kompanisë mëmë se CEZ a.s. si aksioneri kryesor, është gati të sigurojë financim të mëtejshëm të shoqërisë në shumën e duhur të investimit.
5. Më 30 korrik 2012, CEZ Shpërndarje Sh.a. i ka shkruar Kryeministrit duke deklaruar se "sipas kontratës, CEZ Shpërndarje është i detyruar për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes, duke synuar një shërbim më të

mirë për klientët e saj në Shqipëri, kompania neme në Pragë ka vendosur që të alokoje më shumë fonde për kompaninë shqiptare të shpërndarjes që do të përdoren për të siguruar energjinë e nevojshme për të garantuar furnizimin me energji të pandërprerë. " Kjo leter jo vetëm që u referohet konsumatorëve shqiptarë te energjisë si klientë të kompanisë nëmë në Pragë, CEZ a.s, por ajo është një njohje dhe pranimi i metejshem i detyrimit te CEZ a.s. për të ndihmuar kompaninë e shpërndarjes së energjisë elektrike me mjete të mjaftueshme për tu operuar nga CEZ a.s.

6. Së fundmi, në një letër qe CEZ Shperndarje Sh.a. i ka derguar aksionerëve të saj, CEZ a.s dhe METE-s, ne datën 12 nëntor 2012, CEZ Shperndarje sh.a. ka kërkuar që aksioneret të zgjidhin çështjen e likuiditetit të CEZ Shperndarje Sh.a. duke injektuar para. Edhe një herë, kjo konfirmon kerkesen per mbeshtetje te CEZ Shperndarje sh.a. nga kompania e tij mëmë / aksionari kryesor dhe nënshkrues i Marreveshjes se Blerjes se Aksioeneve, CEZ a.s., për mjetet e nevojshme për të vazhduar operimin e saj.

Duhet sqaruar se CEZ Shperndarje ka aplikuar ne ERE per miratimin e nje plani investimesh te detajuar sipas nenit 24 te Ligjit 9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar, qe ndermjet te tjerave te realizoje uljen e humbjeve. Sic theksuam me lart keto plane investimi jane miratuar ne vite nga ana e ERE sic jane propozuar dhe argumentuar nga shoqeria.

Gjithashtu referuar kerkesave ne lidhje me miratimin e Rregullores se Demit Ekonomik , sqarojme se me Vendimin nr. 42, date 22.04.2011, Bordi i Komisionerve ne zbatim te nenit 51, pika 14 te Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e

Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, miratoi “Metodologjine e llogaritjes dhe faturimit të dëmit ekonomik” të ndryshuar me pas me Vendimin nr. 109, date 31.07.2012 “Per miratimin e disa ndryshimeve ne metodologjine e llogaritjes se demit ekonomik”. Ky vendim parashikon nje ashpersim te sistemit te demit ekonomik duke e rritur kete vlere per konsumatorët qe abuzojne me konsumin e energjise elektrike.

Gjithashtu referuar kerkesava ne lidhje me miratimin e Rregullores se Demit Ekonomik , sqarojme se me Vendimin nr. 42, date 22.04.2011, Bordi i Komisionerve ne zbatim te nenit 51, pika 14 te Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, miratoi “Metodologjine e llogaritjes dhe faturimit të dëmit ekonomik” të ndryshuar me pas me Vendimin nr. 109, date 31.07.2012 “Per miratimin e disa ndryshimeve ne metodologjine e llogaritjes se demit ekonomik”. Ky vendim parashikon nje ashpersim te sistemit te demit ekonomik duke e rritur kete vlere per konsumatorët qe abuzojne me konsumin e energjise elektrike.

Si konkluzion, nga paraqitjet e mesiperme duket qarte se, pavaresisht detyrimit ligjor per realizimin e planeve te investimeve, CEZ Shperndarje nuk e ka realizuar ne asnje vit planin e investimeve ne total, pa folur ketu per realizimin e ketij plani sipas zerave te aprovuara nga vendimet e EREs, duke qene e paaftë per te realizuar mbështetje financiarisht permes bankave apo shoqërisë me me.

4- Mospajisja me matesa te energjise elektrike te te gjithe konsumatoreve

Baza ligjore:

- *Licensa e Shperndarje, Pika 2.2 c) “Gjate afatit te Licensës, i Licensuari ka te drejte te kryje te gjitha veprimtarite qe kerkohen per permbushjen e Veprimtarise se Licensuar, perfshire, pa kufizim: c) instalimin dhe sherbimin e matesve te energjise elektrike.*
- *Ne baze te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar, ne nenin 52 percaktohet se “Operatori i Sistemit te Shperndarjes eshte i detyruar te pajise me sistem matjeje cdo klient te lidhur ne sistemin e shperndarjes”,*
- *Ne Nenin 13.1 te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike te konsumatoreve tarifore miratuar me Vendimin 108 dhe 109, date 21.10.2011 nga ana e Bordit te Komisionereve te ERE-se, percaktohet se “Furnizuesi, me shpenzimet e veta, instalon tek Klienti në përputhje me kërkesat e legjislacionit, sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes me nënshkrimin e kësaj kontrate”.*
- *Ne Vendimin 104, date 22.12.2009, te Bordit i Komisionereve te ERE ne shqyrtim te kerkeses se OSSH, percaktoi se afati i aplikimit te faturimit aforfe per klientet familjare te energjise elektrike qe nuk jane pajisur me mates te jete deri ne 30.04.2010, pasi te gjithë klientet jofamiljare ishin te pajisur me matesa.*

Kjo do te thote qe duke filluar nga date 1 Maj 2010, nga ana e shoqerise CEZ Shperndarje duhej te ishte bere pajisja me mates te energjise elektrike per gjithë klientet tarifore.

ERE, ne kuader te monitorimit te pajisjes me matesa, ka konstatuar problematika duke shqyrtuar informacionet periodike, informacionet specifike si dhe nisur nga monitorimet ne terren apo ankesat e konsumatoreve.

Tabela nr. 7

Anomalite e matjes gjate muajit Gusht 2012			
Nr	Pershkrimi i anomalise	Kodi	Sasi
1	Banesa e pabanuar	57	72,038
2	Nuk gjendet kontrata	55	22,750
3	Converge	60	9
4	Klienti nuk lejon akses	34	153
5	Mates i demtuar	51	4,957
6	Mates jashte kushteve teknike	53	11,040
7	Furnizim i paligjshem (linje e dyte)	50	3,139
8	Kontrate jo-aktive	54	5,858
9	Nuk gjendet matesi	1	27,849
10	Matesi i paaksesueshem	2	3,561
11	Matesi ishte ndryshuar	22	1,770
12	Objekti nuk ekziston	56	13,679
13	Njesi te tjera lexuese	32	3,280
14	Vulat e demtuara	52	8,690
	Total		178,773

Sic rezulton edhe nga tabela e mesiperme, 27.849 abonente klasifikohen ne sistemin e faturimit me kodin 1, si abonente pa matesa (kodi 1 “nuk gjendet matesi”).

Vetem nga monitorimet e ushtruara ne CEZ Shperndarje gjate vitit 2012 per efekt te realizimit te detyrimit te shoqerise CEZ Shperndarje per instalimin e matesave te gjithë konsumatoreve, ERE (sikurse eshte evidentuar ne relacionin bashkelidhur Vendimit 158, date 16 Nentor 2012), ka konstatuar shkelje te ketij detyrimi ne rajonet e Kukesit, Fierit dhe Vlores.

Nga monitorimi, ne zonen e Kukesit, sipas te dhenave te vete CEZ Shperndarje sh.a., rezultojne 3.984 abonente qe nuk jane te pajisur me matesa, sic shihet ne tablen e meposhtme. (Nuk gjendet matesi kodi 1).

Tabela nr. 8

Anomalite e matjes ne Kukes			
Nr	EMERTIMI /Kategoria	Kodi	Sasi
1	Banesa e pabanuar	57	902
2	Nuk gjendet kontrata	55	65
3	Mates i demtuar	51	314
4	Mates jashte kushteve teknike	53	183
5	Furnizim i paligjshem	50	230
6	Kontrate jo-aktive	54	60
7	Nuk gjendet matesi	1	3984
8	Matesi i paaksesueshem	2	94
9	Matesi i ndryshuar	22	18
10	Objekti nuk ekziston	56	236
11	Njesi te tjera lexuese	32	55
12	Mungon vula	52	184

Po ashtu ne monitorimin e kryer ne **zonen e Vlores** ka rezultuar se u gjeten 2.097 abonente qe banojne (konsumojne energji elektrike) dhe nuk kane mates.

Tabela nr. 9

Nr Kodit	Gusht 2012	Faturuar me konsum "0"
1	Abonenti Banon por nuk ka mates	2 097
2	Matesi nuk eshte i aksesueshem	235
34	Konsumatori nuk lejon aksesin	76
51	Mates i demtuar	473
54	Kontrate Inaktive	131

55	Kontrate e re / te dhena jo te plota	1 294
56	Objekti nuk egziston	202
57	Klienti nuk banon/nuk shikoj matesin	8738
	TOTALI	13 246

Ne Zonen Fier/Ballsh u gjeten 657 abonente qe banojne dhe qe konsumojne energji elektrike, por nuk kane mates dhe 392 abonente me matesa te demtuar. Nga monitorimi ne vend ne qytetin e Fierit, u gjeten 473 konsumatore me mates te demtuar. Me poshte jepet tabela per anomalite ne matje ne Rrethin e Fierit.

Tabela nr. 10

Nr Kodit	Gusht 2012	Faturuar me konsum "0"
1	Abonenti Banon por nuk ka mates	657
2	Matesi nuk eshte I aksesueshem	237
34	Konsumatori nuk lejon aksesin	12
51	Mates I demtuar	392
54	Kontrate Inaktive	39
55	Kontrate e re / te dhena jo te plota	229
56	Objekti nuk egziston	89
57	Klienti nuk banon/nuk shikoj matesin	5881

	TOTALI	7 536
--	---------------	--------------

Duke pare keto problematika te sistemit te matjes te konstatuara ne disa zona, u kerkua qe te na jepej informacion i nxjerre nga sistemi i faturimit te CEZ Shperndarje per periudhen Janar- Tetor 2012.

Informacioni u dergua me e-mail per te gjithë konsumatorët e faturuar me Konsum “0” me dt. 05.12.2012. Nje permbledhese paraqitet me poshte:

Tabela nr. 11

KONSUMATORE ME FATURIM "0" JANAR-TETOR 2012										
TOTAL (10 ZONA)	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR
Konsumatore Gjithsej	1,132,571	1,134,857	1,138,172	1,176,392	1,179,234	1,147,545	1,159,751	1,161,322	1,163,871	1,149,019
Nr.Faturave te emetuara Gjithsej	1,101,807	1,079,246	1,124,218	1,068,333	1,110,093	1,051,939	1,047,473	1,052,390	1,049,557	1,047,485
Diferenca (c = a – b)	30,764	55,611	13,954	108,059	69,141	95,606	112,278	108,932	114,314	101,534
Nr.Faturave me lexim konsumi	816,905	805,289	815,200	822,577	831,977	792,874	828,380	847,271	852,412	843,788
Nr. Faturave pa lexim (energji e pa matur)	536	806	12,265	2,430	2,329	5,167	3,588	2,300	2,097	3,406
Nr. Faturave pa lexim (dem ekonomik)	1,528	108	2,027	581	1,143	511	483	93	1,246	2,677
Nr. Faturave me konsum "0"	274,502	267,706	288,254	233,487	262,655	237,881	196,444	190,043	185,580	198,519
Nga faturat normale me konsum "0":										
Abonenti banon por nuk ka mates (kodi 1)	8,729	9,480	9	5	12	1	13	4	53	94
Matesi eshte i pa aksesueshem (kodi 2)	222	5	-	-	3	-	3	7	8	9
Konsumatori nuk lejon aksesin (kodi 34)	143	519	-	8	-	-	1	-	4	-
Mates i demtuar (kodi 51)	1,304	4,459	-	1	8	11	6	-	24	29
Kontrate inactive (kodi 54)	2,027	-	1	8	10	7	1	3	5	11
Kontrate e re/te dhena te paplota(kodi 55)	8,819	8,790	8,910	15,744	17,314	18,374	11,972	11,009	10,963	10,683
Objekti nuk egziston (kodi 56)	1,257	1	-	1	7	8	3	1	3	7
Klienti nuk Banon/nuk shikoj mates(kodi 57)	76,841	78,481	84,901	84,372	78,593	77,268	43,569	71,187	71,984	80,271
Te tjera	51,547	49,900	42,779	27,391	51,975	49,897	36,955	6,095	8,062	8,018
Nuk kane anomal	117,102	112,136	103,020	98,370	97,479	82,808	94,009	94,423	88,351	94,910
Total fatura normale me konsum "0"	267,991	263,771	239,620	225,900	245,401	228,374	186,532	182,729	179,457	194,032
Fatura te anuluar me konsum "0"	364	141	1,374	319	549	749	872	453	418	315
Fatura saktuesese me konsum "0"	6,147	3,794	47,260	7,268	16,705	8,758	9,040	6,861	5,705	4,172
Total fatura me konsum "0"	274,502	267,706	288,254	233,487	262,655	237,881	196,444	190,043	185,580	198,519

- Nga tabela permbledhese shihet qarte se ka akoma kliente pa matesa sipas vete deklarimit te CEZ.
- Shifrat e marra ne Gusht nuk perputhen me ato te deklarimit te Dhjetorit per te njejtin muaj megjithese vijne nga i njejt burim (sistemi Faturimit).

Dallohet nje shifer e konsiderueshme e klienteve te cilet etiketohen me “Te Tjera”

Kemi kerkuar detajimin e ketij zeri por akoma nuk na eshte vene ne dispozicion. Rreth 25% e totalit te abonenteve jane abonente qe faturohen me konsum “0”.

Nje fenomen i tille i faturimit aforfe, eshte evidentuar edhe ne vitin 2011, gjate monitorimit te konsumit vetiak te CEZ Shperndarje sh.a., ku u gjet qe edhe vete ambjentet e CEZ Shperndarje faturoheshin me konsum “0” apo me vlera aforfe.

CEZ Shperndarje pretendon se 100% e klienteve kane te instaluar nje mates ne banesat/ mjediset e tyre. Kete deklarim CEZ Shperndarje e mbeshtet ne faktin se nuk ka pajisur me mates vetem klientet te cilet jane te lidhur ne rrjetin e shperndarjes ne menyre te paligjshme dhe me te cilet CEZ Shperndarje nuk ka nenshkruar nje kontrate te rregullt, apo edhe nese ndodh qe te kene patur nje kontrate te rregullt, kjo nenkupton sipas CEZ Shperndarje se ata jane rilidhur ne menyre te parregullt ne rrjet pasi jane shkeputur nga CEZ Shperndarje si rrjedhoje e detyrimeve te papaguara.

Lidhur me kete deklarim te CEZ Shperndarje, ERE argumenton se:

CEZ Shperndarje nuk mbeshtet deklarimet e saj ne legjislacion, kur thote se CEZ nuk ka pajisur me mates klientet e lidhur ne menyre te paligjshme me rrjetin, e me te cilet nuk ka nje kontrate te rregullt furnizimi. Fakti qe keta konsumatore, sipas vete deklarimeve te shoqerise, figurojne ne sistemin e faturimit te CEZ Shperndarje, te identifikuar sipas nje numeri kontrate perkates dhe per me teper faturohen cdo muaj me konsum “0”, tregon qe keta jane kliente te energjise elektrike.

ERE konsideron si shkelje te CEZ Shperndarje mospajisjen me matesa te konsumatoreve me kontrate te rregullt sipas legjislacionit ne fuqi, pasi ne baze te

Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike dhe akteve te tjera rregullatore ne fuqi, subjektet qe nuk kane nje marreveshje me furnizuesin publik me pakice nuk mund te konsiderohen konsumatore te energjise elektrike (neni 13/1 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike te Konsumatoreve Tarifore).

Per me teper krejtesisht i pargumentuar gjendet edhe deklarimi i CEZ Shperndarje per mospaisje me mates te klienteve te cilet kane nje kontrate te rregullt furnizimi, por qe jane shkeputur si rrjedhoje e detyrimeve te prapambetura. Lidhur me konsumatorët qe nuk kane paguar detyrimet e tyre ndaj furnizuesit publik me pakice qartesisht ne kontraten e furnizimit me energji elektrike jane percaktuar te drejtat e furnizuesit qe per kete kategori klientesh te aplikoje kamatvonesen per cdo dite vonese jashte afatit te pecktuar per shlyerjen e detyrimit, te beje edhe nderprerjen e furnizimit me energji elektrike konform rregullave ne fuqi, madje ligji i ka njohur te drejten CEZ Shperndarje te mbledhe edhe detyrimet e papaguara permes ekzekutimit te detyrueshem. Por ne asnje rast, aktet ligjore ne fuqi nuk parashikojne te drejten e CEZ Shperndarje qe per klientet ne vonese te pagimit te faturave te energjise elektrike te ngelen pa mates, por ne cdo rast behet vulosja e tyre me vule te vecante. Pra cdo konsumator qe CEZ Shperndarje i rregjistron ne sistemin e billing si konsumatore tarifore dhe i faturon duke mos pasur matesa te energjise elektrike, perben shkelje te legjislacionit ne fuqi.

Se fundmi theksojme se lidhur me kete shkelje CEZ shperndarje ne përgjigje te Vendimit nr. 158 te ERE, nuk ka paraqitur asnje prove ne lidhje me gjendjen e paisjes me matesa ne keto zona per efekt te ketij procedimi. Si e tille ERE i gjen si te pabazuara, te paargumentuara dhe te pambeshtetura prova pretendimet e CEZ Shperndarje, ne lidhje me kete detyrim te licenses.

5- Mos pagesa ndaj shoqerise OST sh.a sipas marreveshjes se miratuar nga ERE

Baza Ligjore

Pika 4.6 e Licences se Shperndarjes “I Licensuari do t’u bindet vendimeve te nxjerra nga ERE, perfshire pagesat e gjobave te vena nga ERE, sipas Legjislacionit ne Fuqi”.

Vendimi i Bordit te Komisionereve te ERE, nr. 102, date 17.07.2012 “Per miratimin e marreveshjes se transmetimit te energjise elektrike midis OST sh.a dhe CEZ Shperndarje sh.a”.

CEZ Shperndarje nuk ka kryer rregullisht pagesat ndaj OST. Kjo eshte ne kundërshtim te Vendimit nr. 102 date 17.07.2012 te Bordit te Komisionereve te ERE qe miratoi marreveshjen e transmetimit mes OST sh.a dhe CEZ Shperndarje sh.a dhe pikes 6.4 te Modelit te Tregut.

Referuar shkreses 5449 Prot, date 13.12.2012, OST sh.a ve ne dijeni se per vitin 2011 debia e krijuar nga moslikuidimi i ketyre faturave eshte 2,335,565,242 (Dy miliarde e treqind e tridhjetë e pese milione e pesëqind e gjashtedhjetë e pese mijë e dyqind e dyzet e dy) leke dhe interesat e llogaritura deri me 29.08.2012 jane 222,579,749 (Dyqind e dyzet e dy milione e pesëqind e shtatedhjetë e nente mijë e shtateqind e dyzet e nente) leke dhe per vitin 2012 debia e krijuar rezulton 1,815,330,091 (Një miliardë e teteqind e pesëmbëdhjetë milione e treqind e tridhjetë mijë e nentëdhjetë e një) leke dhe interesat e llogaritura per keto fatura deri me 13.12.2012, jane 1,760,162,146 (Një miliardë e shtateqind e gjashtedhjetë milione e njëqind e gjashtë dhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e gjashtë) leke.

6- Moszbatimi i detyrimit per raportimet ne ERE

Sipas Pikes 3.7.2 te Licenses se Shperndarjes dhe 3.2.2 te Licenses se Furnizimit Publik me Pakice - Te Licensuarit i kerkohet te pergatise dhe t'i paraqese ERE-s ne 31 janar te çdo viti, nje raport vjetor lidhur me operimet e tij gjate vitit te meparshem kalendarik

Konstatohet qe shoqeria CEZ Shperndarje sh.a ne shkelje te pikes 3.7.2 te Licenses se Shperndarjes se Energjise Elektrike dhe pikes 3.2.2 te Licenses se Furnizimit Publik me Pakice, nuk ka sjelle brenda 31 Janarit raportin periodik vjetor lidhur me operimet e tij gjate vitit te meparshem kalendarik, qe permban permblendhjen dhe analizen e veprimtarise se shperndarjes se te licensuarit; shitjet e energjise elektrike dhe te dhenat mbi mbledhjen e faturave per vitin paraardhes; cilesine e sherbimit te shperndarjes dhe detajet e cdo mase te marre per permiresimin e sherbimit te shperndarjes ne zone; cdo keq-funksionim qe ka ndodhur gjate vitit te kaluar; cdo nderprerje te programuar dhe te pa programuar te energjise elektrike sipas niveleve te tensioni; humbjet sipas niveleve te tensionit etj, sic kerkuar ne baze te licensave qe ushtron aktivitetin shoqeria CEZ Shperndarje.

Ne vendimin 158, date 16 nentor 2012 te Bordit te Komisionereve te ERE-s, eshte konstatuar se CEZ Shperndarje ka shkelur piken 3.7.2 te Licenses se Shperndarjes se Energjise Elektrike dhe piken 3.2.2 te Licenses se Furnizimit Publik me Pakice.

Lidhur me detyrimin e pikes 3.7.2 te licenses se shperndarjes, CEZ Shperndarje deklaroi se ka permbushur kete detyrim duke raportuar rregullisht cdo muaj dhe se ka dhene informacione shtese te kerkuara nga ERE. Gjithashtu shoqeria pretendon se ne janar te cdo viti ka depozitar ne ERE raportet mbi shifrat kyçe vjetore per vitin e kaluar duke bere referimin ne kete pike ne shkresat nr.313/1 date 19.01.2010,

313/18 date 25.1.2011, dhe nr.892, date 14.02.2012, nderkohe qe pasqyrat financiare jane derguar me shkresat nr. 5525 date 09.08.2012, nr.3572/1 date 14.07.2011, nr.6841/1 prot date 13.11.2012.

Duke analizuar shkresat verehet se CEZ Shperndarje ka dhene informacion per:

- 1- Bilancin e energjise elektrike
- 2- Strukturen e shitjes
- 3- Humbjet teknike dhe joteknike
- 4- Evidencen e debitoreve per energjine mujore dhe progresive
- 5- Te dhena mbi pajisjet me matesa te abonenteve

Nga analiza e informacionit te paraqitur nepermjet ketyre shkresave verehet se ky informacion nuk ploteson kerkesat sic percaktohet ne piken 3.7.2 te Licenses se Shperndarjes ku percaktohet se :

3.7.2 Te Licensuarit i kerkohet te pergatise dhe t'i paraqese ERE-s ne 31 janar te çdo viti, nje raport vjetor lidhur me operimet e tij gjate vitit te meparshem kalendarik, qe permban sa me poshte:

- a) permbledhjen dhe analizen e veprimtarise se shperndarjes se te Licensuarit;
- b) shitjet e energjise elektrike dhe te dhenat mbi mbledhjen e faturave per vitin;
- c) cilesine e sherbimit te shperndarjes dhe detajet e çdo mase te marre per permiresimin e sherbimit te shperndarjes ne zone;
- d) çdo keq-funksionim qe ndodh gjate vitit;
- e) çdo nderprerje te programuar dhe te pa programuar te energjise elektrike sipas niveleve te tensionit
- f) humbjet sipas niveleve te tensionit

Pra ne konkluzion verehet se jo vetem qe CEZ Shperndarje nuk ka paraqitur raportet me permbajten e kerkuar nga pika 3.7.2 e licenses, duke mos paraqitur te dhena ne lidhje me:

- a) cilesine e sherbimit te shperndarjes dhe detajet e çdo mase te marre per permiresimin e sherbimit te shperndarjes ne zone;
- b) çdo keq-funksionim qe ndodh gjate vitit;
- c) çdo nderprerje te programuar dhe te pa programuar te energjise elektrike sipas niveleve te tensionit

por edhe sic pranon vete ne faqe 13 te pergjigjes te derguar ne ERE, pika 4, paragrafi 2, edhe kur ka siguruar informacione shtese e ka bere kete brenda afateve te gjykuara te nevojshme nga ajo vete dhe jo ne kohen e kerkuar nga ERE sic edhe referohet ne piken 3.7.3 te licenses ku qartesisht parashikohet se :

“T Licensuari do t’i paraqese ERE-s, me kerkesen e saj dhe sipas formes dhe brenda kohes se vendosur nga ERE, çdo informacion qe eshte i domosdoshem per ERE-n per te kryer pergjegjesite e saj rregullatore te autorizuar.” .

Per sa i perket shkeljes se konstatuar ne vendimin nr. 158, date 16 nentor, per moszbatim te pikes 3.2.2 te licenses se furnizimit publik me pakice sipas te cilit :

Pika 3.2.2 e licenses

Të Licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t’i paraqesë ERE-s në 31 janar të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, që përmban sa më poshtë:

- o përmbledhjen dhe analizën e veprimtarisë furnizuese të të Licencuarit;*
- o shitjet e energjisë elektrike dhe të dhënat mbi mbledhjen e faturave për vitin;*
- o çdo ndërprerje të furnizimit sipas niveleve te tensionit;*
- o kushtet e kontratave të furnizimit me Furnizuesin Publik me Shumicë; dhe*

- *një tabelë që tregon performancën e Furnizuesit Publik me Pakicë sipas Kodit të Shpërndarjes në atë shkallë që zbatohet*
- *lidhjen e kontratave për furnizimin me energji elektrike me konsumatorët tarifore.*

Ne përfundim sic theksuar me lart CEZ Shpërndarje në përgjigjen e dërguar për efekt të procedimit për heqje të licenses e pranon që nuk ka raportuar sic kërkuar në bazë të kushteve të licenses dhe për më tepër nuk jep asnjë shpjegim për arsyet e mospërmblidhjes së saj.

II. Shkelje të kushteve të Licenses së Furnizimit Publik me Pakicë

1 - Mos pagesa ndaj shoqërisë KESH sh.a sipas marrëveshjes së miratuar nga ERE

Baza Ligjore :

Pika 4.6 të Licenses së Furnizimit Publik me Pakicë - Mos zbatimi i vendimeve të ERE

Vendimin i Bordit të Komisionereve të ERE-s nr.134 datë 17.09.2012

Pikes 6.5, të Modelit të Tregut

ERE ka konstatuar shkelje të detyrimeve në marrëdhëniet kontraktuale midis KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a në kundërshtim me Vendimin 134 datë 17.09.2012 të

ERE per marreveshjen per shitjen e energjise elektrike mes KESH sh.a dhe CEZ Shperndarje sh.a. CEZ Shperndarje ne shkelje edhe te pikes 6.5 te Modelit te Tregut nuk ka kryer pagesa te rregullta te energjise elektrike sipas kushteve te kesaj kontrate. Sipas shkreses te KESH sha me nr. 4230/2 Prot., date 02.10.2012, mospagesa ka kapur vleren 10.372.420.784 (Dhjetë miliarde e treqind e shtatëdhjetë e dy milione e katërqind e njëzetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër)leke e cila duke perfshire penalitetet arrin ne 11.348.987.743 (Njëmbëdhjetë miliarde e treqind e dyzet e tetë milione e nentëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet e tre) leke. Per vitin 2011 vlera e detyrimit eshte 5,511,964,243 (Pesë miliarde e pesëqind e njëmbëdhjetë milione e nente qind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e dyzet e tre) leke dhe per vitin 2012 detyrimi eshte 4,860,420,784 (Katër miliarde e teteqind e gjashtëdhjetë milione e katërqind e njëzet mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër) leke, pa perfshire detyrimin per energji per mbulimin e humbjeve te realizuara nga KESH sh.a.

Kjo ka çuar ne një situatë te vështirë financiare edhe kompanitë e tjera qe operojnë ne Shqipëri, te tille si Prodhuesit e Vegjël te Energjisë Elektrike por mjaft shqetësues është situata edhe ne drejtim te mospagesave ndaj Tregtareve te cilat deri me tani ka shkuar ne vlerat te medha. Kjo shkelje ka krijuar një tjetër shqetësim qe lidhet drejtpërsedrejti me sigurinë e furnizimit me energji elektrike ne vend pasi ne kushtet e vështirësisë financiare me te cilat po përballen këto operatore, nuk janë kryer investimet e pritshme nga KESH dhe OST për vitin 2012, çka gjithashtu i ka ekspozuar këto ne mospërbushjen edhe te detyrimeve ndaj donatoreve.

Lidhur me shkeljen e konstatuar nga ERE per moszbatim te Vendimit te ERE nr.134, date 17.09.2012, mbi marreveshjen per furnizimin me energji lidhur midis KESH dhe CEZ Shperndarje qe konsiston ne mos kryerjen e pagesave per shoqerine KESH, shoqeria CEZ Shperndarje se pari pretendon qe kjo kontrate nuk eshte rene dakord midis paleve dhe eshte refuzuar te nenshkruhet nga shoqeria CEZ

Shperndarje. Sipas kesaj te fundit kjo kontrate eshte imponuar nga ERE pasi permban disa kushte qe jane te padrejta dhe eshte ne shkelje te Modelit te Tregut, pasi nuk eshte negociuar lirisht mes paleve.

Sqarojme se ERE duke filluar nga Dhjetori 2011 ka bere te gjitha perpjekjet me ane te komunikimeve dhe seancave degjimore per te bere qe palet te bien dakord mbi kete marreveshje (shih shkresat e ERE nr.749 prot., date 12.12.2011, Nr. 371 prot., date 30.04.2012, nr. 371/2 prot., date 21.05.2012, nr. 481 prot., 31.07.2012 dhe nr. 623/3 prot., date 06.11.2012). Po ne kushtet e nje mungese vullneti te perbashket te paleve per nenshkrimin e kontrates se furnizimit me energji elektrike eshte ne autoritetin e ERE te ndermarre veprimet dhe procedurat per vendosjen e kesaj marredhenie mbi baza ligjore. Legjitimiteti i ERE-se per te ndermarre nje veprim per miratimin e kontrates ndermjet ketyre paleve buron nga Ligji nr. 9072, date 22.05.2003, „Per sektorin e energjise elektrike“, i ndryshuar, Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 338, date 19.03.2008 „Per miratimin e Modelit te Tregut Shqiptar te Tregut te Energjise Elektrike“, i ndryshuar dhe te gjitha aktet e tjera ligjore e nenligjore ne fuqi.

Në kuptim të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008, Pika 4.12 dhe pika 4.13, Gërma “A”, pika 2, që parashikon rolin e rregullatorit në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve respektive të pjesëmarrësve të tregut, marrëdhënia midis Furnizuesit Publik me Shumicë dhe Furnizuesit Publik me Pakicë funksionon si marrëdhënie e rregulluar, dhe si e tillë marrëveshja për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet tyre kërkohet që të miratohet nga ERE. Nje gje e tille parashikohet edhe në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e ERE –se, nr. 68 datë 23.06.2008, konkretisht ne dispozitat e pikes V.1.

Gjithashtu ne baze te Ligjit nr 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar, neni 8 pika 2, germa d), është në autoritetin e ERE-s

përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmejt tyre.

Persa i perket dispozitave të marrëveshjes shoqëria CEZ Shperndarje ka kundërshtime në lidhje me:

- Ndryshimit nga kërkesa për energji kur FPSH furnizon FPP me një sasi më të lartë energjie, si dhe kostot përkatëse.

Shoqëria CEZ Shperndarje në argumentin e saj bën një lajthitje juridike pasi nga njëra anë e konsideron si shkelje vendimin e ERE, nga ana tjetër përcakton se ky parashikim u pranua nga ERE dhe u vendos të pranohej ankimi i CEZ Shperndarje dhe të ndryshohet dispozita përkatëse. Për më tepër, kjo dispozitë nuk është kërkuar të ndryshohet në asnjë nga shkresat e CEZ Shperndarje. Po ashtu në mbledhjen e datës 17.09.2012 në të cilën kanë qenë prezent edhe përfaqësues të CEZ Shperndarje sh.a nuk është ngritur asnjëherë ky shqetesim. Kjo dispozitë është kërkuar për herë të parë në shkresën nr. 623/2, prot., datë 5.10.2012, në lidhje me ankimin e Vendimit nr. 134, datë 17.09.2012. Duke qenë se kontrata finale është ajo që përmban edhe ndryshimet e vendimit nr. 169 i datës 26.11.2012 “Mbi ankimin administrativ të KESH sh.a dhe CEZ Shperndarje sh.a kundër vendimit të ERE-së nr. 134, ky pretendim i CEZ është i palogjikshëm dhe i pambeshtetshëm.

- Persa i perket pretendimit të CEZ Shperndarje se afati 2 muajor për kompensimin e energjisë midis FPSH dhe FPP është një afat relativisht i shkurtër, sqarojmë se CEZ Shperndarje në ankimin e saj nuk ka evidentuar asnjë dispozitë ligjore që pretendohet të jetë shkelur nga ana e ERE. CEZ Shperndarje nuk jep asnjë argument ligjor mbi pathemelesinë e kësaj dispozite dhe si e tillë është e pamundur të jepen argumente mbi këtë pretendim të shoqërisë. Megjithatë në mbledhjen e datës 17.09.2012, për miratimin e kontratës KESH – CEZ Shperndarje,

perfaqesuesit e kesaj te fundit kane rene dakord per menyren e kompensimit ne afatin 2 mujor. Kjo tregon para se gjitha nje papergjegjshmeri te shoqerise CEZ Shperndarje ne dergimin e perfaqesuesve pa tagra ne mbledhjet vendimarrrese te Bordit te Komisionerve.

- Se fundmi, shoqeria CEZ pretendon si te padrejte dispoziten e marreveshjes e cila detyron FPP te vendose nje garanci bankare ne nje vlere monetare te barabarte me $\frac{1}{2}$ e sasise mesatare te planifikuar te cdo muaji. Edhe lidhur me kete dispozite CEZ Shperdarje nuk jep asnje argument juridik mbi paligjshmerine e kesaj dispozite. CEZ Shperndarje jep thjesht justifikime mbi arsyet e konsiderimit te kesaj dispozite te tepert. Pra sqarimet e CEZ Shperndarje ne lidhje me kundërshtimet e kontrates KESH – CEZ Shperndarje, nuk evidentojne asnje dispozite ligjore te shkelur dhe asnje argument mbështetës, por vetëm justifikime mbi pamundësinë e zbatimit të kontratës.

Vlen per tu theksuar se kjo kontrate eshte ankimuar ne rruge gjyqesore nga ana e shoqerise CEZ Shperndarje dhe si e tille deri ne nje vendim te formes se prere nga ana e gjykates, vendimi i ERE konsiderohet ne perputhje te plote me legjislacioni dhe qe krijon efekte te plota ligjore per subjektet e interesuara.

2- Shkelje te detyrimit per parandalimin e vjedhjeve

Baza Ligjore:

CEZ Shperndarje eshte pergjegjese per zbulimin dhe parandalimin e vjedhjes se energjise. - Pika 4.7 e Licenses se Furnizimit Publik me Pakice

Persa i perket ketij detyrimi per parandalimin e vjedhjeve nga ana e CEZ Shperndarje jane dhene ne forme deklarative disa nga masat e ndermarra nga kjo shoqeri. Mekanizmat qe i referohet shoqeria CEZ Shperndarje jane mekanizma produkt i vendimeve te organeve te Shtetit Shqiptar dhe me konkretisht: Ligjvenesit shqiptar ka parashikuar si veper penale te vecante vjedhjen e energjise elektrike ne nenin 137 i Kodit Penal, po ashtu ne nenin 51 i Ligjit 9072, date 22.05.2003 „Per sektorin e energjise elektrike“, te ndryshuar, ndermjet te tjerave me Ligjin 10485, date 26.11.2011, u miratua nder te tjera parashikimi i llogaritjes se demit ekonomik shkaktuar kompanise nga cdo nderhyrje e paligjshme, ne perputhje me metodologjine e miratuar nga ERE.

Mbeshtetur ne kerkesat e ligjit, ERE miratoi metodologjine per llogaritjen e demit ekonomik (Vendimi 42, date 22.4.2011), vendim i cili eshte amenduar me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr. 109, date 31.7.2012 qe ka rritur vlerat e demit ekonomik sipas nje propozimi te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.

Ne konkluzion, shoqeria CEZ Shperndarje gezon ne perputhje me legjislacionin ne fuqi mjetet dhe mekanizmat ligjore te cilat ndihmojne ne parandalimin/uljen e vjedhjeve dhe te humbjeve ne rrjetin e shperndarjes, gje e cila sic eshte bere prezent ne *piken 2 te shkeljeve teknike te ketij relacioni*, nuk eshte arritur prej tyre.

3- Shkelje te Kushteve te Pergjithshme te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare

Ne kontraten e furnizimit me energji elektrike per konsumatorin familjare dhe jo familjare jane percaktuar raportet e detyrimeve dhe pergjegjesive reciproke te konsumatorit dhe CEZ Shperndarje ne cilesine e furnizuesit publik me pakice. Me poshte jepen shkeljet e shoqerise CEZ Shperndarje ne perputhje me keto detyrime.

- *Furnizimi i panderprere me energji elektrike nga ana e Furnizuesit Publik me Pakice te Klienteve Familjare dhe Jofamiljare dhe detyrimi i Klienteve per te paguar energjiine elektrike te konsumuar ne perputhje me termat dhe kushtet e Kontrates (Neni 2.1 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Klienti ka te drejte te kerkoje lidhjen e kontrates per furnizimin me energji elektrike cdo subjekt qe nuk eshte debitor ndaj Furnizuesit dhe qe ka nje pike lidhje te miratuar me rrijetin e shperndarjes te energjise elektrike, sipas percaktimeve te bera ne Rregulloren e Lidhjeve te Reja. (Neni 4.2 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Furnizuesi do te beje leximin periodik te matesit te energjise elektrike te Klientit per nje periudhe kohore prej 30 ditesh kalendarike dhe do ti dergoje Klientit ne adresen e dhene ne kontrate, faturen tip te energjise elektrike, brenda 10 diteve nga data e leximit . (Neni 7.1 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Brenda dates 31 Dhjetor 2012, Furnizuesi eshte i detyruar te siguroje aksesin e Klientit per leximin e lire te aparatit mates ne cdo kohe. (Neni 7.3 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Faturimi i energjise elektrike per ditet qe Klientit i eshte bequr aparati mates per shkak te kontrollit periodik me kerkese te Klientit apo Furnizuesit, ose ne rast te mosfunksionimit te aparatit mates do te behet bazuar ne konsumin mesatar ditor te muajit paraardhes, por jo me shume se 30 dite.(Neni 8.1 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare)*
- *Nese Furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditor per vendosjen e matesit te rregullt, ateherë pergjegjesia eshte e Furnizuesit dhe faturimi per ditet pa matje tej ketij afati, do te jete zero .(Neni 8.2 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*

- *Ne mungese te pageses nga Klienti te fatures brenda 30 diteve nga kalimi i afatit te caktuar per pagese sipas neneve 9.1 dhe 10, Furnizuesit i lind e drejta qe te beje nderprerjen e furnizimit me energji elektrike te Klientit, pasi e ka lajmernuar me shkrim kete te fundit 48 ore perpara. Furnizuesi eshte i detyruar qe te beje rilidhjen brenda 48 oresh nga kryerja e pageses nga Klienti .(Neni 11.1 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Furnizuesi do te trajtoje cdo ankese ne perputhje me Rregulloren e trajtimit te ankesave, te miratuara nga ERE. Kjo Rregullore behet publike ne zyrtar ku behen pagesat e energjise elektrike, apo ne Zyrtar e Kujdesit ndaj Klientit dhe ne faqet elektronike te Furnizuesit apo te ERE. (Neni 12.2 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Ne rast se Furnizuesi nuk i kthen pergjigje per ankesen Klientit brenda afatit te percaktuar ne Rregulloren e mesiperme, apo nese Klienti nuk eshte dakort me pergjigjen e dhene ndaj Furnizuesit, atehere ai ka te drejte te paraqese ankesen ne ERE, sipas procedurave te percaktuara ne Rregulloret perkatese te ERE-se. (Neni 12.3 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Per faturat e kontestuar nga Klienti qe rezultojne me faturime dukshem me te medha se faturimet mesatare mujore te tij,(te krahasueshme ose me shume se trefishi i faturimit mesatar mujor), Furnizuesi pezullon faturen dhe realizon me procedure te pershpejtuar verifikimin ,anullimin dhe nxjerrjen e fatures se korrigjuar brenda 10 diteve. (Neni 12.6 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Kontrolli i sistemit te matjes behet ne prezence te Klientit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi qe rregullon sektorin e energjise elektrike.(Neni 14.1 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);*
- *Ne rast te mosrespektimit te normave dhe procedurave te percaktuara ne Rregulloren “Per Kushtet Minimale te Cilesise se Sherbimit te Shperndarjes dhe Shitjes se Energjise Elektrike“, Furnizuesi eshte pergjegjes per kompesimin e Klientit,sipas se ketij se fundit,ne*

perputhje me proceduren dhe masen e kompensimit te percaktuara ne Rregulloren e mesiperme. (Neni 15.3 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare);

- *Furnizuesi është përgjegjës për dëmet që mund të shkaktohet Klientit për shkak të devijimeve të tensionit në kundërshtim me normat e furnizimit të përcaktuara në pikën 15.5 dhe akteve të tjera në fuqi, në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë apo me faj të tij. (Neni 15.6 i Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare).*

ERE ka konstatuar se CEZ Shperndarje ne pjesen me te madhe te rasteve eshte ne shkelje te afatit te trajtimit te ankesave apo kerkesave te klienteve sipas detyrimit te pikes 6.10, te Licenses se Furnizimit Publik me Pakice dhe Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Konsumatorët Familjare dhe Jo - Familjare, detyrim ne baze te te cilit i Licensuari do te marre ne konsiderate çdo ankese dhe do t'i pergjigjet me shkrim ankuesit nese ankesa e tij/saj eshte pranuar apo refuzuar, brenda 15 diteve pune nga marrja e saj. Per kete shkelje ne te cilen ERE ben saktesisht referimin se ku konsiston pjesa e papermbushur e detyrimit te CEZ Shperndarje.

Ne tabelen qe vijon jepet ne menyre te detajuar totali i ankesave ne ERE, numri i ankesave qe tashme jane zgjidhur, numri i ankesave te pazgjidhura si dhe numri i ankesave qe jane ne proces analize (duhet thene se me mbylljen e vitit edhe keto ankese mund te konsiderohen te pazgjidhura). **Analiza tregon se numri i ankesave te pazgjidhura eshte rreth 73% (nese shtohen edhe ato ne proces rritet akoma me shume), gje qe tregon punen e dobet te bere nga shoqeria ne kete drejtim.**

Tabela nr. 13

TOTALI I ANKESAVE TE PARAQITURA NE ERE PER VITIN 2012				
MUAJI ▼	TOTALI I ANKESAVE ▼	TE ZGJIDHURA ▼	TE PAZGJIDHURA ▼	NE PROCES ▼
JANAR	109	25	70	14
SHKURT	118	11	99	8
MARS	89	22	61	6
PRILL	113	32	74	7
MAJ	157	29	110	18
QERSHOR	171	17	132	22
KORRIK	203	22	154	27
GUSHT	173	10	121	42
SHTATOR	181	5	167	9
TETOR	147	8	113	26
NENTOR	161	0	129	32
DHJETOR	98	0	12	86
Total	1720	181	1242	297


Gjithashtu, krahas listes se ankesave te drejtuar ne ERE, konsumatorët e kategorive te ndryshme kane derguar ankesa edhe ne METE dhe institucione te tjera sic paraqitet ne tabelen e meposhtme. Edhe per kete grup ankesash, te cilat jane drejtuar ne METE, deri ne fund te dhjetorit 2012 nuk jane zgjidhur rreth 73.8% (nese shtohen edhe ato ne proces rritet akoma me shume), gjë qe tregon edhe një here punën jo efektive të kryer nga shoqëria CEZ Shpërndarje në këtë drejtim dhe humbjen e besimit nga të gjithë kategoritë e konsumatorëve kundër kompanisë CEZ.

Tabela nr. 14

ANKESA	TOTAL	TE ZGJIDHUR	TE PAZGJIDHUR	NE PROCI
ANKESA TE ARDHURA NGA AV.POPULLIT	186	36	103	47
ANKESA TE ARDHURA NGA METE	70	24	11	35
ANKESA TE ARDHURA NGA DPM	276	0	276	0
ANKESAT TOTALE NE TRE INSTITUCIONET E MESIPERME	532	60	390	82

Po te shikojme ecurine e ankesave te paraqitura ne ERE gjate viteve 2009- 2012, do te verejme se numri i ankesave ka nje rritje progresive nga viti ne vit. Kjo gje deshmon qarte sesi performanca e kompanise CEZ Shperndarje ka ardhur ne zbritje dhe pakenaqesia e konsumatoreve ndaj sherbimeve te furnizimit me energji elektrike eshte rritur ne menyre te ndjeshme. **ERE konstaton se numri i ketyre ankesave per vitin 2012 eshte me shume se 20 here me i larte se ato te paraqitura ne vitin 2009.** Per nje pasqyre me te qarte te situates , në tabelen e meposhtme nr. 15 paraqitet numri i ankesave te depozituara ne ERE gjate kesaj periudhe.

Tabela nr. 15



Lidhur me detyrimin per ndjekjen e udhezimeve te ERE-s per zgjidhjen e ankesave sipas pikes 6.11 te Licenses se Furnizimit Publik me Pakice, konstatohet se CEZ Shperndarje nuk e ka respektuar kete detyrim ligjor te percaktuar ne Licensen e Furnizimit Publik me Pakice.

Ne tabelen e meposhtme jepen ne detaje totali i ankesave te paraqitura ne ERE nga te gjitha kategorite e konsumatoreve. Analiza e shifrave te paraqitura tabelen e meposhteme, tregon qe numri i ankesave eshte rritur progresivisht.

Tabela nr. 16

TOTALI I ANKESAVE TE PARAQITURA NE ERE PER VITIN 2012										
Muaji	OBJEKTI I ANKESES									
DEM										TOTAL
	MBIFAT	KEQFAT	EKONO	FAT.AFO	J.K.TEKNI	KOLAU	HAPJE	KONT.FI		
MUAJI	URIM	URIM	MIK	RFE	KE	DIM	KONT	KTIVE	TE TJERA	
JANAR	28	9	52	0	6	0	0	0	14	109
SHKURT	19	4	77	1	1	0	0	0	16	118
MARS	17	8	49	0	0	0	1	4	9	89
PRILL	31	8	55	7	3	0	0	1	8	113
MAJ	29	18	73	12	11	1	2	3	8	157
QERSHOR	37	17	90	6	8	1	2	1	9	171
KORRIK	25	24	108	15	7	5	1	5	13	203
GUSHT	23	29	96	16	2	3	0	0	4	173
SHTATOR	14	16	82	23	10	0	4	6	26	181
TETOR	21	13	68	15	7	0	1	3	19	147
NENTOR	32	4	87	14	4	0	0	4	16	161
DHJETOR	25	2	53	5	7	0	0	1	5	98
Total	301	152	890	114	66	10	11	28	147	1720

Aplikimi në mënyrë të kundërligjshme nga ana e CEZ Shpërndarje të faturimit të konsumatoreve nën zerin “dëm ekonomik” apo “energji e pamatur”. Nje numer i madh ankesash i rregjistruar ne ERE (afersisht 70%), eshte ne lidhje me aplikimin në mënyrë të kundërligjshme nga ana e CEZ Shpërndarje, per faturimin e konsumatoreve nën zerin “dëm ekonomik” apo “energji e pamatur” për kundravajtësit e energjisë elektrike.

Lidhur me kete fakt, jane vërejtur dy tipologji shkeljesh :

- 1- Moszbatimi i Vendimit nr. 90, datë 15.11.2010, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për moszbatim të kushteve të përcaktuara në Licencë dhe konkretisht të pikës 3.1, të Licencës për Aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike” per anulimin e “demi ekonomik” apo “energji e pamatur”, te vendosura pas hyrjes ne fuqi te Ligjit nr. 9997, date 22.09.2008.
- 2- Vendosje “demi ekonomik” per konsumatorët familjare dhe jofamiljare, ne kundërshtim me nenin 14, te Kontrates se Furnizimit

per Klientet Familjare dhe Jofamiljare dhe pikes III.7.7 te Kodit te Matjes se Energjise Elektrike.

Lidhur me ankesat per “demin ekonomik” dhe “energji e pamatur”, ERE ka verejtur nga procesverbalet e leshuara nga grupet e NTL, qe shumica e ketyre kontrolleve nuk jane bere ne prezence te abonentit , gje e cila bie ne kundërshtim me nenin 14.1 te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare si dhe me nenin III.7.7 te Kodit te Matjes. Gjithashtu kontrollet e ushtruara kane qene ne bokse kolektive, bokse te cilat nuk jane ne pronesi te abonenteve por ne administrim te CEZ Shperndarje.

- Nderprerja e menjehershme e energjise elektrike. Nje shkelje tjeter eshte fakti qe menjehere pas vendosjes se “demit ekonomik”, abonenteve iu eshte bere nderprerja e menjehershme e energjise elektrike duke i vene perballe detyrimet te pagimit te vleres se ‘demit ekonomik’ pa e pasqyruar kete vlere ne faturen perkatese te energjise elektrike, gje e cila bie ne kundërshtim me detyrimet e percaktuara ne Kontraten e Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare, konkretisht me nenin 11.1 te kesaj kontrate ku citohet se “Ne mungese te pageses nga Klienti te fatures brenda 30 diteve nga kalimi i afatit te caktuar per pagese sipas neneve 9.1 dhe 10, Furnizuesit i lind e drejta qe te beje nderprerjen e furnizimit me energji elektrike te Klientit, pasi e ka lajmeruar me shkrim kete te fundit 48 ore perpara. Furnizuesi eshte i detyruar qe te beje rilidhjen brenda 48 oresh nga kryerja e pageses nga Klienti”.
- Mbifaturimin dhe keqfaturimin e energjise elektrike. Ankesat ne lidhje me mbifaturimin dhe keqfaturimin e energjise elektrike jane shkaktuar nga problematika te ndryshme si : mos rakordimi i gjendjes se hedhur ne sistem me gjendjen reale të matësit, gabime njerezore nga ana e faturueseve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësve të rinj në sistem. Keto problematika

rrisin peshen financiare qe iu ngarkohet abonenteve duke ulur nivelin e arketimeve. Te gjitha keto shkaqe kanë sjelle qe ankesat ne lidhje me mbifaturimin dhe keqfaturimin e energjise elektrike te jene problematike edhe për vitin 2012. Për te gjitha këto ankesa, ERE ka kërkuar nga CEZ Shperndarje informacionin e nevojshëm dhe verifikimin në vend te tyre. Më pas i jane dhene udhëzimet përkatëse kompanisë CEZ Shpërndarje duke i caktuar afate për zgjidhjen e tyre. Ne baze te te dhenave qe ERE disponon, për pjesën më të madhe te tyre nuk eshte kthyer përgjigje dhe nuk eshte bere sistemimi përfundimtar i gjendjes reale të leximit të matësit.

- Mosrespektimi i afatit 30-ditor per leximin periodik te matesi. Ankesat qe jane paraqitur ne ERE dhe ne lidhje me problemet e mbifaturimit dhe keqfaturimit te energjise elektrike, te cilat vijne si pasoje e mosleximeve periodike te matesave te energjise elektrike per nje periudhe kohore prej 30 ditesh kalendarike,e cila percaktohet ne nenin 7.1 te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare.
- Faturime dukshem të gabuara . Gjithashtu per faturimet dukshem me te medha se faturimet mesatare mujore te konsumatoreve(te krahasueshme ose me shume se trefishi i faturimit mesatar mujor), kompania CEZ Shperndarje nuk ka zbatuar nenin 12.6 te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare, ku percaktohet qarte se “Furnizuesi pezullon faturen dhe realizon me procedure te pershpejtuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e fatures se korrigjuar brenda 10 diteve.”
- Mos krijimi i aksesit te lire per leximin e matesve nga ana e konsumatoreve ;

Bazuar ne Kushtet e Pergjithshme te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare, neni 7.3 i saj percakton se “ Brenda dates 31 Dhjetor 2012, Furnizuesi eshte i detyruar te siguroje aksesin e Klientit per leximin e lire te aparatit mates ne cdo kohe”. Lidhur me sa më sipër, ERE ka verejtur se kompania CEZ Shperndarje nuk ka marre masat e duhura per zbatimin e ketij neni te Kontrates.

- Kolaudimi i matesave te energjise elektrike. Pergjate gjithë vitit 2012, kolaudimi i matesave ka qene i bllokuar dhe te gjithë kerkesat/ankesat qe i jane drejtuar CEZ Shperndarje per verifikimin e saktësisë ne matje te aparateve mates te energjise elektrike nuk jane trajtuar nga kompania.
- Cilesia e furnizimit me energji elektrike. Problematike gjithashtu ka rezultuar edhe cilësia e tensionit. Pjesa me e madhe e këtyre ankesave vijnë kryesisht nga Komuna dhe subjekte të ndryshme private. Një pjese e madhe e këtyre ankesave na janë përcjellë nga METE dhe Avokati i Popullit. Problemet me cilësinë e tensionit, janë të njohura dhe të pranuar nga CEZ Shpërndarje. Rregullimi dhe përmirësimi i situatës për të siguruar një furnizim me energji elektrike konform standardeve, do të kërkonte investime të reja, një pjese e të cilave janë parashikuar për periudhën e trete rregullatore, në përputhje me planin e investimeve që është miratuar nga ERE. Nga ana jonë këto ankesa janë trajtuar duke organizuar seanca dëgjimore, në të cilat i është kërkuar CEZ-it informacion i detajuar lidhur me shkaqet e ndërprerjeve dhe kohëzgjatjen e tyre. Nga ana e CEZ Shpërndarje, janë pranuar ndërprerjet e kryera dhe janë angazhuar për respektimin e detyrimeve kontraktuale dhe njoftimin në kohë të konsumatorëve për rastet e ndërprerjeve të planifikuara dhe kryerjen e defekteve në një kohe sa më të shkurtër. Gjithashtu nga ana e

EREsë, i është kërkuar ndërhyrja e menjëhershme për kryerjen e shërbimeve të rrjetit të shpërndarjes dhe investimeve brenda fondeve të planifikuara, aty ky gjendja është më emergjente.

- Faturimi i energjise elektrike per “matje jashte kushteve teknike”.
Problematike eshte paraqitur gjithashtu situata e cila ka te beje me nderrimin e matesave, te cilet jane jashte kushtit teknik, brenda afateve te caktuara. Mosrespektimi i ketyre afateve ka sjelle ngarkimin e konsumatoreve me energji te faturuar per “matje jashte kushteve teknike”, faturim i cili nuk eshte bere ne baze te legjislacionit ne fuqi. Kjo pasi ne Kontraten e re per Furnizimin me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare, ne Nenin 8, pika 2, citohet se “nese Furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditor per vendosjen e matesit te rregullt, atehere pergjegjesia eshte e Furnizuesit dhe faturimi per ditet pa matje tej ketij afati, do te jete zero”.
- Kontrata fiktive te hapura ne menyre te njeanshme nga ana e kompanise .
Ankesa jane paraqitur ne ER E gjithashtu dhe ne lidhje me problemet per kontratat fiktive qe ekzistojne ne sistemin Billing. Keto kontrata jane kryesisht te dublikuara me kontratat origjinale te klienteve ose jane kontrata te hapura ne menyre te njeanshme pa marreveshje mes paleve.
- Problemet e mbartura nga faturimet aforfe per periudhen 2007 – 2009.
Keto probleme jane kryesisht te mbartura prej viteve 2007- 2010. Keto ankesa vazhdojne te mbeten te patrajtuara nga ana e CEZ Shperndarje, me justifikimin e mungeses se dokumentacionit te plote nga ana e kompanise. Flagrante jane rastet, ne te cilat edhe pse faturimi i konsumatoreve eshte bere dukshem ne kundërshtim me vendimet e miratuara nga Bordi i Komisionereve te ERE-s, per “Per miratimin e kohezgjatjes per faturimin aforfe per abonentet familjare pa mates te energjise elektrike” per vitet

2007-2008-2009, nga ana e kompanise CEZ Shperndarje nuk jane marre masa per te bere anulimet perkatese.

- Mosrespektimi i afateve te percaktuara per lidhjen e kontratave te reja. Për këto raste konstatojmë vonesa në lidhjen e kontratave, mos transferim të kontratave për objektet që figurojnë debitorë. Nga ana jone është udhëzuar të bëhet lidhja e kontratave për të gjithë ata subjekte që nuk janë debitorë, udhezim i cili nuk eshte marre parasysh nga e kompanise.
- Moskreditim i pagesave te bera per faturat e energjise elektrike . Një fenomen te ri për këtë periudhë do të përmendim edhe ankesat e abonentëve që megjithëse kanë kryer të gjitha pagesat e konsumit të energjisë, rezultojnë debitorë. Nga dokumentacioni që kemi shqyrtuar, kemi konstatuar se kemi të bëjmë me raste kur konsumatorët i kanë kryer pagesat kryesisht me bankë ose postë dhe në këto raste vërejmë mos rakordimin e faturave të paguara, por kemi edhe raste të kryerjes se pagesave ne zyrat e shitjes dhe për të cilat mungon dokumentacioni i kryerjes së këtyre pagesave. Procedura e ndjekur për këta konsumatore, ka qenë kryerja e verifikimit në vend të Librezës origjinale apo pagesat e kryera ne Arkë apo Bankë, me Sistemin e Billingut te CEZ Shpërndarje, duke bërë me pas sistemimet e nevojshme.

Pretendimet e CEZ Shperndarje:

Nga ana e saj, CEZ Shperndarje shprehet nder te tjera se vete procedurat e brendshme dhe platforma elektronike e marredhenieve interaktive te shoqerise me klientet nuk mundeson respektimin e afateve te percaktuara nga ERE ndersa ne pergjigjen e saj ne raport me kete detyrim te licenses nuk ben gje tjeter vecse prezanton punen e kryer nga kjo shoqeri per ngritjen e

qendrave te kujdesit ndaj klientit duke evidentuar punen qe behet nga keto qendra te tilla si veprimet lidhur me pagesat e faturave te konsumatoreve, monitorimit me kamera, sistemit te faturimit online, numri i transkacioneve ne baze mujore, perpunimit te kerkesave per sherbime, punen e bere ne drejtim te pergatitjes se broshurave, pamfleteve te publikuara, modeleve standarte te botuara, modelit te kerkeses per sherbim ku perfshihen komponentet e tarifave dhe ankesa duke u shprehur se shoqeria ka zgjidhur 90% te ankesave dhe kerkesave totale.

Sipas konstatimeve te ERE-s, trajtimi dhe zgjidhja e ankesave nga ana e Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit të CEZ Shpërndarje, kane rezultuar shume problematike. Mosdhenia pergjigje brenda afatit te percakuar ne Rregulloren e Trajtimit te Ankesave nga ana e Furnizuesit, te miratuara nga ERE, vonesa në trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe mos dhenia e zgjidhjes se ketyre ankesave nga ana e CEZ Shperndarje, eshte nje fenomen publik e mediatik, por mbi te gjitha ERE e mbeshtet kete konstatim ne faktin se konsumatorët, ne pjesen me te madhe te tyre, jane paraqitur ne ERE pas kalimit te afatit te kthimit te pergjigjes nga ana e CEZ Shperndarje (lista bashkelidhur). Kjo vonesë bën që një pjesë e konsumatoreve që nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit 1 mujor të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të CEZ, i drejtohen ERE-s për zgjidhjen e ankesës.

Nderkohe nga ana e CEZ Shperndarje, eshte paraqitur ne ERE vetem nje raportim mbi numrin total te ankesave te paraqitura ne CEZ Shperndarje sh.a. si me poshte:

Tabela nr. 17

Ne raportimin periodik te Nentor 2012 deklarohet nga CEZ-Shperndarje :			
	Nr Ankesave Tot. Progressive te vitit		60,001
	Nr. Pergj. ndaj Ankesave Tot vitit		48,350
	Numri Ankesave Totale te muajit Nentor 2012		4,865
	Nr. Pergj. ndaj Ankesave Tot muajit Nentor 2012		2,553

ERE ka konstatuar nje mungese totale informacioni ne raportimet e CEZ Shperndarje, per menyren e trajtimit te ankesave, per kohen e kthimit te pergjigjes konsumatoreve dhe per te dhenat e tjera te detyrueshme ne maredheniet e shoqerise me klientet, detyrime keto te percaktuara si ne licensen per aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakice te energjise elektrike ashtu edhe ne Rregulloren e Trajtimit te Ankesave nga ana e Furnizuesit, te miratuara nga ERE.

4 -Shkelje te treguesve te cilesise se shërbimit te Shpërndarjes dhe Shitjes se energjisë elektrike

Enti Rregullator i Energjise ka miratuar nje sere aktesh me qellim specifikimin e elementeve kyc te cilesise se shërbimit te ofruar konsumatoreve.

Baza Ligjore

- *Vendimi Nr. 108, datë 21.10.2011 “Kushtet e përgjithshme te kontratës se furnizimit me energji elektrike për klientët familjare”, neni 2 dhe 15.*
- *Vendimi Nr. 109, datë 21.10.2011 “Kushtet e përgjithshme te kontratës se furnizimit me energji elektrike për klientët jofamiljare”, neni 2 dhe 15.*
- *Vendimi Nr. 110, datë 21.10.2011, “Për miratimin e rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”*
- *Vendimi Nr. 66, Datë 06.06.2012, “Mbi miratimin e standarteve të trajtimit te ankesave te klientëve te energjisë elektrike nga te licensuarit per aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakice te energjisë elektrike”, neni 3, 4, 16.*

Duke filluar nga 1 Janari i vitit 2012, bazuar ne Vendimet e mësipërme te Bordit te Komisionereve te ERE-s, CEZ Shpërndarje Sh.a. kishte detyrimin per furnizimin e pandërprerë me energji elektrike te Klientëve Familjare. Shoqëria e Shperndarjes duhej:

- a- Te sigurate një regjistrim korrekt të ndërprerjeve të energjisë elektrike të shkaktuara në sistemin e shpërndarjes, për të pasur tregues të performancës për sa i përket vazhdueshmërisë së furnizimit;
- b- Te permiresonte vazhdueshmërinë e shërbimit të furnizimit në nivel kombëtar dhe për të ulur diferencat ndërmjet zonave të ndryshme të furnizimit;
- c- Të kufizonte numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve vjetore që pësojnë klientët, duke i siguruar një rimbursim të përcaktuar në rastet e tejkalimit të standarteve specifike të përcaktuara në këtë Rregullore.
- d- Te sigurate një proces te drejte dhe efektiv te trajtimit te ankesave te klienteve te energjise elektrike, ne menyre qe te permiresohet cilesia e sherbimit te shperndarjes dhe furnizimit me energji elektrike

Gjithashtu, bazuar ne Rregulloren e Cilesise se Sherbimit te sipermendur, duke filluar nga 1 janari i vitit 2012, CEZ Shperndarje kishte detyrimin te respektonte këto nivele të lejuara ***për kohëzgjatjen e ndërprerjeve te gjata te paplanifikuara*** te shkaktuara në rrjetin e tensionit 20 kV e lart për 1 vit:

- a) Për kryeqytetin – 2 ore/klient
- b) Për zonat urbane – 4 ore/klient
- c) Për zonat rurale – 24 ore/klient

Ndersa ***per numerin e ndërprerjeve te shkaktuara*** në rrjetin e tensionit 20 kV e lart për 1 vit, duhet te respektonte keta tregues:

- a) Për kryeqytetin - 2 ndërprerje
- b) Për zonat urbane - 5 ndërprerje
- c) Për zonat rurale - 10 ndërprerje

Nga monitorimet e ushtruara nga ana e ERE-s, është analizuar evidenca e ndërprerjeve të gjata të paplanifikuara, për periudhën tetor – dhjetor 2012, periudha e cila bazuar në numërimin e shtuar të ankesave të konsumatorëve në zona të ndryshme të vendit, si dhe nga informacionet e raportuara nga mediat e shkruara dhe vizive, rezultojnë se këto ndërprerje kanë qenë me evidente. Nga tabela nr. 18 e mëposhtme, pasqyrohen ndërprerjet për muajin Nëntor 2012, në Tension të Lartë, Tension të Mesëm dhe Tension të Ulët.

Tabela nr. 18

Tension I Larte

Shkaku I stakimit	Konsumatore te efektuar nga stakimet	Kohezgjatja totale e stakimeve (h : min)
Tranformatoret	67336	31:39:00
Linja	432407	136:58:00
Zbarat e N/St	20873	36:24:00
Celesat e HV	222265	94:50:00
Izolatoret	6632	2:51
Mbrojtja maximale	61403	7:59
Lidhje e Shkurtra	1	3:00
Lidhje me token	700	14:30
Siguresat HV	1187	3:01
Mbiflukset	1832	7:59
Arsye sigurie	28448	33:47:00
Shuma	843084	372:58:00

Tension I Mesem

Shkaku I stakimit	Konsumatore te efektuar nga stakimet	Kohezgjatja totale e stakimeve (h : min)
Tranformatoret	5800	12197:04:00
Percjelles dhe Izolator	1458165	7475:21:00
Percjelles i l.dobta	7058	15:15:00
Thikat	27648	94:50:00
Izolatoret	376809	3564:42:00
Kablli ; Kablli kryesor	86119	927:30:00
Lidhje e Shkurtra	358776	552:48:00
Lidhje me token	146331	192:13:00
Siguresat MV	316046	325:26:00
Kabinat	60	145:00:00
Arsye sigurie	647091	894:36:00
Shuma	3429903	14187:41:00

Tension I Ulet

Shkaku I stakimit	Konsumatore te efektuar nga stakimet	Kohezgjatja totale e stakimeve (h : min)
Percjellesi	7289	1058:02:00
Automati LV	3740	139:46:00
Siguresat LV	2582	180:09:00
Panel LV	180	5:20:00
Izolatoret LV	353	79:15:00
Shuma	14144	1462:32:00

Nga tabela e mesiperme evidentohen keta tregues:

- Numri i konsumatoreve te prekur nga ndërprerjet e gjata te paplanifikuara ne rang vendi, eshte 843084 ne TL, 3429903 ne TM, 14144 ne TU;

- Kohezgjatja e ndërprerjeve është 372 ore në TL, 14187 ore në TM dhe 1462 ore në TL;

Siç u shpjegua në analizën më sipër CEZ Shperndarje, bazuar në detyrimin e saj për të operuar dhe për të zhvilluar OSSH në pajtim me Licencën e Shperndarjes së energjisë elektrike, dhe konkretisht në pikën 3.3 dhe 3.4, ku përfshihen detyrimet e të Licensuarit si më poshtë:

- I Licensuari do të hartojë dhe nxisë politika dhe programe për arritjen e një niveli të lartë të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së Shërbimeve të Shperndarjes sipas Rregullave të ERE-s.
- I Licensuari do të ndermarre të gjithë masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të Veprimtarisë së Licensuar me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të shperndarjes në përfitim të klienteve, dhe sipas Kodit të Shperndarjes.

Pra në kundërshtim me sa parashikuar në aktet rregullatore të sipërmendura, CEZ Shperndarje ka shkelur në mënyrë të dukshme cilësinë e shërbimit të ofruar konsumatorëve.

Nga sa verifikuar nga ERE, një nga shkaqet kryesore të ndërprerjeve kanë qenë veprimet e mbrojtjes maksimale, si rezultat i uljes së tarimeve të kësaj mbrojtjeje nga vete kompania CEZ Shperndarje. ERE ka monitoruar dhe analizuar këto veprime direkt në nën/stacionet perkatëse, nga ku rezulton se 46.969 konsumatorë kanë mbetur të furnizuar me energji për rreth 447 ore, gjatë muajit nëntor 2012.

Nderprerjet kolektive te energjise elektrike.

Gjate monitorimeve te realizuara nga ana e ERE-se gjate muajve Tetor – Dhjetor 2012, eshte verejtur nje perkeqesim i situates se furnizimit me energji elektrike, per shkak te paaftesise menaxhuese te shoqerise CEZ Shperndarje. Lidhur me mungesën e energjisë ne disa zona konkretisht:

- Komuna Postribe, Rrethi Shkoder;
- Komuna Kolsh, Rrethi Lezhe;
- Tirane, N/Stacioni Uzina Dinamo e re;
- Kruje, N/Stacioni Kruje;
- Zona e Mamurrasit.

jane verejtur keto problematika :

Komuna Postribe, Rrethi Shkoder – Nisur nga shqetesimet e bera prezent prane ERE nga banoret e zones se Postribes se rrethit Shkoder , per nderprerjen e vazhdueshme te energjise elektrike, ERE ngriti nje grup pune per monitorimin e situates. Nga verifikimi ne vend u konstatua qe ne kete zone kishte stakime masive te Fiderit nr.15, qe del nga nenstacioni Shkodra 1, i cili furnizon te gjithë konsumatorët e kesaj zone. Pasi u kontrollua i gjithë dokumentacioni teknik i mbajtur ne kete nenstacion, u verejt qe me date 16.10.2012 nga ana e punonjesve te CEZ Shperndarje eshte bere ulja e tarimit te mbrojtjes maksimale nga 320A ne 216A. Ulja e vleres se tarimit eshte bere ne menyre te pajustificuar pasi stakimet e deritanishme te ketij Fideri kane ardhur jo si rezultat i mbingarkeses. Si rezultat i veprimit te kesaj mbrojtje maksimale te gjithë konsumatorët e lidhur ne Fiderin nr.15 nuk jane furnizuar me energji elektrike pothuajse gjate gjithë kohes. Nga ana e perfagesuesve te ERE dhe CEZ Shperndarje u procedua me nenshkrimin e nje procesverbali konstatimi , duke rikthyer gjendjen ne parametrat teknik normal te ketij Fideri dhe furnizimin me energji

elektrike te konsumatoreve. Gjithashtu nga ana e ERE-s me shkresen me Nr. Prot. 675, me dt. 22.10.2012 i eshte kerkuar kompanise CEZ Shperndarje qe cdo lloj mase e ndermarre ne te ardhmen nga ana e tyre te mos cenoje furnizimin e konsumatoreve me energji me elektrike ne perputhje me Standartet e Cilesise Teknike te Furnizimit.

Komuna Kolsh, Rrethi Lezhe – Gjate monitorimit te ushtruar ne terren nga ana e ERE-s, u konstatua se ne kete komune mungonte furnizimi me energji elektrike si pasoje e stakimit te Fiderit Nr.10, fider i cili furnizon me energji elektrike komunen Kolsh. Pas verifikimit te kryer nga ana e ERE-s, lidhur me pagesat e energjise elektrike nga ana e banoreve te kesaj Komune, u dokumentua se mbi 120 konsumatore rezultonin pagues te rregullt te energjise elektrike. Bazuar ne sa me siper Enti Rregullator i Energjise i eshte drejtuar kompanise CEZ Shperndarje me shkresen me Nr. Prot 656, me date 11.10.2012 ku i konstatohen keto fakte dhe i kerkohet marrja e masave te menjehershme per furnizimin me energji elektrike te konsumatoreve te energjise elektrike te Komunes Kolsh dhe procedimi ne perputhje me percaktimet e nenit 11, te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per abonentet te cilet rezultojne debitore ndaj kompanise CEZ Shperndarje. Nga ana e saj, vete CEZ Shperndarje, ne lidhje me problemet e furnizimit me energji elektrike per Komunen Kolsh ne Lezhe, eshte pergjigjur me shkresen me Nr. Prot 6563, me date 16/10/2012, shkrese ne te cilen pranon se kjo komune nuk eshte 100 % debitore. Bazuar ne sa me siper, ERE konstaton se nderprerja e furnizimit me energji elektrike ne kete komune, si pasoje e stakimit te Fiderit Nr.10, eshte bere ne kundërshtim me Licensen per Aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakice te Energjise Elektrike dhe Kushtet e Pergjithshme te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare.

Tirane, N/Stacioni Uzina Dinamo e re – Nga ana e ERE u konstatua se ne Fiderin 254, që del nga ky N/Stacion, ishte ulur tarimi i mbrojtjes maksimale nga 240 A ne 200 A, dhe si rezultat kishte ndërprerje te vazhdueshme te energjise elektrike duke bërë që 3571 konsumatorë të kishin mungesë furnizimi të pandërprerë me energji elektrike. Pas verifikimit nga ana e perfaqesuesve te ERE-s, u gjykua e pajustificuar dhe e padrejte kjo ulje e tarimit te mbrojtjes. Ne kete N/Stacion vihet re qe Transformatori i fuqisë ekzistues 10 MW i dëmtuar ishte zëvendësuar me një transformator 6 MW i cili nuk mbulon kërkesen për energji nga zona te cilen furnizon duke bërë alternimin e zonës cdo 2 orë.

Kruje , N/Stacioni Kruje - Nga konstatimi i gjendjes teknike ne vend të Fiderit 1, që del nga N/St Kruje, vërehet se, ky Fider del me kabell $3 \times 185 \text{ mm}^2$ dhe vazhdon me linje ajrore Alumin-Celik 95 mm^2 ku kampatat fundore e kesaj linje me ngarkese te ulet jane 50 mm^2 e njejta gjendje verehet dhe per Fiderin 2 por qe linja vazhdon kablllore. Transformatoret e rrymes te ketyre Fiderave jane 400/5, ku tarimet e mbrojtjes maksimale per te siguruar furnizimin me energji te zones deri me date 11.07.2012 ishin 480 A, ne kete date tarimet e mbrojtjes maksimale u ulen ne 200 A (sipas shenimit ne librin operativ), duke cuar ne stakimin e ketyre tranformatorve dhe mosfurnizimin me energji të 1279 konsumatorëve tariforë.

Zona e Mamurrasit - E njejta problematikë e mbrojtjes maksimale është vërejtur edhe në zonën e Mamurrasit e cila rezultonte pa energji elektrike si rrjedhojë e uljes së mbrojtjes maksimale, duke lënë pa energji energji elektrike 2691 konsumatorë. Duhet theksuar që në këtë zonë është e papranueshme justifikimi që është rritur ngarkesa.

Gjithashtu nga evidencat e fundit, rezulton se numri i konsumatorëve pa energji elektrike rezultojn të jetë mbi 7000. Vihet re që shkak kryesor për këtë është mungesa/dëmtimi i transformatoreve.

Ne tabelen nr. 19 pasqyrohen ne menyre analitike nderprerjet e gjata te paplinifikuara per shkak te veprimit te mbrojtjes maksimale, gjate muajit nentor 2012 ne gjithe Shqiperine, si rezultat i uljes se vlerave te tarimeve te kesaj mbrojtjeje.

Nenstacioni	Data	Fideri	Total		Nr ckycjeve	Kohezgjatja	Nderprerjet e energjiise	
			Nr I kabinave	Nr I konsumatoreve			Nr I kabinave	Nr I konsumatoreve
5	14.11	Bilisht	45	3891	1	14:00	1 branch	809
4-Petrushe	19.11	Petrushe	20	2923	1	8:00	13	1103
Dinamo	1.11	254	9	988	1	8:00	1	56
Dinamo	2.11	253	17	2087	3	16:00		
Dinamo	5.11	253	17	2087	2	16:00		
Dinamo	8.11	253	17	2087	5	10:00	6	354
Fushe Kruje	1.11	6	40	1800	2	12:00	14	650
Fushe Kruje	1.11	12	44	1888	2	12:00	15	680
Fushe Kruje	2.11	6	40	1800	2	20:00	14	500
Fushe Kruje	2.11	12	44	1888	2	10:00	9	380
Fushe Kruje	16.11	12	44	1888	1	20:00	9	380
Fushe Kruje	30.11	6	40	2039	1	4:00	7	300
Ibe	6.11	3	59	1526	1	4:00	25	693
Ibe	9.11	3	59	1526	1	2:00	25	693
Ibe	14.11	3	59	1526	1	4:00	25	693
Ibe	15.11	7	17	802	1	16:00	10	700
Ibe	16.11	3	59	1526	1	2:00		
Ibe	23.11	3	59	1526	1	4:00	25	693
Ibe	26.11	3	59	1526	2	12:00	25	693
Ibe	30.11	3	59	1526	1	8:00	25	693
Kinostudio	1.11	126	44	967	2	6:00	1	195
Kinostudio	2.11	126	44	967	1	6:00		
Kruje	1.11	1	23	1670	3	6:00	5	450
Kruje	1.11	2	18	1274	1	4:00	6	560
Kruje	2.11	1	23	1670	1	10:00	7	430
Kruje	2.11	2	18	1274	1	14:00	6	460
Kruje	30.11	1	23	1670	2	8:00	4	200
Llixha-2	12.11	Mjekes	34	1819	1	8:00	9	407
Llixha-2	22.11	Mjekes	34	1819	1	16:00	6	196
Mamuras	1.11	3	25	815	1	8:00		
Mamuras	2.11	3	25	815	1	10:00	2	200
Mamuras	8.11	3	25	815	1	0:00		
Mamuras	9.11	3	25	815	1	18:00		
Mamuras	12.11	3	25	815	1	6:00		
Mamuras	15.11	3	25	815	1	18:00	1	200
Rexhepaj	2.11	7	30	1340	1	17:36	7	700
Rinas	30.11	Vore	57	584	1	12:00		
Selite	2.11	28	12	1280	1	4:00	2	454
Shijak	19.11	10	52	1265	1	12:00		
Shijak	23.11	4	72	2019	3	14:00	12	200
Shijak	27.11	4	72	2019	3	14:00	12	200
Shijak	30.11	9	44	2564	1	6:00		

Shkodra 1	1.11	5	140	2708	3	2:48	55	700
Shkodra 1	1.11	15	126	2865	1	2:48	36	250
Shkodra 1	2.11	5	140	2708	2	17:36	55	700
Shkodra 1	2.11	15	126	2865	2	19:12	95	2100
Shkodra 1	5.11	5	140	2708	1	9:36	55	700
Shkodra 1	5.11	15	126	2865	1	9:36	95	2100
Shkodra 1	6.11	5	140	2708	1	9:36	55	700
Shkodra 1	6.11	15	126	2865	1	9:36	95	2100
Shkodra 1	7.11	5	140	2708	1	9:36	55	700
Shkodra 1	8.11	5	140	2708	1	13:12	28	600
Shkodra 1	9.11	5	140	2708	1	20:48	28	600
Shkodra 1	12.11	5	140	2708	3	7:12	35	700
Shkodra 1	12.11	15	126	2865	1	12:24	30	600
Shkodra 1	14.11	5	140	2708	2	20:24	40	800
Shkodra 1	15.11	5	140	2708	1	6:24	40	800
Shkodra 1	16.11	5	140	2708	1	19:36	40	800
Shkodra 1	19.11	5	140	2708	1	6:00	60	1200
Shkodra 1	21.11	5	140	2708	1	6:00	60	1200
Shkodra 1	22.11	5	140	2708	1	17:36	60	1200
Shkodra 1	23.11	5	140	2708	3	6:48	60	1200
Shkodra 1	26.11	5	140	2708	2	5:12	43	700
Shkodra 1	26.11	13	8	391	1	0:00		
Shkodra 1	26.11	15	126	2865	1	11:36		
Shkodra 1	27.11	13	8	391	1	23:36	8	391
Shkozet	1.11	24	82	1626	1	16:00	12	600
Shkozet	2.11	24	82	1626	1	4:00	12	400
Shkozet	6.11	24	82	1626	1	10:00	12	400
Shkozet	30.11	24	82	1626	3	20:00	12	400
Shupenze	7.11	2	35	1514	1	9:36	2	120
Shupenze	8.11	2	35	1514	1	9:36	2	120
Shupenze	9.11	2	35	1514	1	9:36	2	120
Shupenze	12.11	2	35	1514	1	0:00	2	120
Shupenze	14.11	2	35	1514	1	0:00	2	120
Shupenze	15.11	2	35	1514	1	0:00	2	120
Shupenze	16.11	2	35	1514	1	4:00	2	120
Tec Kombinat	1.11	3F	11	2092	1	18:00	2	400
Tec Kombinat	2.11	3F	11	2092	1	14:00	2	300
Tec Kombinat	2.11	8F	10	1859	1	8:00	4	600
Tec Kombinat	6.11	18F	24	2753	2	12:00	4	530
Tec Kombinat	8.11	11F	111	1306	1	10:00	30	300
Tec Kombinat	8.11	18F	24	2753	1	6:00	4	600
Tec Kombinat	9.11	2F	11	886	1	0:00		
Tec Kombinat	9.11	18F	24	2753	1	0:00	4	600
Tec Kombinat	12.11	18F	24	2753	1	12:00	1	185
Tec Kombinat	14.11	3F	11	2092	2	10:00	3	250
Tec Kombinat	16.11	11F	111	1306	3	2:00	20	30
Tec Kombinat	16.11	3F	11	2092	1	10:00	1	575
Tec Kombinat	16.11	2F	11	886	1	0:00	1	453
Tec Kombinat	20.11	2F	11	886	1	10:00	1	453
Tec Kombinat	20.11	3F	11	2092	2	16:00	2	300
Tec Kombinat	20.11	11F	111	1306	1	20:00	20	250
Tec Kombinat	23.11	2F	11	886	1	10:00	1	453
Tec Kombinat	23.11	3F	11	2092	1	6:00	2	300
Tec Kombinat	23.11	19	40	557	3	12:00	2	250
Tec Kombinat	26.11	3F	11	2092	2	4:00	2	300

Tec Kombinat	26.11	8F	10	1859	1	18:00	4	600
Tec Kombinat	26.11	18F	24	2753	1	6:00	4	530
Tec Kombinat	26.11	19	40	557	2	2:00	2	250
Tec Kombinat	27.11	3F	11	2092	4	0:00		
Tec Kombinat	27.11	18F	24	2753	4	16:00		
Traktora	2.11	70	17	1458	1	10:00		
Traktora	9.11	80	8	451	1	6:00		
Valias	1.11	143	15	206	1	0:00	3	57
				192,006	152	637h 38 m		46,969

Shqetësues është fakti që ka konsumatorë me mbi 500 ditë pa energji elektrike.

Sqarojme se për gjitha keto monitorime ERE ka mbajtur kontakte të afërta me përfaqësues të shoqërisë CEZ, gjë e pranuar nga vetë CEZ në informacioni e dërguar. Për të gjitha keto raste ERE ka mbajtur qëndrim zyrtar mbi mënyrën e trajtimit dhe gjithashtu ka dërguar udhëzimet e veta me anë të shkresës nr. 816, prot., datë 26.12.2012, udhëzime keto të cilat nuk janë parë të pasqyruara në veprimet e shoqërisë CEZ.

Nga ana e CEZ shkak i mungesës së energjie elektrike në keto zonë është rezultat i disa faktorëve të tilla si niveli i ulët i mbledhjes së detyrimeve dhe nivelet e larta të vjedhjes.

Thëksojmë se rritja e arketimeve dhe ulja e vjedhjeve ishte një nga objektivat kryesore të privatizimit, të cilat vetë CEZ në informacionin e dërguar pranon që ka deshtuar të përmirojë dhe jo vetëm por i konsideron si shkak i mungesës së energjisë elektrike. Gjithashtu ERE si autoriteti më i lartë energjetik në vend ka miratuar kontratat dhe rregulloret e cilësive të cilat vendosin detyrime ndaj CEZ mbi mënyrën e ndërprerjes së energjisë elektrike, afatet dhe sanksionojnë parimin që ndërprerjet duhet të jenë individuale. Ashtu siç mbajtur qëndrim në shkresat e dërguara në CEZ, shoqëria CEZ përgjithësisht nuk ka respektuar modalitetet e nevojshme për ndërprerjen e energjisë elektrike konsumatoreve.

Cilesia e tensionit te furnizimit me energji elektrike

Nje tjeter problem shume serioz eshte cilesia e furnizimit te energjise elektrike. Per shkak te mos realizimit te investimeve dhe mos njohjes se zhvillimit te zonave te vendit, CEZ nuk ka ndjekur me investime shume zona gje qe ka bere cilesia e furnizimit me energji elektrike sidomos ne drejtim te nivelit te tensionit te jete jashte cdo norme te lejuar. Ne listen shume te gjate te ankesave shume konsumatore familjare dhe sidomos industrial ankohen per nje nje nivel tensioni rreth 30-40% me te ulet se vlera standarte. Kjo ka cuar nje nje demtim te rende te shume pajisjeve elektroshtepiake, makinerive ne sektorin industrial dhe sistemin e pompave te ujesjellesve dhe hidrovoreve pothuajse ne cdo zone te vendit. Vlera e ketyre humbjeve eshte shume e madhe dhe METE se bashku me te gjitha institucionet e vendit ka filluar te kuantifikoje (vleresojte ne menyre sasiore) demin qe i kane sjelle qofte nga mos fornizimi (gje qe i ka detyruar shume konsumatore te perdorin gjeneratorenet diezel me nje kosto gjenerimi rreth 25 cent/kWh) dhe qofte duke i demtuar pajisjet elektroshtepiake, makinerive ne sektorin industrial dhe sistemin e pompave.

Lidhur me konstatimin e ERE ne relacionin bashkelidhur vendimit 158 date 16 nentor 2012, sipas te cilit CEZ Shperndarje ne pjesen me te madhe te rasteve eshte ne shkelje te afatit te trajtimit te ankesave apo kerkesave te klienteve sipas detyrimit te pikes 6.10 te Licenses se Furnizimit Publik me Pakice detyrim ne baze te te cilit i Licensuari do te marre ne konsiderate cdo ankese dhe do t'i pergjigjet me shkrim ankuesit nese ankesa e tij/saj eshte pranuar apo refuzuar, brenda 15 diteve pune nga marrja e saj. Per kete shkelje ne te cilen ERE ben saktesisht referimin se ku konsiton pjesa e papermbushur e detyrimit te CEZ Shperndarje (mos respektimi i afatit prej 15 dite) .

Edhe me tej ne pergjigjen ne raport me kete detyrim te licenses, CEZ Shperndarje serisht nuk jep informacionin sic kerkohet mbi zbatimin e pikes 6.10 te Licenses se FPP- trjatismi i ankesave, por jep nje informacion duke bere prezent punen e bere ne drejtim te pergatitjes se broshurave, pamfleteve te publikuara, modeleve standarte te botuara , modelit te kerkeses per sherbim ku perfshihen kompenetet e tarifave dhe ankohet paralelisht per mungese reagimi nga ERE per nje numer klientesh te cilet nuk respektojne kontraten e furnizimit me energji elektrike lidhur me CEZ Sh, mbeshtetje kjo e munguar edhe nga gjykatat shqiptare, policia e shtetit.

IV- Pergjigja e CEZ Shperndarje sh.a. ne lidhje me Vendimin nr. 158, date 16 nentor 2012 “Per fillimin e procedurave për heqjen e licensës së shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me Vendimin nr. 08, date 25.01.2008, te ndryshuar dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike” të miratuar me vendimet e bordit të komisionerëve nr. 09, datë 25.01.2008 të ndryshuar”.

Ne analize te pergjigjes se CEZ Shperndarje sh.a vërehet se kjo pergjigje është strukturuar ne tre pjese sipas ndarjeve te mëposhtme:

Pjesa e pare – Hyrje

Pjesa e Dyte – Pergjigja e CEZ Shperndarje ndaj Vendimit dhe Raportit te ERE-s e nëndarë kjo ne disa pjese ku parashtrohen sipas gjykimit te CEZ Shperndarje:

A. Mangësi Ligjore ne Vendimin e ERE-se

B. Shkeljet e supozuara te Licensës se Shpërndarjes

C. Shkelje te pretenduara te licensës se furnizimit publik me pakice.

Persa i perket pretendimeve te shoqerise CEZ Shperndarje te analizuar ne pjesen e dyte te informacionit, qe kane te bejne me shkeljet e kushteve te licensave nga

shoqeria CEZ Shperndarje, u trajtuan gjeresisht ne pjesen e pare dhe te dyte te ketij materiali dhe si e tille do konsiderohet i ezauruar.

Po ashtu persa i perket pretendimeve qe i takojne pjeses se pare dhe te dyte ne pergjigjen e CEZ Shperndarje verehet se kjo shoqeri pretendon se situata kritike ne sektor dhe shkeljet e konstatuara nga ERE ne relacionin mbeshtetes te Vendimit nr. 158, date 16 nentor 2012, jane pasoje e veprimeve apo mosveprimeve te pjestareve te tjere te tregut, si KESH sh.a, OST sh.a apo tregtaret (te cilet kane bllokuar llogarite financiare), institucioneve shteterore te cilet permes vendimeve te tilla si vendosja masave administrative (nga Drejtoria e Tatimeve apo edhe ERE), kane krijuar veshtiresite financiare te ketij subjekti, veshtiresi te cilat jane reflektuar me pas sipas CEZ Shperndarje ne pamundesine per permbushjen e detyrimeve dhe kryerjen e sherbimeve sipas legjislacionit ne fuqi. Megjithate CEZ Shperndarje nuk paraqet asnje argument apo reference ligjore qe te mbeshtesi pretendimet e veta ndaj subjekteve te cituara me siper dhe cka eshte me e rendesishme CEZ Shperndarje ne asnje moment nuk jep alternativa te zgjidhjes se situates apo reflektim mbi shkeljet e shkaktuara nga ana e ERE.

Po ashtu CEZ Shperndarje ne informacionin e derguar pretendon se ERE nuk i ka dhene asnjë informacion paraprak apo nuk i ka kerkuar kësaj te fundit te mbroje pozicionin e saj duke e konsiduar kete veprim te ERE si shkelje te nenit 18 pika 2, germa a), te Ligjit nr. 9072 “Për sektorin e energjisë elektrike”, date 22.05.2003, te ndryshuar, si dhe te nenit 2, te Rregullores “Për procedurat e Heqjes se nje License”.

Lidhur me kete pretendim per mos njoftim pararak dhe mostrajtim sipas procedurave ne fuqi sqarojme se:

Sikurse cituar edhe ne fillim te ketij relacioni ne përputhje me sa përcaktuar ne nenin 18 pika 1, germa a), te Ligjit nr. 9072 “Për sektorin e energjisë elektrike”, date 22.05.2003, te ndryshuar, si dhe per sa përcaktuar ne nenet 7 dhe 8 te Rregullores për procedurat e Heqjes se nje License, te miratuar me Vendim te Bordit te Komisionerëve te ERE nr. 68, date 04.11.2005, ERE njoftoi shoqerine CEZ Shpërndarje sh.a per fillimin e procedurave per heqje te licensave kesaj shoqerie, dhe ne baze te kësaj te drejte te komunikuar nga ERE (cito shkresen), CEZ Shperndarje paraqiti informacionin sipas procedurave per heqjen e licenses. Kjo dëshmon ndermjet te tjerave qe ERE ka zbatuar te gjitha procedurat ligjore dhe qe CEZ ka dijeni te plote lidhur me te gjitha argumentat e parashtruara per heqjen e licenses.

Nga ana tjetër nga ana e CEZ Shperndarje pretendohet per nje trajtim jo te barabarte nga ana e ERE-se mbi procedurat e heqjes se licenses, por nuk jepet asnjë argument i metejshem mbi kete shkelje apo ndonje reference tek ndonje procedure tjetër ku ERE ka mbajtur nje qëndrim te ndryshem. Po ashtu CEZ Shperndarje pretendon per nje shkelje nga ana e ERE te parimeve te përcaktuara ne Kodin e Procedurave Administrative dhe me saktësisht parimeve te ligjshmerise, mos diskriminimit dhe proporcionalitet si dhe ne vendimin e saj nuk ka zbatuar parimin e kryerjes se veprimtarise ne bashkëpunim te ngushte me entet private.

Sqarojme se ERE ne Vendimin 158, ka ruajtur **parimin e ligjshmerise** sipas nenit 9 te Kodit te Procedurave Administrative pasi ERE ka vepruar brenda kufijve te kompetencave qe i ka dhene ligji dhe konform qëllimit per te cilat jane dhene keto kompetenca. Konkretisht ne baze te nenit 18 te Ligjit 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjisë elektrike”, te ndryshuar, dhe mbeshtetur ne rregulloren për heqjen e Licensës një te licencuari, nisma per heqjen e nje license dhe vete heqja e licenses jane kompetence e ERE-se. Gjithashtu te gjitha argumentat e parashtruara nga ERE per fillimin e procedurave per heqje licenses shoqerise CEZ Shperndarje jane te

mbeshtetura ne ligjin per sektorin e energjise elektrike, Modelin e Tregut, Rregullat e Tregut, Licensat e Shpërndarjes dhe Furnizimit Publik me Pakice si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore.

Gjithashtu ERE gjate procedurave te ndjekura per heqjen e licenses shoqerise CEZ Shperndarje ka zbatuar plotësisht kerkesat e nenit 11 te Kodit te Procedurave Administrative mbi **parimin e barazise dhe proporcionalitetit**. ERE gjate gjithë vendimmarrjes se saj eshte udhëhequr nga parimi i barazise duke mos privilegjuar asnjë shoqeri te licensuar nga ERE si dhe duke marre marre parasysh edhe ankesat e shumta nga ana e aktoreve te tjere te tregut ndaj shoqerise CEZ Shperndarje sh.a. Masa per fillimin e procedures per heqje liecense eshte konsideruar proporcionale me situaten e paprecedente te krijuar nga shoqëria CEZ Shperndarje ne sektorin e energjise elektrike, permes pa aftesise menaxhues te kësaj te fundit per furnizimin panderprere te konsumatoreve tarifore dhe permbushjes se detyrimeve financiare ndaj pjestareve te tjere te tregut.

Po ashtu ERE ne baze te nenit 12 te Kodit te Procedurave Administrative ka ruajtur **parimin e drejtesise dhe paanesise**, duke i trajtuar gjitha pjestaret e tregut te energjise elektrike ne Shqiperi ne menyre te barabarte.

ERE ka zbatuar **parimin e bashkepunimit te administrates me personat private**, sanksionuar ne nenin 13 te Kodit te Procedurave Administrative, duke i siguruar shoqerise CEZ Shperndarje informacionin dhe sqarimet e nevojshme. Theksojme edhe nje here qe ERE, ne baze te kerkesave te legjislacionit ne fuqi, me ane te shkreses (cito shkresen) ka derguar ne CEZ Shperndarje vendimin 158 dhe relacionin shoqerues duke i dhene mundesise kesaj shoqerie qe te paraqiste argumentet dhe objeksionet e saj.

ERE gjithashtu ka ruajtur parimin e sanksionuar ne nenin 15 te Kodit te Procedurave Administrative, mbi **marrjen e vendimeve**. ERE si autoritetit me i larte ne sektorin e energjise elektrike ka marre vendimi nr. 158, date 16.11.2012 edhe si rrjedhoje e te gjitha ceshtjeve te ngritura nga ana e shoqerive KESH sh.a, OST sh.a, apo cdo pjesetari tjetër te tregut mbi mos realizimin nga ana e CEZ Shperndarje te detyrimeve te saj ligjore.

Si perfundim ERE ne vendimin nr. 158 per fillimin e procedurave te licensave te shperndarjes dhe furnizimi publik me pakice eshe udhehequr nga parimi **i paanshmerise dhe i marrjes se vendimeve** vetem mbi baze te te dhenave te sakta, te cilat kane cuar ne konkluzionin se situata e krijuar ne sektorin e energjise elektrike ka ardhur kryesisht si rrjedhoje e nje menaxhimi jo profesional nga ana e shoqerise CEZ Shperndarje, gje qe i eshte bere e ditur CEZ ne menyre te vazhdueshme (cito shkresat).

Persa i perket pretendimit qe vendimi nr. 158 i ERE, per fillimin e procedurave per heqje license eshte i pajustificuar dhe qe bie ndesh me vendimarrje te tjera te ERE, sqarojme se njoftimi per mbledhje te Bordit te Komisionereve qe do te vendoste per fillimin e procedurave per heqje license eshte njoftuar qe ne 11 Tetor 2012. Nga ana e ERE eshte shtyre disa here kjo mbledhje pikerisht per ti lene kohe shoqerise CEZ Shperndarje per te reflektuar dhe te permiresonte treguesit e saj.

Duke pare perkeqesimin e sherbimeve te ofruara nga shoqeria CEZ Shperndarje dhe kryesisht ne furnizimin e panderprere te energjise elektrike konsumatoreve tarifore, nga ana e ERE u pa e arsyeshme qe te merrej vendimi per fillim procedure per heqje license.

Duke patur parasysh kete vendimarrje te ERE si dhe duke u nisur nga ngritja e nje grupi negociator qe do merrej me negocimin me shoqerine CEZ a.s., persa i perket problemeve te krijuara me kete shoqeri, me Vendimin 159, date 21.11.2012, nga ana e Bordit te Komisionereve u vendos pezullimi i procedures se shqyrtimit te aplikimit te CEZ per rinovim te licenses se shperndarje, si nje proces i ndare dhe i vecante nga procedura per heqje license.

Nga ana tjeter pretendimet e shoqerise CEZ ne baze te cilave deklaratat publike te perfagesuesve te ERE kane qene paragykuese dhe kane ulur arketimet e shoqerise jane te pabazuara pasi se pari ne asnje rast perfagesuesit e ERE nuk kane paragykuar procesin ne media dhe po vete shoqeria CEZ Shperndarje nuk citon asnje rast te tille konkretisht dhe se dyti nga raportimet periodike ne ERE nuk verehet asnje ulje e arketimeve, aq me pak ulje e menjehershme sic pretendon shoqeria CEZ Shperndarje.

Pjesa III – Veprimet e dëmshme kundër CEZ Shpërndarje

Per sa i perket **Pjeses III-** te pergjigjes se CEZ Shperndarje duke pare qe kjo pjese i referohet vendimeve te tjera administrative qe kane te bejne me pretendimet e CEZ Shperndarje per deme te pesuara nga kjo e fundit ne raport me institucionet shqiptare ne mbështetje te nenit 18 te ligjit nr.,9072 date 22.05.2003 “Per sektorin e energjisë elektrike” pika 3 germa a) dhe b), ne te cilat përcaktohet se përgjigja me shkrim e te licensuarit duhet te bazohet ne argumentimin nga i licensuari te arsyeve për shkaqet per te cilit ka nisur procedimi per heqje license, konsiderohen pa interes ligjor per kete procedimi administrativ. Si e tille argumentat e pjeses se trete nuk do merren parasysh ne analizen e përgjigjes se shoqerise CEZ Shperndarje sh.a duke qene se i takojne

vendimmarrjeve dhe pretendimeve te kesaj shoqerie ndaj vendimmarrjeve te tjera te ERE-s, apo shoqerive tjera, organeve te tjera administrative apo gjyqesore dhe jo Vendimit nr. 158, date 16 nentor 2012 *“Per fillimin e procedurave për heqjen e licensës së shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, për aktivitetin e shpërndarjes së energjise elektrike, miratuar me Vendimin nr. 08, date 25.01.2008, te ndryshuar dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike” të miratuar me vendimet e bordit të komisionerëve nr. 09, datë 25.01.2008 të ndryshuar”*.

V- Konkluzione

- Pergjigja e CEZ Shperndarje ndaj vendimit nr. 158, nuk eshte nje pergjigje e mirefillte ndaj vendimit te ERE-s per fillimin e procedurave per heqjen e licenses kësaj shoqerie, apo nje dokument i cili ka qëllimin e mire per zgjidhjen e situates te krijuar ne Shqiperi, apo qe te jape alternativa zgjidhjeje per shkeljet e konstatuara nga ERE, por eshte nje dokument i cili ka si qellim te shprehe synimin e tij per tu larguar nga Shqiperia dhe per ti vene perballe Qeverise se Shqiperise alternativen e shpronësimit te aseteve te CEZ Shperndarje nga ana e shtetit shqiptar.
- Mos vullneti i CEZ Shperndarje per te vazhduar projektin ne Shqiperi reflektohet nga mos vullneti per te investuar ne sistemin e shperndarjes dhe/apo te bleje pajisjet e nevojshme per operim.
- CEZ Shperndarje apo CEZ a.s. nuk kane dhene asnjehere opsione per zgjidhjen e situates, përkundrazi ata shprehin gatishmeri per tu larguar nga Shqiperia. Duke iu referuar shkrimit te botuar nga Agjensia BLOOMBERG ne daten 31 Tetor 2012, ku deklaroi *“CEZ a.s. (CEZ) kompania me e madhe*

CEKE e podhimit te energjise , pohon se eshte duke marre ne konsiderate largimin nga Shqiperia.”

- Referuar korrespondencave te CEZ a.s dhe CEZ Shperndarje, sic përmendur me siper, konfirmohet mos gatishmeria per te zgjidhur ceshtjen e nderprerjeve ne Shqiperi, kryerjen e investime ne rrjetin e shperndarjes, blerjen e pajisjeve dhe paaftësia e tyre per te parandaluar perkeqesimin e situates .
- Mos prokurimi i energjise elektrike per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes eshte nje shembull i qarte i deformimit te tregut te realizuar nga CEZ a.s dhe CEZ Shperndarje, i cili ka sjelle pasoja te renda per sigurine e furnizimit ne Shqiperi.
- Fakti se CEZ Shperndarje ne tetor ka nenkontraktuar menaxhimin e shoqerise nje pale te trete (Schindler’s Group) e cila nuk ka asnje experience ne sektorin e energjise elektrike, tregon qe shoqeria CEZ Shperndarje ka fokusuar aktivitetin dhe menaxhimin e saj ne perгатitjen per largimin nga Shqiperia, ne vend qe te shmangte shkeljet. Kjo deshmon ne paaftesine dhe mos gatishmerine ne permbushjen e detyrimeve dhe investimeve sic kerkuar ne license dhe deklaraten rregullatore. Mjafton vetem ky fakt per te deshmuar mos gadishmerise e shoqerise per te qendruar ne Shqiperi e CEZ a.s dhe CEZ Shperndarje per te hequr licenses.
- Per sa i takon pretendimit te mungesave ligjore ne vendimin e fillimit te procedurave, evidentojme faktin se ERE ka patur komunikime te vazhdueshme me CEZ Shperndarje dhe ka marre vendimet perkatese ne lidhje me kete shoqeri, duke zbatuar te gjitha detyrimet e Kodit te Procedurave Administrative dhe ka plotesuar detyrimin e parashikuar ne

nenin 18, pika 2 e Ligjit 9072, date 22.05.2003, “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar, duke identifikuar gjitha dispozitat ku bazohet ne procesin e fillimit te procedures per heqje license.

- Njohja e detyrimit nga ana e CEZ Shperndarje, duke u shprehur e gatshme per te importuar sasine e nevojshme te energjise, sic shihet edhe ne shkresen e derguar Kryeministrit, te dates 30 Korrik 2012 ne te cilen percaktohet se *“sipas kontrates, CEZ Shperndarje eshte i detyruar te importoje energjine e duhur per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes, duke synuar nje sherbim me te mire per klientet shqiptar, kompania meme ne Prage ka vendosur to alokoje me shume fonde ne kompanine e shperndarjes, te cilat do te perdoren per te siguruar energjine e duhur me qellim garantimin e furnizimit te panderprere me energji elektrike”*, rrezon te gjitha pretendimet e CEZ Shperndarje se kane importuar sasine e duhur te Energjise per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes.
- Ne letren drejtuar Kryeministrit, te dates 16 Korrik, 2011, ne te cilen CEZ Shperndarje thekson se *“...se mund te sjelle sa me shpejt te jete e mundur 100 milion euro ne Shqiperi dhe mund te investoje shumen e pare te rendesishme ne rrjetin e shperndarjes dhe te vazhdoje me permiresimin e sherbimit te shperndarjes nga ana CEZ Shperndarje s”*, konfirmohen dy fakte te rendesishme:
 - a. Se pari, njihet detyrimi per te investuar nga ana CEZ Shperndarje ne rrjetin e shperndarjes
 - b. Se dyti, konfirmohet me shkrim nga ana e tyre qe kjo vlere eshte investimi i pare qe do te kryhet prej tyre ne Shqiperi.

- Nje dokument shume i rendesishem, na demonstroi qellimin e kompanise CEZ Shperndarje per tu larguar nga Shqiperia. Ne proces verbalin e mbledhjes te dates 8.11.2012, drejtuesit e kompanise ceke, shprehen: *“Eshte e rendesishme te theksohet se keto detyrime apo keto efekte negative jane vetem per efekt mbajtje llogarish, sepse ne ndaluan financimin. Ne nuk po investojme me asnje para. Kompania nuk po performon mire, Kompania nuk ka para per CapEx, keshtu qe ne nuk paguajme tani per energji dhe nuk jemi duke paguar per energji. Por ju e dini qe ne nuk jemi te gatshme te investojme asnje Euro ne kompani derisa siuate te ndryshoje derisa te largohemi. Keshtu nese largohemi ne do shesim kompanine, e dorezojme tek Shqiptaret cfaredo qe te ndodhe ne deri ne fund te vitit .”*

Keto deklarime jane nje deshmi e qarte e shprehjes ne menyre flagrante te mungeses se vullnetit te CEZ Shperndarje per te mos investuar ne Shqiperi dhe e pergatitjes se tyre per tu larguar nga Shqiperia sa me pare te jete e mundur.

- ERE konstatoi se mungesa e investimeve nga ana e CEZ Shperndarje sh.a. dhe permiresimi i sistemit te shperndarjes, ne kundërshtim keto me detyrimet sipas planit te investimeve te miratuar nga ERE, i cili kishte si qellim pikerisht permiresimet ne kete sektor, jane shkak qe CEZ Shperndarje nuk ka mundur te permbushë detyrimet e marra persiper, te cilat kane cuar nder te tjera edhe ne rritjen e vjedhjeve te energjise elektrike dhe shtimin e lidhjeve te paligjshme.
- Persa i takon shkeljes se konstatuar ne lidhje me mungesen e matesave te Energjise elektrike, evidentojme faktin se asnjehere nuk eshte provuar para ERE-s plotesimi me matesa i te gjithe abonenteve duke qene se vete CEZ Shperndarje ka nje mungese te theksuar provash ne pergjigjen e saj, dhe per me teper eshte kontraktaktor pasi ne raportimet prane ERE konfirmohet

nga vete CEZ Shperndarje, ekzistenca e abonenteve pa matesa ne teritorin e Shqiperise.

- CEZ Shperndarje ne pergjigjen e derguar pranon vete faktin qe nuk ka plotesuar kushtet e licenses persa i perket raportimeve periodike.

Per Licensen e Furnizuesit Publik me Pakice

- Lidhur me pretendimet e CEZ Shperndarje sh.a. se ERE ia ka imponuar Marreveshjen KESH sh.a. del qarte se ERE i ka beret e gjitha perpjekjet qe palet te arrinin ne nje Marreveshje. Per me teper, bazuar ne piken 4.3. te Modelit te Tregut, marredhenie KESH sh.a. (FPSH) dhe CEZ Shperndarje sh.a. (FPP) per furnizimin me energji elektrike, eshte nje marredhenie e rregulluar nga ERE, gje qe i jep te drejte ERE-s te percaktoje te drejtat dhe detyrimet e pjesetareve te tregut, qe perfshin edhe aprovimin e e kesaj Marreveshjeje.
- Rritja e ndjeshme e numerit te ankesave te paraqitura nga ana e konsumatoreve ne ERE, eshte tregues i dukshem:
 - i. Se pari i paaftësisë se CEZ Shperndarje për te trajtuar ankesat mjaft te shumta dhe te rritura qe nga momenti i privatizimit.
 - ii. Se dyti se eshte nje fakt i pakundershtueshem i perkeqesimit te cilesise se sherbimit te CEZ Shperndarje Sh.a ndaj konsumatorit
 - iii. Se treti, deshmon se CEZ Shperndarje është në fakt e paaftë për të trajtuar rritjen e numrit të ankesave për shkak të mungesës së investimeve dhe per shkak te mosplotesimit nga ana e tyre te

detyrimeve te marra me siper te permendura gjeresisht ne kete material.

- CEZ Shperndarje ne pergjigjen e saj nuk sjell asnje prove per te argumentuar “*permiresimet e bera ne trajtimin e ankesave*”. Nepermjet te dhenave te paraqitura ne kete raport, evidentohet fakti qe Qendrat e Trajtimit te ankesave te konsumatoreve te ngritura nga CEZ Shperndarje sh.a., kane rezultuar inefficente dhe nuk kane permbushur detyrimet ligjore per trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave.
- ERE ka dokumentuar se ndërprerjet kolektive e energjisë elektrike te kryera te nga CEZ Shperndarje keta muajt e fundit, kane prekur nje pjese te madhe te komunitetit, duke mos patur asnje argument teknik per kryerjen e tyre, pervec mungeses se transformatoreve dhe bazes se nevojshme materiale qe duhej te sigurohej nga vete CEZ Shperndarje sh.a..

Eshte e rendesishme te theksojme se letra e derguar nga CEZ Shperndarje me shkresen nr 6092/2, date 28.09.2012 ku theskohet qe KESH sh.a *duhet te sberbeje furnizues i alternativa e fundit dhe CEZ Shperndarje sh.a eshte ne pamundesine te beje importin e nevojshem*, dhe letra tjeter e derguar prej CEZ Shperndarje ne date 20 Dhjetor 2012, nr.7869 ne ERE ne te cilen thekson se CEZ Shperndarje *mund te mos jete ne gjendje te parandaloje perkeqesimin ne javet e ardhshme ne nivelin e sherbimeve qe siguron, perfshire edhe levrimin e energjise elektrike*, jane te mjaftueshme per ti hequr licensat kompanise CEZ Shperndarje, duke qene se ajo vete me keto letra dorezohet duke thene se nuk i ploteson dot me detyrimet e licencave. Megjithate grupi i punes ka analizuar ne kete relacion me detaje te gjitha shkeljet, duke i mbeshtetur ato me te dhena dhe dokumentacionin perkates. Bashkengjitur ketij materiali eshte i gjithe dokumentacioni

dhe korespondenca, qe kane sherbyer si baze per hartimin e ketij Relacioni, i ndare sipas anekseve perkatese.

Per gjithë sa me siper i propozojmë Bordit te Komisionerëve te ERE-s qe:

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma a), 9 dhe 18 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; Modelit te Tregut te Energjië Elektrike te Shqiperise, te miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008; “Deklarates Rregullatore” miratuar me Vendimin nr. 12, date 03.03.2009, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të Rregullores për Heqjen e Liçensave, miratuar me Vendimin nr. 68, datë 04.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; Liçensës “Për aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike” miratuar me Vendimin nr. 09, datë 25.01.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; Liçensës për aktivitetin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin nr. 08, datë 25.01.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjare dhe Jo-Familjare, miratuar me Vendimet nr. 108 dhe 109, datë 21.10.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike me KESH sh.a dhe CEZ Shperndarje, te miratuar me Vendimin nr. 31, date 31.03.2011 te Bordit te Komisionereve te ERE; Marreveshjes se Transmetimit mes OST sh.a dhe CEZ Shperndarje miratuar me Vendimin 03, date 11.01.2011 te Bordit te Komisionereve te ERE dhe nenit 18 pika 1 gërma a) të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, te vendose:

1. Heqje te licenses se aktivitetit te shperndarjes se energjise elektrike shoqerise CEZ Shperndarje sh.a;
2. Heqje te licenses se aktivitetit furnizimit publik me pakice te energjise elektrike shoqerise CEZ Shperndarje sh.a;
3. Shoqeria CEZ Shperndarje eshte pergjegjese per kostot e shkaktuara ERE-se, Qeverise Shqiptare dhe pjesmarresve te tregut, si rezultat i heqjes se licensave ne perputhje me piken 5.6 te licenses se shperndarjes dhe pikes 5.6 te licenses se furnizimit publik me pakice;

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje Keshillin e Ministrave per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE, qe te veproje menjehere per shpronësimin e aseteve te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a kundrejt nje kompensimi te drejte, sipas procedurave te parashikuara ne ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.
5. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje menjehere CEZ Shperndarje per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE.